



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E BUJQËSISË, MBROJTES SË MJEDISIT, VETERINARISË,
PYJE DHE KULLOTA

Nr. 12963 prot.

Vlorë, më 15 08 2024

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____.2024

“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PËRSHTATJES NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NË BASHKINË VLORË”

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 19.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8, pika 2, neni 9.1, pika 1.a dhe 1.b, neni 23, pika 14, neni 26, në Ligjin nr.155/2020 “Për Ndryshimet Klimatike”, Vendim nr. 466, datë 3.7.2019 “Për Miratimin e Dokumentit Strategjik dhe të Planeve Kombëtare për Zbutjen e Gazeve me Efekt Serrë dhe për Përshtatjen Ndaj Ndryshimeve Klimatike”, si dhe në relacionin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 22.08.2024.

V E N D O S I:

1. Të miratojë “Planin e Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike” në Bashkinë Vlorë, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij Projektvendimi.
2. Për zbatimin e këtij Projektvendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.

Ky projektvendim hyn në fuqi menjëherë, bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 55 pika 6.

KRYETAR

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E BUJQËSISE MBROJTJES SË MJEDISIT VETERINARISË
PYJE DHE KULLOLTA

Nr. 12963 prot.

Vlorë, më 15 08 2024

RELACION

**MBI PROJEKTVENDIMIN “PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PËRSHTATJES
NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NË BASHKINË VLORË”**

Të nderuar këshilltarë!

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 19.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8, pika 2, neni 9.1, pika 1.a dhe 1.b, neni 23, pika 14, neni 26, në Ligjin nr.155/2020 “Për Ndryshimet Klimatike”, Vendim nr. 466, datë 3.7.2019 “Për Miratimin e Dokumentit Strategjik dhe të Planeve Kombëtare për Zbutjen e Gazeve me Efekt Serrë dhe Për Përshtatjen Ndaj Ndryshimeve Klimatike”, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 22.08.2024.

Projektvendimi që po ju paraqesim për miratim lind si domosdoshmëri e përmbushjes së detyrimeve ligjore të Qeverisjes Vendore për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të popullatës. Në këto kushte, Bashkia Vlorë ka inicuar hartimin e Planit të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike në territorin e saj.

Bashkia Vlorë për shkak të pozitës së saj gjeografike dhe karakteristikave unike të mjedisit, është e ndjeshme ndaj ndryshimeve klimatike. Vlora, qyteti i tretë më i madh në Shqipëri, shtrihet nga grykëderdhja e lumit Vjosë në veri deri në Parkun Kombëtar të Llogarasë në jug, me mbi 90 km vijë bregdetare në Detin Adriatik dhe Jon. Qyteti ka dalje direkte në det dhe mbrojtje natyrore nga malet dhe kodrat dhe përfiton nga pozicioni i tij strategjik midis rrugëve tokësore detare dhe ajrore.

Bashkia mbulon një territor prej 617 km², rreth 2.2% të sipërfaqes së vendit.

Klima e Vlorës po ndryshon në përputhje me tendencën e ngrohjes globale.

Mbi bazën e një analize multikriteriale, Bashkia Vlorë identifikohet si një nga bashkitë më të prekura nga ndryshimet e klimatike dhe moti ekstrem.

Në zbatim të Ligjit nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”, bashkitë duhet të hartojnë dhe zhvillojnë politika dhe masa përshtatëse, për të zvogëluar rrezikun dhe pasojat e ndryshimeve të klimës, duke rritur kapacitetet dhe përfshirjen e barabartë gjinore në proceset vendimmarrëse për përshtatjen dhe ripërtëritjen e komuniteteve.

Plani i Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike, është hartuar nën drejtimin e stafit

teknik të Bashkisë, përmes ngritjes së bazës së të dhënave, zhvillimit të kapaciteteve,

identifikimit të masave prioritare përshtatëse dhe hartimit të këtij plani të për t'iu përgjigjur ndikimeve negative të ngjarjeve atmosferike ekstreme dhe për të siguruar investime afatgjata.

Bashkia e Vlorës ka identifikuar 51 Masa Prioritare (14 me prioritet shumë të lartë, 28 me prioritet të lartë dhe 9 me prioritet të mesëm) për të përballuar risqet nga ndryshimet klimatike.

Procesi i hartimit të Planit të Përshtatjes

- a) Mbledhja dhe rishikimi i të dhënave në nivel lokal.
- b) Hartimi i skenarëve klimatik.
- c) Vlerësimi i ekspozimit të 5 sektorëve prioritare ndaj rrezikut klimatik.
- d) Vlerësimi i ndryshimeve, shkallës së prekjes nga rreziku klimatik.
- e) Vlerësimi i kapaciteteve për përshtatje.
- f) Vlerësimi i riskut për sektorët prioritare, dhe zonat më të prekura, bazuar në evidenca lokale.
- g) Identifikimi dhe prioritizimi i masave të përshtatjes në zonat e identifikuara.

Përfshirja e palëve të interesuara

Stafi i Bashkisë së Drejtorisë së Bujqësisë, Mbrojtjes së Mjedisit, drejtoi procesin e planifikimit të përshtatjes dhe siguroi mbledhjen e të dhënave historike dhe fakteve për vlerësimin e riskut nga perspektiva lokale. Stafi i Bashkisë dhe përfaqësues të institucioneve të tjera u ndërgjegjësuam mbi domosdoshmërinë e planifikimit për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe trajtimin e ndikimeve të tyre për një zhvillim të qëndrueshëm.

Vlerësimi i riskut klimatik për Bashkinë Vlorë është kryer për pesë fusha prioritare sektoriale: bujqësi, turizëm, energji, transport dhe zhvillim urban.

Ky vlerësim është kryer bazuar në evidenca dhe ngjarje historike të lidhura me ndryshimet klimatike, duke analizuar ekspozimin nga rreziqet klimatike dhe ndryshimet në kontekstin vendor, analizimin e kapaciteteve përshtatëse të bashkisë ndaj ndryshimeve të klimës, nëpërmjet konsultimeve me palët e interesit.

Rreziqet nga ndryshimet klimatike

Thatësitrat: Do sjellin vështirësi në furnizimin me ujë dhe energji deri në vitet 2050 dhe vështirësi të theksuara deri në vitet 2100.

Përmbytjet: Intensiteti i reshjeve dhe erozioni i lumenjve do shtojë përmbytjet, që mund të rrezikojnë jetën e banorëve, dëmtojnë pronën dhe infrastrukturën përfshirë dhe shërbimet e menaxhimit të ujërave.

Zjarret masive: Temperaturat ekstreme mund të favorizojnë përhapjen e zjarreve në pyje.

Rritja e nivelit të detit:

Ndryshimi i nivelit të detit mund të sjellë një sërë rreziqesh për Bashkinë e Vlorës

- Ndryshimet në regjimin hidrologjik dhe thatësira mund të prekin biodiversitetin, duke shkaktuar depërtimin e ujërave të kripura dhe kolonizimin nga specie të reja.
- Depërtimi i ujërave të kripura në tokat bujqësore mund të ulë prodhimin bujqësor.
- Rritja e nivelit të detit mund të shkaktojë përmbytje në zona prej 7,000ha, 9,000 ha, dhe 9,250 ha sipas niveleve të ndryshme të rritjes (33 cm, 90 cm, dhe 100 cm).
- Rritja e nivelit të detit mund të përshpejtojë erozionin bregdetar, veçanërisht në Pyllin e Sodës.
- Zonat bregdetare në lartësi të ulët do të përballen me erozion dhe përmbytje të

intensifikuar.

Objektivat e Planit të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike.

- a) Ujlen e rreziqeve dhe cënueshmërisë ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike në të gjithë Shqipërinë, përmes planifikimit afatmesëm dhe afatgjatë për përshtatjen në nivel kombëtar dhe vendor.
- b) Fuqizimin e kapaciteteve institucionale dhe rritjen e aftësive teknike të palëve të interesuara për analizimin e informacionit klimatik
- c) Vlerësimin e rrezikut dhe cënueshmërisë në nivel vendor të bazuar në fakte
- d) Kuptimin e ndikimit të mundshëm të klimës në sektorët prioritarë.
- e) Identifikimin dhe prioritizimin e mundësive për përshtatje.

Disa nga masat përshtatëse me prioritet shumë të lartë janë:

- Forcimi i kuadrit ligjor, institucional dhe rritja e financimit për përshtatjen ndaj klimës.
- Rritja e kapacitetit shkencor, teknik dhe shoqëror që synon gjenerimin e provave shkencore për të mbështetur vendimmarrjen, identifikimin e zonave me risk të lartë, rritjen e ndërgjegjësimit dhe zbatimin e programeve të trajnimit për përshtatjen ndaj klimës.
- Zhvillimi dhe zbatimi i ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit për zonat e mbrojtura (si lumi i Vjosës, laguna e Nartës dhe laguna e Orikumit) dhe efektet e ndryshimeve klimatike në to.
- Mbrojtja e infrastrukturës së banesave, aseteve dhe pronave bashkiake dhe prodhimit, për të parandaluar dëmtimin dhe degradimin e mëtejshëm nga faktorët klimatikë.
- Vlerësimi i rreziqeve potenciale për infrastrukturën rrugore dhe integrimi i pjesëve të rrjetit që duhen përmirësuar në proceset vendimmarrëse.
- Përshtatja e sektorëve prioritarë ekonomikë (Bujqësia, Transporti, Energjia, Zhvillimi Urban, Turizmi).
- Incentivizimi i komuniteteve për të marrë pjesë në projekte për zvogëlimin e konsumit të energjisë dhe për përmirësimin e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes për të përballuar erërat më të fuqishme dhe të shpeshta.
- Forcimi i menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë.
- 8 masa për përshtatjen e mjedisit natyror bazuar në qasje të integruara të bazuara në ekosisteme (EbA), dhe zgjidhjeve të bazuara në natyrë (NbS) dhe/ose të ndërhyrjeve inxhinierike.

Masat për zbatimin e Planit të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike përfshihen:

Hartimi dhe zbatimi i masave për të luftuar erozionin e bregdetit në “Pyllin e Sodës.

Restaurimi i zonave të degraduara dhe zonave pyjore të djegura nga zjarret (Llogara, Karaburun, pylli i Pishë-Poros, etj.). Ndërhyrjet në pyllëzimin në fshatin “Dukat i Vjetër” për të rikuperuar pyllin e dëmtuar.

Zbatimi i masave përmes qasjes NbS, për mbrojtjen nga erozioni i tokave bujqësore në fshatin Trevllazër, erozionin e tokës në basenin lumor të Shushicës.

Restaurimi i shtresave pyjore midis sipërfaqeve bujqësore, Dukat i Ri, Tragjas Radhimë, për krijimin e mikrohabiteteve dhe mbrojtjen e kulturave bujqësore nga erërat e forta.

Ngritja e fidanishteve pyjore në fshatrat Dukat, Kaninë dhe Tragjas për kultivimin dhe furnizimin e qëndrueshëm të fidanëve vendas të përshtatur me kushtet klimatike vendore.

Përmirësimi i kullotave dhe përdorimi i specieve vendase, nëpërmjet farërave të

grumbulluara në zonat përkatëse Karaburun, Dukat, Tragjas, Shashicë, Kaninë, etj.
Mirëmbajtja e kanaleve të brëndshme dimërore e verore, si dhe rindërtimi i 2 stacioneve të pompimit në Akërnj dhe Orikum, për të siguruar kontrollin e prurjes së rregullt të ujit në Lagunat e Nartës dhe Orikumit.

KRYETAR

Ermal Dredha





BASHKIA VLORE

MIRATOI

KRYETAR

Ermal Dredha



**PLANI I PËRSHTATJES NDAJ
NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NË
BASHKINË VLORE**

2024



Bashkia Vlorë

Plani Vendor i Përshtatjes

Mars 2024

Deklaratë e rëndësishme

Përparimi i planifikimit të përshtatjes afatmesme dhe afatgjatë të Shqipërisë, përmes zhvillimit të një procesi të Planifikimit Kombëtar të Përshtatjes (PKP), është projekt i GEF-së financuar nga UNDP-ja. Përfituesi i drejtpërdrejtë i projektit është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e Shqipërisë. Projekti zbatohet nga Zyra Vendore e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Shqipëri. Pikëpamjet dhe komentet në këtë material nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e institucioneve të lartpërmendura.

Tabela e përmbajtjes

| | |
|---|-----------|
| TABELA E PËRMBAJTJES | 2 |
| LISTA E SHKURTESAVE | 4 |
| 1 HYRJE | 7 |
| 1.1 RËNDËSIA E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE | 7 |
| 1.2 FUNKSIONET E PVP-SË | 7 |
| 1.3 KUADRI POLITIK DHE INSTITUCIONAL PËR PLANIFIKIMIN E PËRSHTATJES | 8 |
| 1.4 PËRMBLEDHJE E ORGANIZIMIT TË PVP-SË | 8 |
| 2 RRETHANAT VENDORE | 10 |
| 2.1 TIPARET GJEOGRAFIKE | 10 |
| 2.1.1 <i>Tiparet vendore</i> | 11 |
| 2.1.2 <i>Zonat urbane</i> | 12 |
| 2.1.3 <i>Tiparet ekologjike</i> | 14 |
| 2.2 EKONOMIA DHE TRAJEKTORJA EKONOMIKE | 16 |
| 2.2.1 <i>Bazat e ekonomisë</i> | 16 |
| 2.2.2 <i>Treguesit ekonomikë (PBB-ja, etj.)</i> | 17 |
| 2.2.3 <i>Trajektorja për të ardhmen dhe prioritetet e zhvillimit ekonomik të bashkisë</i> | 18 |
| 2.3 KUSHTET SOCIO-EKONOMIKE | 19 |
| 2.3.1 <i>Varfëria</i> | 19 |
| 2.3.2 <i>Treguesit shëndetësorë</i> | 19 |
| 2.3.3 <i>Treguesit arsime</i> | 21 |
| 2.4 PROFILET E SEKTORËVE PRIORITARË | 22 |
| 2.4.1 <i>Bujqësia</i> | 22 |
| 2.4.2 <i>Zhvillimi urban</i> | 23 |
| 2.4.3 <i>Turizmi</i> | 24 |
| 2.4.4 <i>Energjia</i> | 25 |
| 2.4.5 <i>Transporti</i> | 26 |
| 3 QEVERISJA DHE KUADROT RREGULLATORE DHE POLITIKAT, PLANET E PROGRAMET PËRKATËSE..... | 28 |
| 3.1 PROFILI I QEVERISJES NË VJORË | 28 |
| 3.2 OBJEKTI I PLANIT VENDOR TË PËRSHTATJES | 28 |
| 3.3 LIDHJET ME STRATEGJINË KOMBËTARE TË ZHVILLIMIT/KUADRIN E PLANIFIKIMIT | 29 |
| 4 PROCESET QË MBËSHTESIN HARTIMIN E PLANIT VENDOR TË PËRSHTATJES..... | 30 |
| 4.1 ORGANIZIMI I NEVOJSHËM INSTITUCIONAL PËR PROCESIN E PVP-SË..... | 30 |
| 4.2 PROCESET E ANGAZHIMIT TË PALËVE TË INTERESIT | 31 |
| 4.3 KËRKOHET INFORMACION SHITESË/RREGULLIM INSTITUCIONAL PËR PROCESIN E LAP. | 31 |
| 5 INFORMACIONI MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE | 32 |
| 5.1 PËRKUFIZIMI I TERMAVE KYÇ..... | 32 |
| 5.2 INFORMACIONI MBI KLIMËN | 33 |
| 5.2.1 <i>Ndryshimet aktuale klimatike në Shqipëri</i> | 33 |
| 5.2.2 <i>Parashikimet për të ardhmen për Shqipërinë</i> | 35 |
| 5.2.3 <i>Rreziqet</i> | 39 |
| 5.3 QASJA E VLERËSIMIT TË RISKUT DHE CENUESHMËRISË..... | 40 |
| 5.4 DISPONUESHMËRIA DHE NEVOJA PËR TË DHËNA | 43 |

| | | |
|----------|---|-----------|
| 6 | NDIKIMET SEKTORIALE | 44 |
| 6.1 | HAPI 1: VLERËSIMI I NDRYSHIMEVE KLIMATIKE AKTUALE DHE TË ARDHSHME | 44 |
| 6.2 | HAPI 2: IDENTIFIKIMI I RISKUT..... | 47 |
| 6.3 | <i>Hapi 3: Pikëzimi i riskut.....</i> | 48 |
| 6.4 | <i>Analiza sektoriale dhe mundësitë për Bashkinë Vlorë.....</i> | 49 |
| 6.4.1.1 | <i>Risqet nga temperaturat më të larta</i> | 51 |
| 6.4.1.2 | <i>Mundësitë lidhur me rritjen e temperaturave.....</i> | 52 |
| 6.4.1.3 | <i>Risqet nga reshjet intensive</i> | 52 |
| 6.4.2 | <i>Infrastruktura</i> | 53 |
| 6.4.2.1 | <i>Risqet për infrastrukturën nga temperaturat më të larta në verë</i> | 53 |
| 6.4.2.2 | <i>Risqet për infrastrukturën nga ndryshimet e reshjeve.....</i> | 53 |
| 6.4.3 | <i>Biznesi (përfshirë turizmin, bujqësinë dhe pylltarinë).....</i> | 54 |
| 6.4.3.1 | <i>Rreziqet për biznesin nga temperaturat dhe reshjet e shtuara dhe pakësuara.....</i> | 55 |
| 6.4.3.2 | <i>Mundësitë për bizneset.....</i> | 56 |
| 6.4.3.3 | <i>Risqet dhe mundësitë për turizmin.....</i> | 56 |
| 6.4.3.4 | <i>Industritë e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit.....</i> | 57 |
| 6.4.4 | <i>Risqet për natyrën.....</i> | 58 |
| 6.4.4.1 | <i>Risqet dhe mundësitë për speciet tokësore në Bashkinë Vlorë.....</i> | 58 |
| 6.4.4.2 | <i>Risqet dhe mundësitë për tokat dhe për speciet e ujërave të ëmbla</i> | 59 |
| 6.4.4.3 | <i>Risqet dhe mundësitë nga ndryshimet klimatike në karakterin e peizazhit.....</i> | 61 |
| 6.4.5 | <i>Asetet dhe veprimtaritë e bashkisë.....</i> | 61 |
| 6.4.5.1 | <i>Risqet për asetet në pronësi të bashkisë ose që mirëmbahen nga Bashkia Vlora.....</i> | 61 |
| 6.5 | <i>Përfundimet.....</i> | 62 |
| 7 | PLANI VENDOR I VEPRIMIT | 64 |
| 7.1 | <i>Qëllimi i Planit Vendor të Veprimit.....</i> | 64 |
| 7.1.1 | <i>Konteksti i këtij plani për Bashkinë Vlorë</i> | 64 |
| 7.2 | <i>Procedura dhe kriteret e priorizimit</i> | 65 |
| 7.3 | QEVERISJA, MONITORIMI DHE VLERËSIMI | 78 |
| 7.3.1 | <i>Përfaqësimi.....</i> | 78 |
| 7.3.2 | <i>Zbatimi</i> | 78 |
| 7.3.3 | <i>Raportimi.....</i> | 78 |
| 8 | SHTOJCAT..... | 79 |
| | SHTOJCA I: QASJA E PALËVE TË INTERESIT LIDHUR ME PËRGATITJEN E PLANIT VENDOR TË VLORËS PËR PËRSHTATJE | 79 |
| | SHTOJCA II: PARASHIKIMET PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE | 81 |
| | SHTOJCA III: INTEGRIMI I VLERËSIMEVE TË CENUESHMËRISË DHE TË RISKUT | 82 |
| | SHTOJCA IV: KRITERET E PIKËZIMIT TË RISKUT | 84 |
| | SHTOJCA V: LISTA E MASAVE TË PËRSHTATJES TË PROPOZUARA | 85 |
| | A.1 <i>Qeverisja, monitorimi dhe vlerësimi.....</i> | 85 |
| | A.2 <i>Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar nga njeriu.....</i> | 88 |
| | A.3 <i>Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar.....</i> | 94 |
| | A.4 <i>Biznesi dhe industria</i> | 98 |
| | A.5 <i>Mjedisi natyror.....</i> | 101 |
| | A.6 <i>Asetet dhe veprimtaritë e bashkisë</i> | 106 |
| | SHTOJCA VI: METODOLOGJIA PËR PRIORITIZIMIN E MASAVE PËR PËRSHTATJE..... | 109 |

Lista e shkurtesave

VKM – Vendimi i Këshillit të Ministrave

EbA – Përshtatje e bazuar në ekosistem

GES - Gazet me efekt serrë

HEC - Hidrocentral

U&K - Ujitje dhe Kullim

PINS – Plani i Integruar Ndërsektorial

INSTAT – Instituti Kombëtar i Statistikave

PVZH – Plani i Përgjithshëm Vendor i Zhvillimit

GLN – Gaz i lëngëzuar i naftës

PM – Procesverbalet e mbledhjeve

MTM - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

BMA - bimë mjekësore dhe aromatike

PKP - Plani Kombëtar i Përshtatjes

AKZM – Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

NbS – Zgjidhje të bazuara në natyrë

KKP - Kontribut Kombëtar i Përcaktuar

AKM - Agjencia Kombëtare e Mjedisit

AREB - Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor

ARZM – Agjencia Rajonale e Zonave të Mbrojtura

PVEQ – Plani Bashkiak i Veprimit për Energjinë e Qëndrueshme

PLUQ – Plani i Lëvizshmërisë Urbane të Qëndrueshme

TCI – Indeksi i Klimës së Turizmit

TeR – Termat e Referencës

UNDP – Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

KKKBK – Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike

UNESCO – Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë

Lista e tabelave

| | |
|--|----|
| Tabela 2.1 _ Nxënësit e regjistruar në nivelet arsimore në Bashkinë Vlorë | 21 |
| Tabela 2.2 _ Të dhënat për infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit në Bashkinë Vlorë (2022) | 22 |
| Tabela 3.1 _ Përmbledhje e Objektivave Strategjike të PVZH-së së Vlorës në lidhje me sektorët prioritarë të PKP-së | 29 |
| Tabela 4.1 _ Burime njerëzore të dedikuara që mbulojnë sektorët prioritarë të PKP-së në Bashkinë Vlorë | 30 |
| Tabela 4.2_ Burimet njerëzore të dedikuara që mbulojnë funksionet mbështetëse të PNK-së në Bashkinë Vlorë | 31 |
| Tabela 5.1 _ Luhatjet e vlerave mesatare vjetore të temperaturës dhe reshjeve..... | 33 |
| Tabela 5.2 _ Qasja e vlerësimit | 41 |
| Tabela 5.3 _ Matrica e Ndjeshmërisë e Shqipërisë | 41 |
| Tabela 5.4 _ Kapaciteti për përshtatje i Shqipërisë..... | 42 |
| Tabela 5.5 _ Matrica e cenueshmërive aktuale të Shqipërisë ndaj riskut | 42 |
| Tabela 6.1 _ Qasja ndaj grupimit sipas sektorëve | 49 |
| Tabela 6. 2_ Vlerësimi Përfundimtar Sektorial për bashkitë | 50 |
| Tabela 6.3 _ Përmbledhje e risqeve ndaj shëndetit dhe komuniteteve nga temperaturat e larta të verës dhe pikëzimi përkatës | 51 |
| Tabela 6.4 _ Mundësitë e identifikuar që vijnë si pasojë e rritjes së temperaturave gjatë verës dhe dimrit | 52 |
| Tabela 6.5 _ Risqet për shëndetin dhe komunitetet nga reshjet intensive..... | 52 |
| Tabela 6.6 _ Risqet në shëndet dhe komunitet nga rritja e temperaturave | 53 |
| Tabela6. 7_ Risqet për infrastrukturën nga ndryshimet e reshjeve dhe pikëzimi i tyre | 53 |
| Tabela 6.8 _ Risqet e identifikuar për biznesin nga temperaturat më të larta dhe pikëzimi i tyre..... | 55 |
| Tabela 6.9 _ Mundësitë për bizneset | 56 |
| Tabela 6.10 _ Risqet e identifikuar për speciet tokësore në Bashkinë Vlorë dhe pikëzimi i tyre | 58 |
| Tabela 6.11_ Mundësitë për speciet tokësore..... | 59 |
| Tabela 6.12_ Risqet e identifikuar për tokat, rezervat e karbonit dhe speciet e ujërave të ëmbla | 60 |
| Tabela 6.13_ Mundësitë për habitatet e ujërave të ëmbla | 61 |
| Tabela 6.14 _ Risqet nga ndryshimet klimatike në karakterin e peizazhit dhe pikëzimi i tyre | 61 |
| Tabela 6.15_ Mundësitë për peizazhin..... | 61 |
| Tabela 6.16_ Risqet e identifikuar për tokat, rezervat e karbonit dhe speciet e ujërave të ëmbla | 61 |
| Tabela 7.1 _ Masat/veprimet e mundshme prioritare për përshtatje | 71 |
| Tabela 8.1 _ Qasje për përgatitjen e Planit të Vlorës për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike.... | 79 |
| Tabela 8.2 _ Rritja e parashikuar e temperaturës globale sipas skenarëve të ndryshëm | 81 |
| Tabela 8.3 _ Shkalla e ndjeshmërisë | 82 |

| | |
|---|----|
| Tabela 8.4 _ Shkalla e ceneshmërisë..... | 82 |
| Tabela 8.5 _ Kriteret e pikëzimit të riskut | 84 |

Lista e figurave

| | |
|---|----|
| Figura 2.1 _ Harta administrative e Bashkisë Vlorë..... | 10 |
| Figura 2.2 _ Prirja e popullsisë sipas grupmoshave (meshkuj dhe femra) në Bashkinë Vlorë (2018-2022)..... | 11 |
| Figura 2.3 _ Shpërndarja e popullsisë në Bashkinë Vlorë (2021) | 12 |
| Figura 2.4 _ Gjenerimi i mbetjeve në Bashkinë Vlorë (2016 – 2021) | 13 |
| Figura 2.5 _ Prirjet e prodhimit të sektorit ekonomik në Bashkinë Vlorë (2017-2021) | 18 |
| Figura 2.6 _ Prirjet e tejkalimeve të ndotësve të ajrit në Bashkinë Vlorë (2012-2021)..... | 20 |
| Figura 2.7 _ Përqendrimi i ndotësve të ajrit në Bashkinë Vlorë (2012-2021)..... | 20 |
| Figura 2.8 _ Vizitorë në Parqet Kombëtare Llogara dhe Karaburun-Sazan (2018-2022)..... | 24 |
| Figura 5.1 _ Shpërndarja e temperaturave mesatare vjetore | 34 |
| Figura 5.2 _ a) shpërndarjavjetore e Tmaks mesatare vjetore; b) shpërndarja mujore të temperaturave mesatare vjetore..... | 34 |
| Figura 5.3 _ Shpërndarja e reshjeve vjetore (1951 – 2010)..... | 35 |
| Figura 5.4 _ Ndryshimi botëror i temperaturës së sipërfaqes në krahasim me periudhën 1850 – 1900 | 36 |
| Figura 5.5 _ Shpërndarja e ndryshimeve të Tmaks gjatë verës deri në vitin 2050 | 37 |
| Figura 5.6 _ Ndryshimet e pritshme në vlerat e Tmes sezonale në Vlorë | 37 |
| Figura 5.7 _ Ndryshime të mundshme në reshjet e verës në Vlorë | 38 |
| Figura 5.8 _ Ndryshime të mundshme në nivelin e detit, SSPx-y të ndryshme, Deti Adriatik | 39 |
| Figura 5.9 _ Metodologjia..... | 40 |
| Figura 6.1 _ Grafiku që tregon panoramën e përgjithshme të metodologjisë | 44 |
| Figura 6.2 _ Përmbytja nga rritja e nivelit të ujit në lumin Vjosa (periudha e kthimit një herë në 100 vjet)..... | 46 |
| Figura 6.3 _ Përmbytje nga rritja e pritshme e nivelit të detit..... | 47 |
| Figura 7.1 _ Vendndodhjet për EbA, NbS dhe/ose ndërhyrjet inxhinierike | 68 |
| Figura 7.2 _ Zgjidhje të bazuara te natyra (NbS) dhe/ose ndërhyrje inxhinierike për të luftuar erozionin e tokës në fshatin Trevllazër..... | 69 |
| Figura 7.3 _ Masa për të restauruar zonat e degraduara dhe zonat pyjore të djegura nga zjarret..... | 70 |

1 Hyrje

1.1 Rëndësia e ndryshimeve klimatike

Popullsia e Shqipërisë, kryesisht rurale, është shumë e ndjeshme ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, ku reshjet ekstreme shpesh sjellin përmbytje shkatërrimtare, ndërsa jetesa e bazuar në bujqësi dhe disponueshmëria e ujit të pijshëm kërcënohen gjatë thatësirave. Me rritjen e temperaturave, skenarët klimatikë parashikojnë rritjen e intensitetit dhe shpeshtësisë së këtyre kushteve ekstreme të lagështirës dhe thatësirave, së bashku me pakësimin e reshjeve të përgjithshme vjetore të shiut. Këto ndryshime sjellin risk për popullsinë e Shqipërisë dhe kërcënojnë industrinë hidroenergjetike nga burimet hidrike dhe të turizmit.

Shqipëria është e ekspozuar ndaj fatkeqësive dhe rreziqeve, shumica e të cilave (90%) janë përmbytje, vërshime dhe zjarre pyjore të shkaktuara kryesisht nga kushtet hidrologjike dhe meteorologjike. Për shkak të pozicionit të saj bregdetar, Shqipëria renditet ndër vende që përballen me risqe të mëdha klimatike.

Zhvillimi aktual socio-ekonomik e rrit edhe më shumë cenueshmërinë e vendit. Indeksi ND-GAIN për Vendet¹ për vitet 2020 dhe 2021 mati dimensionet e cenueshmërinë dhe gatishmërinë, në bazë të të cilave u renditën vendet në mbarë botën. Nga 182 vendet e vlerësuara në vitin 2021, Shqipëria u rendit e 80-ta për rezultatin e kombinuar ND-GAIN. Ajo u rendit në vendin e 78-të sa i përket cenueshmërisë dhe në vendin e 96-të sa i përket gatishmërisë.

Njohuritë për ndikimet dhe cenueshmëritë e ndryshimeve klimatike në Shqipëri vijnë si rezultat i punës në kuadër të Komunikimit Kombëtar të Parë (2002), të Dytë (2009), të Tretë (2016) dhe të Katërt (2022) në KKKBNK, dhe tregojnë se cenueshmëria e vendit mbetet mjaft e lartë. Me qëllim trajtimin e këtyre cenueshmërive, Qeveria e Shqipërisë nisi procesin e saj për planin e dytë kombëtar të përshtatjes (PKP) në vitin 2021 në sektorët prioritarë të turizmit, zhvillimit urban, bujqësisë, transportit dhe energjisë, dhe Planet e para Vendore të Përshtatjes (PVP) për 8 bashki: Vlorë, Fier, Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Përmet, Kukës, Krujë.

PVP-të janë hartuar në bashkëpunim me personelin e bashkive, përmes ngritjes së bazës së fakteve për PNK-në, sigurimit të zhvillimit të kapaciteteve dhe hartimit të planit të bashkërenduar të veprimit për ulje risku dhe investime afatgjata lidhur me PNK-në në bashkitë përkatëse.

1.2 Funkzionet e PVP-së

Procesi i Planit Vendor të Përshtatjes (PVP), ashtu si edhe procesi i Planit Kombëtar të Përshtatjes (PKP), “shihet si mënyrë më e mirë për të punuar, duke marrë plotësisht në konsideratë problematikat e ndryshimeve klimatike gjatë proceseve të planifikimit dhe vendimmarrjes. Ai do të përfshijë të gjitha organizimet e nevojshme për zhvillimin e njohurive në mbështetje të vendimmarrjes, si dhe të kapaciteteve të nevojshme për ndërmarrjen e të gjitha veprimeve në kuadër të procesit strategjik të vendit për planifikimin e përshtatjes”.

KKKBNK-ja promovoi Planet Kombëtare të Përshtatjes (PKP) në nivel ndërkombëtar për t'i ndihmuar vendet të hartojnë, bashkërendojnë, zbatojnë dhe monitorojnë më mirë përpjekjet për trajtimin e risqeve klimatike. Elementi më i rëndësishëm është se procesi i PKP-së synon të ngriejë sistemet dhe

¹ Indeksi ND-GAIN i Vendeve përmbledh cenueshmërinë e një vendi të caktuar ndaj ndryshimeve klimatike dhe sfidave të tjera botërore kombinuar me gatishmërinë e tij për të përmirësuar aftësitë ripërtëritëse. Indeksi synon të ndihmojë qeveritë, bizneset dhe komunitetet t'u japin më shumë prioritet investimeve që i përgjigjen në mënyrë më efektive sfidave aktuale botërore. Për sa i përket renditjes botërore sipas Indeksit ND-GAIN, sa më lart në renditje, aq më e mirë është situata.

kapacitetet e nevojshme për integrimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në planifikimin për zhvillim, vendimmarrje dhe buxhetim.

PVP-të hartohen në mënyrë që bashkia të mund ta monitorojë dhe rishikojë atë rregullisht, si dhe ta përditësojë herë pas here bazuar në të dhëna dhe parashikime klimatike të reja dhe/ose më cilësore, si dhe në informacione të tjera të dobishme për procesin e planifikimit. PVP-ja duhet të identifikojë vazhdimisht mangësitë në kapacitete dhe përshtatje dhe të planifikojë trajtimin e tyre. Gjithashtu, ajo duhet të integrojë në proces pikëpamjen gjinore me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë të burrave dhe grave në proceset vendimmarrëse, si dhe në zbatimin e veprimtarive të përshtatjes. Për më tepër, duhet të sigurohet që procesi i PVP-së dhe veprimtaritë e tij të mos përkeqësojnë pabarazitë gjinore. Këto plane mund të rezultojnë në përshtatje më të mirë dhe komunitete me aftësi më të mira ripërtëritëse.

1.3 Kuadri politik dhe institucional për Planifikimin e Përshtatjes

Si Palë e KKKBNK-së, Shqipëria angazhohet ndaj Procesit të Planifikimit të PNK-së. Ky angazhim bëhet i qartë në Dokumentin Strategjik dhe Planet Kombëtare për Ndryshimet Klimatike (si të Zbutjes ashtu edhe Përshtatjes) (2019), legjislacionin për ndryshimet klimatike (2020), dokumentin e KKP-së (2021), Komunikimin e 4-t Kombëtar (2022), BUR-in e 1-rë (2022), etj., si dhe në një sërë marrëveshesh dhe angazhimesh ndërkombëtare ose rajonale.

Dokumentet e politikave që përcaktojnë përgjegjësi për qeverisjen kombëtare dhe vendore lidhur me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike janë dokumenti i PKP-së i Shqipërisë, e miratuar me VKM nr. 466, datë 03.07.2019 dhe Ligji nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”.

Në shtator të vitit 2021, Shqipëria i paraqiti PKP-në e saj të parë KKKBNK-së, përfshirë edhe një strategji gjithëpërfshirëse financimi. Për shkak të mangësive financiare të pranura që prej nisjes së hartimit, PKP-ja e parë është zbatuar pjesërisht. Aktualisht, Shqipëria po përgatit PKP-në e dytë, nën bashkërendimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, me pjesëmarrjen e palëve të interesit dhe kontributin e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Ndryshimet Klimatike (GNPNK).

1.4 Përmbledhje e organizimit të PVP-së

Përveç kësaj hyrjeje, dokumenti i PVP-së i Bashkisë Vlorë organizohet në 6 kapituj.

Kapitulli 2 paraqet **rrethanat vendore të Bashkisë Vlorë**, duke përfshirë gjeografinë, sektorët ekonomikë prioritarë dhe situatën e dinamikën socio-ekonomike në territorin e saj, teksa jep informacion për pesë sektorët prioritarë të PKP-së.

Sistemi i qeverisjes i Bashkisë Vlorë dhe angazhimi i saj për përshtatje trajtohen në **Kapitullin 3**. Ndërkohë që në nivel kombëtar mekanizmat janë disi më të zhvilluara, integrimi i problematikave të ndryshimeve klimatike dhe të përshtatjes në Bashkinë Vlorë, sipas detyrave që i ngarkohen qeverisjes vendore nga Ligji “Për ndryshimet klimatike”, nuk është kryer për shkak të mungesës së njohurive, burimeve njerëzore, teknike dhe financiare.

Procesi i Planit Vendor të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike, përfshirë angazhimin e palëve të interesit në Bashkinë Vlorë, trajtohet në **Kapitullin 4**. Në nivelin vendor nuk ka marrëveshje të rregullta institucionale, mekanizma bashkërendimi dhe procedura konsultimi me palët e interesit.

Kapitulli 5 trajton informacionin mbi ndryshimet klimatike. Ai nis me përkufizimin e termave të përdorur në këtë plan dhe vijon me rëndësinë e mbledhjes së të dhënave dhe informacionit për vlerësimin e cenueshmërive klimatike. Ai siguron informacion mbi variablat e shumta të klimës, mënyrën se si ato do të ndryshojnë gjatë shekullit, luhatjen e mundshme të këtyre ndryshimeve në skenarë të ndryshëm të klimës dhe se si këto ndryshime mund të dallojnë nga njëra-tjetra.

Ndikimet e mundshme sektoriale të ndryshimeve klimatike për Bashkinë Vlorë trajtohen në **Kapitullin 6**.

Kapitulli 7 trajton **Planin Vendor të Veprimit për Bashkinë Vlorë**, të hartuar bazuar në vlerësimin e riskut klimatik të Vlorës, si dhe në identifikimin dhe prioritizimin e masave për përshtatje.

2 Rrethanat vendore

2.1 Tiparet gjeografike

Vlora është qyteti i tretë më i madh dhe një bashki në Shqipëri. Bashkia shtrihet nga grykëderdhja e lumit Vjosa në veri, deri në Parkun Kombëtar të Llogarasë në jug, me mbi 90 km vijë bregdetare në bregun verior të Detit Mesdhe, Detit Adriatik dhe Jon. Qendra e bashkisë është qyteti i Vlorës, një nga qytetet më të rëndësishme të Shqipërisë jugperëndimore për sa i përket kulturës dhe ekonomisë. Qyteti ka dalje direkte në det dhe mbrojtje natyrore falë maleve dhe kodrave. Ky pozicion i favorshëm gjeografik përfordhet nga vendndodhja e tij midis rrugëve tokësore, detare dhe ajrore që e lidhin lehtësisht me pjesën tjetër të vendit dhe më gjerë (Figura 2.1). Bashkia shtrihet në një territor prej 617 km², duke zënë rreth 2.2% të sipërfaqes së përgjithshme të vendit.

Figura 2.1 _ Harta administrative e Bashkisë Vlorë



Burimi: Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)

2.1.1 Tiparet vendore


Bashkia e Vlorës është e veçantë në krahasim me bashkitë e tjera, pasi paraqet një bilanc pozitiv të lëvizjes migratore, ndërkohë që lëvizjet e popullsisë si jashtë ashtu dhe brenda bashkisë nuk kanë ndikuar në numrin e përgjithshëm të popullsisë.²

Shumica dërrmuese e popullsisë³ (77%) së qarkut të Vlorës banon në Bashkinë Vlorë, ku 71% e kësaj popullsie jeton në qytetin e Vlorës, siç tregohet në Figura 2.3. Ky përqendrim i lartë i popullsisë po ndikon në burimet e bashkisë dhe duhet të jetë në fokus të politikave të përgjithshme të zhvillimit të bashkisë dhe të politikave të planifikimit urban në veçanti. Të dhënat tregojnë një rritje graduale të të moshuarve (70-84 vjeç). Kjo prirje kërkon zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve miqësore për këtë grupmoshë për t'iu përgjigjur nevojave në rritje të kësaj demografie. Reduktimi i dukshëm i grupmoshës së të rinjve do të ketë pasoja afatgjata për tregun vendor të punës, gjë që kërkon masa për të nxitur rritjen e familjes ose për të tërhequr punëtorë të rinj me qëllim ruajtjen e fuqisë punëtore të ekuilibruar.

Analiza e të dhënave demografike të Bashkisë Vlorë (të dhënat e INSTAT-it kombinuan të dhënat e bashkisë dhe të prefekturës⁴) për vitet e fundit (periudha 2018 – 2022) tregon një zhvendosje demografike me një rënie të vazhdueshme të popullatës më të re (grupmosha 0-9 vjeç). Njëkohësisht, ka një rritje të lehtë të popullsisë së të moshuarve (mosha 85+), çka tregon përmirësime të jetëgjatësisë ose kujdes më të mirë shëndetësor. Përgjatë viteve, raporti meshkuj-femra për çdo grupmoshë ka mbetur relativisht i qëndrueshëm (Figura 2.2).

Grupet e moshës së mesme (30-59 vjeç) tregojnë qëndrueshmëri relative për sa i përket numrit. Kjo grupmoshë, me gjasë fuqi punëtore aktive, duhet të jetë në fokus të nismave të zhvillimit ekonomik.


Figura 2.2 _ Prirja e popullsisë sipas grupmoshave (meshkuj dhe femra) në Bashkinë Vlorë (2018-2022)



² ALTAX, Monitorimi shumëdimensional i qeverisjes vendore – Bashkia Vlorë 2021, i disponueshëm në: <https://altax.al/monitorimi-shumedimensional-i-qeverisjes-vendore-bashkia-vlore-2021/>

³ Qarku dhe prefektura e Vlorës përfshin shtatë bashki, konkretisht Vlorën, Selenicën, Himarën, Finiqin, Delvinën, Sarandën dhe Konispolin.


⁴ Të dhënat e bashkisë janë të disponueshme në <https://vlora.gov.al/statistikat-vendore/> dhe të dhënat e prefekturës në <https://qarkuvlore.gov.al/qarku-vlore/#>



Burimi: INSTAT (2018 – 2022)

Popullsia e Bashkisë Vlorë ka qenë pak a shumë e qëndrueshme gjatë viteve 2017-2022. Në qytetin e Vlorës, rritja më e lartë e popullsisë vërehet në rajonet 2 (6%), 3 (8%) dhe 4 (5%). Kjo rritje e popullsisë përkon edhe me rritjen e numrit të familjeve në këto tre rajone (14% në 16%). Në zonat rurale të njësisve administrative Orikum, Qendër, Shushicë dhe Novoselë, rritja e popullsisë ka qenë e qëndrueshme, dhe vetëm njësia administrative Novoselë ka shënuar rritje prej 2% në periudhën 2017-2022. Numri i familjeve është rritur në Orikum (10%), Qendër (10%), Shushicë (12%) dhe Novoselë (10%), gjë që tregon një prirje të brezit të ri për të siguruar jetesën në komunitetet e tyre.

Figura 2.3 _ Shpërndarja e popullsisë në Bashkinë Vlorë (2021)



Burimi: Bashkia Vlorë

Pakicat etnike janë të pranishme në Bashkinë Vlorë, konkretisht pakica greke që jeton në zonën e Nartës dhe pakicat rome dhe egjiptiane që janë vendosur në njësitë administrative Novoselë dhe Shushicë.⁵

2.1.2 Zonat urbane

Përdorimi hapësinor dhe demografia lidhen drejtpërdrejt me tiparet gjeografike të rajonit. Bashkia e Vlorës ka një pozicion strategjik në kryqëzimin midis bregdetit Adriatik dhe Jon. Pas viteve '90, qyteti i Vlorës u rrit dhe u zgjerua kryesisht në jug, përgjatë bregdetit. Përgjatë bregdetit u ndërtuan blloqe të larta banimi për të përmbushur kërkesën “vendore” në rritje për banesa të dyta dhe turistike. Kjo

⁵ Bashkia Vlorë, Plani Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022 (2019), i disponueshëm në: <https://rm.coe.int/local-plan-vlora/1680a1b5c7>

kërkesë është e vazhdueshme pasi qyteti po zgjerohet në drejtim të jugut.

Gjiri i Vlorës njihet për burimet e shumta natyrore, për biodiversitetin dhe korridoret ekologjike, dhe për pasuritë e tij të shumta arkeologjike, historike dhe kulturore. Si i tillë, ky qytet është një nga zonat me potencialin më të lartë turistik në vend, falë edhe daljes së tij në det. Kjo zonë njihet për zhvillimet e saj industriale (për shkak të portit dhe zonave industriale rreth tij, peshkimit), për shërbimet në përgjithësi dhe sektorin e turizmit në veçanti, por edhe për bujqësinë dhe blegtorinë. Gjatësia e vijës bregdetare të qytetit të Vlorës është 90 km.⁶

Zona e gjelbër urbane është shtrihet përgjatë qytetit dhe është përqendruar në pyllin e Sodës (pyll me pisha me sipërfaqe prej 214 ha, i mbjellë në të kaluarën)⁷. Vitet e fundit, ndikimi i ndryshimeve klimatike në gjelbërimin e qytetit u vu re te palmat përgjatë bulevardit kryesor të qytetit, të cilat u infektuan dhe u thanë⁸

Infrastruktura urbane përbëhet nga rrjeti rrugor urban, rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm dhe rrjeti i kanalizimit. Investimet në rrjetet e përgjithshme rrugore kanë qenë të konsiderueshme në vitet e fundit dhe kanë përmirësuar ndjeshëm aksesueshmërinë e bashkisë, si dhe të të gjithë rivierës shqiptare. Megjithatë, nga diskutimi me përfaqësuesit e bashkisë u konstatua se efektet e ndryshimeve klimatike (reshjet e dendura) janë të pranishme veçanërisht në infrastrukturën **rrugore** dhe në segmente të caktuara rrugore. Për rrjedhojë, bypass-i i Vlorës është prekur nga rrëshqitjet e dheut dhe rënia e shkëmbinjve. Po kështu, segmenti rrugor bregdetar Vlorë-Radhimë dhe Dukat-Llogara është prekur nga rënia e shkëmbinjve.⁹

Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve janë të disponueshme, por aksesit në këto shërbime ndryshon ndjeshëm në zonat rurale dhe urbane. Lidhja në rrjetin e ujësjellësit është e disponueshme në nivelin 100% në zonat urbane kundrejt 36% në zonat rurale. Lidhja në rrjetin e kanalizimeve është e disponueshme vetëm për 82% të familjeve në zonat urbane. 70% e rrjetit të kullimit të ujërave të shiut është i rehabilituar dhe funksional. Impianti i trajtimit të ujërave të zeza në Vlorë është funksional.¹⁰ Sfidë mbetet lidhja e të gjitha rrethinave të Vlorës (veçanërisht ajo periferike) në tubacionet kryesore të grumbullimit të ujërave të ndotura.¹¹ Po ashtu, infrastruktura e ujërave të ndotura është e nënzhvilluar në njësinë administrative Orikum (zona urbane, bregdetare dhe disa nga fshatrat).

Bashkia e Vlorës gjeneron rreth 48,000 tonë **mbetje** në vit, me mbetjet organike që zënë pjesën më të madhe (40%).¹² Sasia e mbetjeve është problem në periudhën e verës, kur fluksi i mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga turistët i tejkalon kapacitetet njerëzore dhe teknologjike që disponon Bashkia Vlorë. Të dhënat për mbetjet (2016-2021) tregojnë prirje dhe luhajtje të dukshme në segmente të ndryshme të mbetjeve, siç ilustron Figura 2.4.

Figura 2.4 _ Gjenerimi i mbetjeve në Bashkinë Vlorë (2016 – 2021)

⁶ Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin, 2016, AKPT

⁷ Plani Vendor i Zhvillimit i Vlorës (2016), f. 182


⁸ PM-të me Prefekturën e Vlorës, 8 shtator 2022

⁹ PM-të me Bashkinë Vlorë, 8 shtator 2022

¹⁰ Baza e të dhënave e Bashkisë Vlorë, korrik 2023

¹¹ PM-të me Prefekturën e Vlorës, 8 shtator 2022

¹² Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2023—2028 (2022), f. 28-31, i disponueshëm në: <https://vlora.gov.al/wp-content/uploads/2023/03/PVMIM-Vlore-30.03.2023.pdf>



Burimi: Bashkia Vlorë

Riciklimi i mbetjeve është në nivele shumë të ulëta. Po bëhen investime për të vënë në punë Qendrën e Menaxhimit të Mbetjeve në Sherishtë, me një kapacitet përpunues prej rreth 1.2 milionë tonë mbetjesh. Qendra do të përfshijë një landfill sanitar, sistemin e grumbullimit të gazit, impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura, impiantin e ndarjes së mbetjeve të riciklueshme me kapacitet rreth 55,000 tonë/vit dhe kapacitet kompostimi për mbetjet organike deri në 4,200 tonë/vit.¹³ Gjithashtu, janë planifikuar investime për mbylljen e venddepozitimeve ekzistuese në Vlorë dhe Selenicë dhe për blerjen e makinerive dhe pajisjeve për pastrimin e rrugëve, grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve nga Bashkitë Vlorë dhe Selenicë.¹⁴ Sherishta (landfilli sanitar) është afër përfundimit.

2.1.3 Tiparet ekologjike

Bashkia e Vlorës ka disa **zona** të rëndësishme **natyrore** dhe secila prej tyre luan një rol të rëndësishëm në mbështetjen e ekosistemeve dhe specieve të ndryshme. Bashkia Vlorë ka 5 **zona të mbrojtura** me rëndësi kombëtare dhe 20 **monumente natyrore**. Ndër to, 3 janë parqe kombëtare (Llogoraja, lumi i Vjosës dhe parku detar Karaburun-Sazan), një rezervat natyror i menaxhuar (Karaburun) dhe një peizazh i mbrojtur (Pishë Poro – Nartë). Për më tepër, disa zona brenda territorit të bashkisë kanë përcaktime të veçanta përtej nivelit kombëtar, duke përfshirë territoret që mbulojnë lagunën e Nartës, Llogaranë, Gjirin e Vlorës, Gadishullin e Karaburunit dhe Malin e Çikës, të cilat njihen si Zona të Rëndësishme për Shpendët (ZRS), Zona Kryesore të Biodiversitetit (ZKB), dhe vende kandidatë për rrjetin Emerald. Për më tepër, Zona e Mbrojtur Detare Karaburun-Sazan ka statusin e Zonave të Mbrojtura të Veçanta me Rëndësi Mesdhetare (SPAMI).

Të gjitha këto zona janë të lidhura me njëra-tjetrën nga pikëpamja socio-ekonomike, nëpërmjet aktiviteteve në zhvillim që kryhen në rajon, por edhe nga pikëpamja biologjike, nëpërmjet habitateve dhe ekosistemeve që përfshihen në të gjitha ato zona, nëpërmjet mënyrës se si këto habitate ndërveprojnë dhe mbështeten në burimet detare dhe tokësore, si dhe nëpërmjet kushteve të mikroklimës. Sipas kësaj qasjeje, kompleksi natyror Karaburun-Llogara-Mali i Çikës dhe peizazhi i mbrojtur i Pishë Poro-Nartës janë elementi qendror për ruajtjen e natyrës, ndërkohë që qyteti i Vlorës është elementi qendror i zhvillimit.

Efektet e ndryshimeve klimatike janë të pranishme dhe ndikojnë në biodiversitetin e pasur të zonave

¹³ Këto investime janë pjesë e “Programit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane në Vlorë”, projekt i mbështetur nga Bashkëpunimi Gjermano-Shqiptar nëpërmjet Bankës për Zhvillim KfW.

¹⁴ Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve për Qarkun e Vlorës 2023—2028 (2022), f. 10

të mbrojtura. Temperatura e lartë dhe thatësira prekin lagunën e Nartës, niveli i ujit të së cilës luhet për shkak të avullimit dhe mungesës së mirëmbajtjes së kanaleve të komunikimit, si dhe funksionimit të kriporeve të Nartës.¹⁵ Nivelet e ngritura të PO_4 në lagunën e Nartës tregojnë pasurim me lëndë ushqyese dhe kërkojnë vëmendje për të parandaluar lulëzimin e algave dhe eutrofikimin. Kjo ka frenuar migrimin e flamingove të pranishëm në lagunën e Nartës, ndërsa në lagunat e Nartës dhe Orikumit vërehet prani e specieve invazive, si gaforja blu. Kjo specie, e cila shumohet shpejt, ka ndikuar në riprodhimin e specieve të tjera në të dyja lagunat, dhe rrjedhimisht edhe në stokun e peshkut dhe potencialin për peshkim në këto laguna; gjithashtu, peshqit nuk u nënshtrohen cikleve të tyre të riprodhimit biologjik për shkak të rritjes së temperaturës së ujit, çka sjell ndikim në ekonominë e të gjithë bashkisë.¹⁶

Pyjet dhe kullotat përbëjnë një burim të rëndësishëm natyror në Bashkinë Vlorë. Ato mbulojnë rreth një të tretën e territorit. Bashkia Vlorë administrohet një sipërfaqe prej 4,050 ha pyjesh dhe 7,150 ha kullotash. Zonat e tjera pyjore, afërsisht 8,200 ha pyje dhe 9,400 ha kullota (në Llogara, Pishë Poro dhe Karaburun) administrohen nga ARZM Vlorë. Peizazhet më të rrezikuara me vlera të larta mjedisore janë pylli me pisha bregdetare “Pylli i Sodës” dhe pylli “Pishë Poro”, të kërcënuar nga shkaqe natyrore, si dhe nga presioni urbanistik. Zonat e tjera pyjore janë të ruajtura mirë, dhe kërcënimet kryesor janë zjarret. Në parkun kombëtar të Llogarasë, në dekadat e fundit janë vërejtur ndryshime të rëndësishme morfologjike në raportin midis specieve halore dhe gjetherënëse, të vlerësuara si të ndikuara nga ndryshimet klimatike.¹⁷ Zjarret në pyje mbeten një emergjencë kryesore në Bashkinë Vlorë. Në zonat natyrore po vihen re gjithnjë e më shumë zjarre dhe me kohëzgjatje më të madhe. Krahas thatësirës, kohëzgjatja e zjarrit është më e madhe edhe për shkak të erërave. Shembulli më i fundit është viti 2021 kur zona e mbrojtur e Karaburunit u përfshi nga zjarre masive dhe me një rezistencë më të gjatë.¹⁸

Territori i Bashkisë Vlorë përshkohet nga një sërë **lumenjsh**, që janë pasuri për rajonin, por shpeshherë kërcënim për jetën dhe pasurinë e banorëve. Lumi kryesor i qarkut Vlorë është Vjosa¹⁹ dhe dega e saj, Shushica. Lumi i Shushicës është 80 km i gjatë me një sipërfaqe ujëmbledhëse prej rreth 715 km².

Lumi Vjosa, në pjesën e tij të fundit, përshkon ultësirat e Bashkisë Vlorë, përpara se të derdhet në bregdetin e Adriatikut. Në këtë segment janë të pranishme përmytjet, kryesisht në njësinë administrative Novoselë. Përmytjet janë regjistruar në vitet 2015, 2017 dhe 2019, kur dalja nga shtrati e lumit Vjosa, e kombinuar me shirat e dendur, shkaktoi përmytje. Përmytjet dhe mundësitë për përmytje janë ulur ndjeshëm pas investimeve për mbrojtje me argjinatura.²⁰ Shpallja e lumit dhe degëve të tij kryesore Park Kombëtar pritet të ndikojë në menaxhimin e tij. Megjithatë është në proces hartimi një plan menaxhimi, menaxhimi i basenit mund të përmirësohet ndjeshëm në saje të investimeve në pajisje telemetrike (pajisje që matin nivelin e ujit në lumë) dhe pastrimit të grykëderdhjes së lumit Vjosa nga sedimentet dhe mbeturinat e tjera që rrjedhin nga lumi.²¹

Parametrat e cilësisë së ujit të lumit Vjosa, në Bashkinë Vlorë, tregojnë nivele pH nën 8.5, brenda kufijve të pranueshëm për ekosistemet e ujërave të ëmbla, dhe një mjedis të qëndrueshëm pH. Rritja e niveleve të oksigjenit të tretur (O_2) (2014 deri në 2020) tregon përmirësim të cilësisë së ujit. Kjo mbështetet nga shifrat e Kërkesës Biologjike për Oksigjen (BOD) të cilat dëshmojnë një rënie me kalimin e viteve, gjë që mund të tregojë ulje të ndotjes organike. Nivelet e amonit (NH_4) janë përgjithësisht të ulëta, por tregojnë disa luhetje, të cilat mund të jenë tregues të inputeve të

¹⁵ PM-të me Bashkinë Vlorë, 8 shtator 2022

¹⁶ PM-të nga Workshop-i trajnues për përshtatjen i Bashkisë Vlorë, 5 tetor 2023

¹⁷ Lushaj, Sh. dhe Hysolako, N. (2018) “Biodiversiteti në parkun e Llogarasë dhe ndryshimet morfologjike”

¹⁸ PM-të me Bashkinë Vlorë, 8 shtator 2022

¹⁹ VKM nr. 155/2023 “Për shpalljen e ekosistemit natyror të lumit Vjosa “Park Kombëtar”, kategoria II

²⁰ PM-të nga Workshop-i trajnues për përshtatjen i Bashkisë Vlorë, 5 tetor 2023

²¹ PM-ja me Drejtorin e Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, 8 shtator 2022

ndryshueshme të ndotjes, si vërshimet e ujit nga tokat bujqësore. Nivelet e fosfatit (P-total, PO₄) tregojnë disa luhatje, me rritje të mundshme që mund të kontribuojnë në eutrofikim nëse përkohjë me rritje të lëndëve të tjera ushqyese.

Si një bashki bregdetare, Vlorë ka një rëndësi strategjike në kontekstin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, duke pasur parasysh vijën e saj të gjerë bregdetare dhe **biodiversitetin e pasur detar**. Studimet nxjerrin në pah cilësinë e mirë deri në të jashtëzakonshme të ujit dhe habitatet e larmishme detare me rëndësi të veçantë, si livadhet *Posidonia* dhe pyjet e dendura *Cystoseira*, të cilat shërbejnë si ekosisteme kritike që mbështesin specie të shumta detare. Mjediset bregdetare dhe detare të Vlorës janë shtëpia e **specieve** të ndryshme dhe të lëvizshme, duke përfshirë *fokat murg* dhe *breshkat detare*. Monitorimi i lulëzimit të algave të detit dhe i modeleve riprodhuese të fokave murg është thelbësor për të kuptuar dinamikën ekologjike dhe ndikimet e mundshme të ndryshimeve klimatike në këto ekosisteme të ndjeshme. Speciet invazive (peshkaqenët) që nuk janë vërejtur më parë në ujërat e zonës bregdetare të Vlorës tashmë po vihen re dhe po regjistrohen.

Gjiri i Vlorës karakterizohet nga kushte përgjithësisht oligotrofike dhe procese shumë të ndryshueshme të prodhimit primar. Studimet treguan se ndikimi i ujërave të hapura të Adriatikut jugor në trofizmin e gjirit ishte i papërfillshëm, ndërsa ndikimi i inputeve tokësore ishte shumë i theksuar. Shpërndarja e biomasës në sipërfaqen e ujit tregoi qartë rolin e shkarkimeve tokësore nga bregu lindor në nxitjen e proceseve të prodhimit primar. Gjiri, i ndarë në dy seksione përgjatë drejtimi juglindor dhe veriperëndimor, regjistroi vlerat më të ulëta të biomasës fitoplanktonike në zonën perëndimore. Gjendja trofike u nxit nga kushtet hidrodinamike vendore, inputet tokësore të lëndëve ushqyese dhe ciklet biogjeokimike, të cilat që të gjitha ishin të kufizuara kryesisht brenda gjirit.²²

2.2 Ekonomia dhe trajektorja ekonomike

Bashkia Vlorë renditet në vendin e tretë, pas Tiranës dhe Durrësit, për ekonominë më të zhvilluar të vendit. 5% e të gjitha ndërmarrjeve aktive të vendit ndodhen në Bashkinë Vlorë. Që nga viti 2022, struktura e ndërmarrjeve mbizotërohet nga ndërmarrje shumë të vogla, me 1 deri 4 punonjës, të cilat përbëjnë më shumë se 88% të të gjitha ndërmarrjeve aktive që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këtë bashki.²³

2.2.1 Bazat e ekonomisë

Edhe pse bashkia ka potenciale të mëdha të ndikuara nga rritja e turizmit bregdetar, aksesit në objektet portuale për pasagjerët, anijet turistike private, si dhe përpunimi i naftës, ekonomia e saj bazohet kryesisht në tregtinë me pakicë. 84% e ndërmarrjeve aktive janë ofrues shërbimesh, ndërsa pjesa tjetër (16%) janë prodhues mallrash.²⁴ Zonat ekonomike janë të përqendruara në qytetin e Vlorës dhe rrethinat e tij.

Gjatë periudhës 2018 – 2022, numri i ndërmarrjeve aktive në Bashkinë Vlorë ka mbetur i qëndrueshëm, me një rënie të lehtë prej 7% gjatë periudhës 2019-2021, dhe me rikthim në të njëjtat shifra në vitin 2022. Që prej vitit 2022, sa i përket pronësisë, ndërmarrjet aktive janë 95.4% shqiptare dhe vetëm 4.6% e tyre financohen me kapital të huaj dhe/ose kapital të përbashkët.²⁵

Bashkia është një qendër e rëndësishme detare në Shqipëri me një industri të zhvilluar peshkimi. Në Vlorë prodhohen edhe mallra si nafta, gazi natyror, bitumi dhe kripa. Po kështu, janë zhvilluar edhe

²² Revista e Kërkimeve Bregdetare 270, Karakterizimi trofik i ekosistemit pelagjik në Gjirin e Vlorës (Shqipëri) (janar 2011), f.67-79

²³ INSTAT, Regjistri i Biznesit 2018-2022, i disponueshëm në: <https://www.instat.gov.al/al/temat/statistikat-e-p%C3%ABrgjithshme-dhe-rajonale/tregues-sipas-bashkive/#tab2>

²⁴ INSTAT, Regjistri i Bizneseve 2018-2022; numri i ndërmarrjeve aktive (përfshirë fermerët)

²⁵ Po aty

industria e prodhimit të tekstit dhe e ndërtimit. Megjithatë, mbrojtja, promovimi dhe vlerësimi i burimeve natyrore dhe biodiversitetit, në kontekstin e zhvillimit ekonomik, mbetet problematikë kyç për zhvillimin e Bashkisë Vlorë.

2.2.2 Treguesit ekonomikë (PBB-ja, etj.)

Sipas të dhënave kombëtare për periudhën 2017-2021, prefektura e Vlorës ka kontribuar me 5.6% të PBB-së në ekonominë kombëtare. Duke qenë se në nivel bashkie nuk ka të dhëna për treguesit ekonomikë, analiza e profilit ekonomik të Bashkisë Vlorë u krye mbi bazën e të dhënave kombëtare të INSTAT-it për treguesit ekonomikë, duke i përshtatur ato për nivelin e bashkisë. Sektorët janë kategorizuar në: bujqësi, industri, turizëm, energji/transport, shërbime dhe të tjerë; këta sektorë janë përshtatur për t'u përputhur me ndarjet sipas sektorëve në të dhënat publike të INSTAT-it. Për këto arsye, janë bërë përshtatjet e mëposhtme: fusha "Industri" në të dhënat publike të INSTAT-it përfshin "industrinë nxjerrëse; përpunimin; energjinë; ujin". Për qëllime të këtij raporti, 25% e vlerave në këtë fushë i kanë kaluar fushës së Energjisë dhe 75% mbahen në fushën e Industrisë. Për qëllime të këtij vlerësimi, 33% e vlerës së fushës "Tregtia me shumicë dhe me pakicë, riparimi i mjeteve motorike dhe mallrave shtëpiake, hotelet dhe pushimi" shpërndahet në fushat e turizmit, transportit dhe shërbimeve. Për rrjedhojë, kontributi i secilit sektor në PBB-në e prodhuar në Vlorë është përkatësisht 27.8% (Bujqësi), 20.6% (Industri), 6.1% (Turizëm), 9.1% (Energji/Transport), 34.4% (Shërbime), 1.9% (të tjerë).

Ekonomia e Bashkisë Vlorë tregon një zgjerim të qëndrueshëm me një normë mesatare prej 7.57% për periudhën 2017-2021, dëshmuar nga një rritje progresive e PBB-së (Figura 2.5). Rritja e përgjithshme e numrit të bizneseve tregon për një ekonomi të shëndetshme dhe në zgjerim.

Spektori i bujqësisë në Bashkinë Vlorë ka demonstruar rritje të qëndrueshme të prodhimit nga viti 2017 deri në vitin 2021, me një projeksion të konsiderueshëm rritjeje për vitin 2022. Ndër vite është rritur edhe numri i shoqërive në këtë sektor. Bazuar në llogaritjet dhe supozimet e paraqitura më sipër, të ardhurat u rritën në vazhdimësi nga 140 milionë dollarë në vitin 2017 në 181 milionë dollarë në vitin 2021, gjë që tregon rritje të qëndrueshme gjatë periudhës pesëvjeçare. Ky sektor ka shfaqur një trajektore pozitive, me një rritje mesatare vjetore të të ardhurave.

Po ashtu, **sektori i industrisë** ka shënuar rritje, ndonëse ka pasur disa luhajtje. Të ardhurat u rritën nga 96 milionë dollarë në vitin 2017 në 135 milionë dollarë në vitin 2021, çka tregon një prirje të përgjithshme rritëse. Numri i shoqërive në këtë sektor ka mbetur relativisht i qëndrueshëm.


Të ardhurat nga **turizmi** kanë pësuar luhajtje ndër vite. Megjithatë pati rritje të qëndrueshme gjatë periudhës 2017-2019, teksa të ardhurat u rritën nga 29 milionë dollarë në 37 milionë dollarë, në vitin 2020 u vu re një rënie në 31 milionë dollarë, ndërsa në vitin 2021 kjo shifër u rrit në 40 milionë dollarë, gjë që përkon edhe me situatën pas Covid-it. Numri i shoqërive në këtë sektor ka pësuar rënie. Pavarësisht luhajtjeve, të ardhurat nga turizmi treguan qëndrueshmëri dhe periudha u mbyll me prirje rritëse.

Spektori i energjisë dhe transportit shfaqti luhajtje të ndryshme të ardhurash, duke shënuar rritje dhe ulje gjatë periudhës pesëvjeçare. Pavarësisht luhajtjeve, të ardhurat e përgjithshme u rritën nga 42 milionë dollarë në vitin 2017 në 56 milionë dollarë në vitin 2021, çka tregon rritje, por të shoqëruar me njëfarë paqëndrueshmërie. Numri i shoqërive në këtë sektor është ulur.

Spektori i shërbimeve ka shënuar rritje të qëndrueshme të sasisë së prodhimit ndër vite, me një rritje të konsiderueshme për vitin 2022. Shërbimet u shfaqën si faktor kontribues i rëndësishëm në rritjen e të ardhurave, të cilat u rritën në vazhdimësi nga 179 milionë dollarë në vitin 2017 në 237 milionë dollarë në vitin 2021. Ky sektor tregoi rritje të qëndrueshme dhe të vazhdueshme gjatë gjithë periudhës, me ardhura të konsiderueshme për çdo vit. Numri i shoqërive në këtë sektor ka shënuar rritje. Kategoria "të tjerë" ka pasur disa luhajtje, por kontributi i saj në PBB-në e përgjithshme është relativisht i ulët, mesatarisht 2%.

Në përgjithësi, edhe pse secili sektor pati tendencat e tij unike të të ardhurave, analiza kolektive zbulon një prirje pozitive në rritjen e të ardhurave në shumicën e sektorëve gjatë periudhës pesëvjeçare. Shërbimet u shfaqën si sektori me performancën më të mirë, duke gjeneruar të ardhura të vazhdueshme dhe të konsiderueshme, ndërsa sektorët e tjerë shfaqën shkallë të ndryshme rritjeje dhe paqëndrueshmërie.

Figura 2.5 _ Prirjet e prodhimit të sektorit ekonomik në Bashkinë Vlorë (2017-2021)



Burimi: INSTAT (2017-2021)

Të dhënat demonstrojnë një peizazh dinamik dhe të larmishëm biznesi në qytetin e Vlorës. Rritja në sektorët e shitjes me pakicë dhe të shërbimeve tregon mundësi për zhvillime dhe investime të mëtejshme. Përqendrimi i bizneseve në tre rajone specifike (Rajoni 3 me 1,447 biznese; Rajoni 5 dhe 2 me përkatësisht 832 dhe 814 biznese) duhet të shërbejë si orientim i përpjekjeve për planifikimin vendor.

2.2.3 Trajektorja për të ardhmen dhe prioritetet e zhvillimit ekonomik të bashkisë

Plani i Përgjithshëm Vendor i Zhvillimit (PVZH) për Bashkinë Vlorë është dokumenti kryesor i politikave në lidhje me qëllimin e këtij studimi dhe që identifikon prioritetet kryesore të zhvillimit ekonomik. Dokumenti është miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 1, datë 16.10.2017.

Pesë nga gjashtë objektivat strategjike të PVZH-së identifikojnë ndërhyrjet me rëndësi për fushat prioritare të PKP-së, si transporti, zhvillimi urban, turizmi dhe bujqësia. Më konkretisht:

- Objektivi strategjik nr. 1 “përmirësimi i konkurrueshmërisë dhe cilësisë së produktit turistik”;
- Objektivi strategjik nr. 2 “zhvillimi i zinxhirëve të bashkëpunimit territorial për ekonomi të qëndrueshme” nëpërmjet OS2OB1 “krijimi i sinergjive ekonomike midis turizmit dhe bujqësisë”;
- Objektivi strategjik nr. 4 “përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shërbimeve për popullsinë banuese dhe rritja e kohezionit social”;
- Objektivi strategjik nr. 5 “përmirësimi i lidhjeve dhe zhvillimi i formave multimodale të transportit” nëpërmjet gjashtë ndërhyrjeve të tij strategjike, dhe
- Objektivi strategjik nr. 6 “menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore”.²⁶

PVZH-ja e Vlorës nuk siguron vlerësimin e duhur të efekteve të ndryshimeve klimatike në zhvillim

²⁶ PVZH-ja e Vlorës (2017), f. 107 deri në 112

urban, bujqësi, turizëm, energji dhe transport. Prandaj, objektivat strategjike nuk arrijnë të identifikojnë masat/ndërhjert, të cilat do të bënin të mundur përshtatjen e sektorëve kyç të zhvillimit të bashkisë ndaj ndryshimeve klimatike. Analiza e PVZH-së tregon se **aktivitetet e lidhura me transportin dhe turizmin do të jenë dy sektorët ekonomikë që do të shënojnë rritje ekonomike**, ndërsa bujqësia dhe peshkimi pritet të kenë rritje të ulët ekonomike deri në vitin 2031.²⁷

Megjithëse **turizmi** është identifikuar si sektori kyç i zhvillimit vendor, nuk është përgatitur asnjë dokument strategjik në lidhje me Planin Sektorial të Turizmit. Po ashtu, Bashkia nuk ka as Strategji Vendore për Zhvillimin e Transportit, as Plan të Lëvizshmërisë Urbane të Qëndrueshme (PLUQ), dhe as Plan Bashkiak për Energjinë ose Plan Veprimi për Energjinë e Qëndrueshme (PVEQ), të rëndësishme për sa u përket mënyrave novatore për ndriçimin e qytetit dhe eficiencën e **energjisë** në ndërtesat publike.

2.3 Kushtet socio-ekonomike

Vlerësimi i fundit i pabarazive rajonale në Shqipëri është kryer në vitin 2012. Këto të dhëna tregojnë se qarku i Vlorës ka normën më të ulët të varfërisë në vend me 11.1%, pas Gjirokastrës me 10.6%.²⁸

2.3.1 Varfëria

726 familje (1.2%) në Bashkinë Vlorë përfitojnë ndihmë ekonomike. Numri i përfituesve të ndihmës ekonomike është 735 banorë të cenueshëm dhe 1,311 persona me aftësi të kufizuar.²⁹ Sipas të dhënave të INSTAT-it (2018), papunësia në Bashkinë Vlorë është 21.9%, shumë më e lartë se niveli kombëtar prej 12.3%, ndërkohë që 26.2% e të papunëve janë gra. Njësitë administrative Novoselë (26.2%) dhe Shushicë (30.9%) shfaqin një nivel shumë më të ulët punësimi dhe nxjerrin në pah dallime të mëdha sociale, gjë që sjell kushte të vështira jetese. Këto kategori janë gjithashtu të ekspozuara ndaj “varfërisë energjetike”, gjë që nënkupton vështirësi ekonomike, pamundësi për të paguar faturat, izolim social, apo edhe probleme shëndetësore.³⁰

6.06% të popullsisë së Bashkisë Vlorë e përbëjnë pakicat rome dhe egjiptiane. Këto pakica banojnë në njësitë administrative Novoselë, Shushicë dhe Qendër. Niveli i tyre i varfërisë është 90% (1,080 persona)³¹ dhe kanë si burim kryesor të ardhurash bujqësinë, blegtorinë, si dhe punësimin rastësor/sezonal, remitancat nga emigrantët dhe fitimet e vogla të gjeneruara nga riciklimi i mbetjeve.³²

2.3.2 Treguesit shëndetësorë

Në Bashkinë Vlorë, kujdesi shëndetësor parësor ofrohet në nivel bashkie, ndërsa kujdesi shëndetësor dytësor ofrohet në qytetin e Vlorës, si pjesë e rajonalizimit të shërbimeve shëndetësore spitalore.

Sa i përket infrastrukturës shëndetësore, të gjitha njësitë administrative kanë të paktën një qendër shëndetësore (QSH) dhe ambulancat janë të pranishme në shumicën e vendbanimeve. Në përgjithësi, objektet ekzistuese të kujdesit shëndetësor përfshijnë 1 spital rajonal, një spital psikiatrik, 71 qendra shëndetësore dhe 54 ambulanca.³³ Një veçori e rëndësishme që lidhet me mirëqenien dhe shëndetin

²⁷ PVZH-ja e Vlorës (2017), f. 118 deri në 120

²⁸ INSTAT “Shqipëria: trendi i varfërisë” (2015), i disponueshëm në: https://www.instat.gov.al/media/2064/shqiperi-trendi_i_varferise_2012_.pdf

²⁹ EmpowerMed, Vlerësimi i Bashkisë Vlorë nga perspektiva e varfërisë energjetike, gjinisë dhe ndikimit në shëndet (2020) f. 21-22, i disponueshëm në: <https://www.empowermed.eu/wp-content/uploads/2020/11/D1.1-Vlorë-Shqipëri.-Faqja-Pilot-2.pdf>

³⁰ Po aty, f. 25


³¹ Bashkia Vlorë, Plani Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022 (2019), f. 22

³² EmpowerMed (2020) f. 22-23

³³ <https://www.fsdksh.com.al/qendrat-shendetesore>

e banorëve është **cilësia e ajrit**. Të dhënat tregojnë se ka tejkalime të ndryshueshme të PM₁₀, me një rritje të konsiderueshme në vitin 2021, gjë që nënkupton ose një ndryshim në aktivitetet vendore që gjenerojnë lëndë grimcore, si ndërtimi ose trafiku, ose ndryshime në praktikën e monitorimit ose raportimit. Prirja në rritje e **përqendrimeve të PM₁₀** nënkupton një përkeqësim të mundshëm të cilësisë së ajrit, që sjell ndërlikime të mundshme për sëmundjet e frymëmarrjes. Kulmi i **tejkalimeve të NO₂** në vitin 2017, i pasuar nga të dhëna jo të plota, tregon për ngjarje episodike që çuan në rritje të niveleve të NO₂, të tilla si dyndja e trafikut ose emetimet industriale.

Figura 2.6 _ Prirjet e tejkalimeve të ndotësve të ajrit në Bashkinë Vlorë (2012-2021)




Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Raportet për Gjendjen e Mjedisit

Për sa i përket ndotjes së ajrit nga industria, diçka e tillë nuk konstatohet në Bashkinë Vlorë. Cilësia e ajrit preket vetëm nga sektori i transportit dhe emetimet e automjeteve të transportit. Popullsia arrin në mbi 200,000 banorë gjatë muajve të pikut që përkohet me periudhën e verës, kur shumica e popullsisë përdor makina private, të cilat shkaktojnë bllokime të mëdha trafiku dhe emetime gazi në ajër. Gjithashtu, në këto periudha është e pranishme edhe ndotja akustike (zhurmë më e lartë). Cilësia e ajrit gjatë sezonit të verës është ndikuar nga zjarret në pyje, si dhe nga episodet e zjarreve në landfillin e mbetjeve.³⁴

Figura 2.7 _ Përqendrimi i ndotësve të ajrit në Bashkinë Vlorë (2012-2021)

³⁴ PM-të nga Workshop-i trajnues për përshtatjen i Bashkisë Vlorë, 5 tetor 2023



Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Raportet për Gjendjen e Mjedisit

2.3.3 Treguesit arsimorë

Sipas të dhënave për arsimin, në të gjitha njësitë administrative (përveç Qendrës) janë të pranishme 17 institucione të arsimit të mesëm dhe 52 institucione të arsimit bazë në shumicën e vendbanimeve.³⁵ Numri i përgjithshëm i nxënësve/fëmijëve të regjistruar në arsimin bazë (fillor dhe i mesëm i ulët) është 10,354 fëmijë, prej të cilëve 48% janë femra.³⁶ Nivelet e regjistrimit në arsimin bazë kanë rënë rreth 30% gjatë pesë viteve të fundit (Tabela 2.1 _ Nxënësit e regjistruar në nivelet arsimore në Bashkinë Vlorë Tabela 2.1).

Tabela 2.1 _ Nxënësit e regjistruar në nivelet arsimore në Bashkinë Vlorë

| Niveli arsimor | Regjistruar 2017-2018 | Regjistruar 2018-2019 | Regjistruar 2019-2020 | Regjistruar 2020-2021 | Regjistruar 2021-2022 |
|---|-----------------------|-----------------------|-----------------------|-----------------------|-----------------------|
| Arsimi fillor dhe arsimi i mesëm i ulët (arsimi 9-vjeçar) | 13,482 | 12,860 | 11,176 | 10,811 | 10,354 |
| Arsimi i mesëm i lartë (i përgjithshëm) | 4,073 | 3,876 | 3,318 | 3,179 | 3,137 |
| Shkolla e mesme (profesionale) | 1,095 | 1,052 | 1,027 | 1,014 | 964 |
| Studime universitare | 7,368 | 6,457 | 5,575 | 4,906 | 4,798 |

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, Bashkia Vlorë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA)

Bashkia Vlorë ka tre shkolla të arsimit të mesëm profesional/të orientuar, të cilat ndodhen në qytetin e Vlorës. 19% e totalit të nxënësve, që kanë filluar arsimin e mesëm gjatë vitit shkollor 2021-2022 në

³⁵ <https://vlora.gov.al/arsimi-ne-vlore/>

Bashkinë Vlorë, janë regjistruar në trajnime profesionale.³⁷ Në Vlorë ndodhet Universiteti “Ismail Qemali” dhe dy institucione të tjera private që ofrojnë studime universitare. Regjistrimet në studimet universitare janë përgjysmuar në pesë vitet e fundit, të kushtëzuara nga demografia e të rinjve.³⁸

2.4 Profilet e sektorëve prioritarë

Në përputhje me procesin e PKP-së, sektorët prioritarë në nivel vendor janë bujqësia, planifikimi urban, turizmi, energjia dhe transporti.

2.4.1 Bujqësia

Bashkia Vlorë shtrihet në një territor fushor dhe kodrinor dhe sektori i bujqësisë mbizotërohet nga ullishtat, vreshtat dhe blegtoaria. Në periudhën 2016-2021, ka pasur një rritje të dukshme të sipërfaqes së **kultivimit të drithërave**, gjë që tregon zgjerim të synuar në këtë segment themelor të bujqësisë (Figura 2.10). Nga ana tjetër, sipërfaqja kryesore për perime është ulur me 37% në periudhën 2017-2022. Megjithëse zë një pjesë të vogël të sektorit bujqësor, kultivimi i **kulturave mjekësore** ka shënuar rritje të dukshme të prodhimit, i cili u rrit 34% (nga 15 në 23 tonë) gjatë periudhës 2017-2021. Kjo tregon rritje të interesit të tregut për këto produkte dhe mund të përfaqësojë një mundësi të re për diversifikimin bujqësor.

Sipërfaqja e posaçme për **pemët frutore** mbeti e qëndrueshme nga viti 2017 deri në vitin 2022, pa ndryshime të konsiderueshme në hektarët e caktuar për mollët, kumbullat dhe qershitë. Megjithatë, shifrat e prodhimit tregojnë disa luhajtje, me një prirje të përgjithshme në rritje të prodhimit total të rrushit. Viti 2022 shënoi rritje të prodhimit në të gjitha llojet e pemëve frutore, gjë që tregon ose kushte të favorshme klimatike, ose përmirësime në praktikën e hortikulturës.

Sipas të dhënave të bashkisë për vitin 2022, sipërfaqja e përgjithshme e tokës së kultivuar (perime dhe kultura bujqësore të arave) ishte 10,031 ha. Vetëm 25% e sipërfaqes së tokës së kultivuar ka akses në sistemin e ujitjes dhe e gjithë sipërfaqja ka akses në kullim (Tabela 2.2). Edhe pse rrjeti i kullimit duket të jetë më efikas, sfidat operative me të cilat përballet hidrovori përbëjnë kërcënim real për përmbajtje të tokave bujqësore. Amortizimi i pajisjeve jetike, si pompat dhe paneli elektrik, si dhe personeli i pamjaftueshëm për pastrim dhe mirëmbajtje, sjellin bllokime dhe ulje të funksionalitetit.

Tabela 2.2 _ Të dhënat për infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit në Bashkinë Vlorë (2022)

| Sistemi i ujitjes dhe kullimit | Shifrat |
|--|---------|
| Gjatësia e sistemit të ujitjes (në km) | 230 |
| Sipërfaqja bujqësore e mbuluar me ujitje (në ha) | 2,565 |
| Gjatësia e sistemit të kullimit (në km) | 371,5 |
| Sipërfaqja bujqësore e mbuluar me kullim (në ha) | 10,850 |
| Sipërfaqja e rezervuarëve (ha) | 1.625 |

Burimi: Bashkia Vlorë

Bashkia është e pasur me **rezervuarë artificialë** (7): Kanina 1 dhe 2, Kallafet, Bunavi, Babicë, Bestrovë dhe Panaja. Të gjithë rezervuarët kanë nevojë urgjente për shkarkim të sigurt dhe pajisje të reja për të garantuar rregullimin e nivelit të ujit të rezervuarëve në rast reshjesh të dendura dhe ekstreme. Kanalet e shkarkimit të ujit shpesh dëmtohen dhe mbuloen me bimësi. Rehabilitimi i rezervuarit të

³⁷ Buletini Statistikor 2021 (2022) f. 36, i disponueshëm në: <https://akpa.gov.al/wp-content/uploads/2022/12/Buletini-Statistikor-2021.pdf>

³⁸ Ministria e Arsimit dhe Sportit, Vjetari Statistikor për Arsimin dhe Sportin (2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023)

Bunavisë, për të parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm të strukturës së digës dhe për ta mbajtur atë në një gjendje të sigurt dhe funksionale, mbetet një emergjencë.³⁹

Mangësitë e trajtuara më sipër jo vetëm që paraqesin risk për prodhimtarinë bujqësore, por edhe për sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemeve të menaxhimit të ujërave.

Edhe pse një bashki bregdetare, rajoni është shumë i njohur për **mbarështimin e bagëtive**. Blegtoria është aktiviteti më i rëndësishëm ekonomik në rezervatin natyror të menaxhuar të Karaburunit dhe në terrenet malore të bashkisë. Bashkia ofron kullota verore dhe dimërore, kryesisht për mbarështimin e dhive dhe dhenve. Kullotat në gadishullin e Karaburunit, në Shushicë dhe ato midis lumenjve Vjosë dhe Shushicë, janë ndër masivet më efektive të kullotave dimërore në Shqipëri. Këto veprimtari sjellin të ardhurat bazë përmes prodhimit të produkteve ushqimore bazë, si mishi, bulmeti dhe mjalti, duke qenë faktor i rëndësishëm për ekonominë vendore. Numri i bagëtive për vitin 2022 arrin në: 6,278 gjedhë (5,637 lopë); 27,273 dhi; 52,258 dhen (39,913 me qumësht); 30,940 dhi (20,124 me qumësht); 1,169 njëthundrakë; 184,478 shpendë dhe 4,380 bletë.

Bashkia është një qendër e rëndësishme detare në Shqipëri me një industri të zhvilluar **peshkimi**. Triporti, që është porti kryesor i peshkimit, ka 239 anije peshkimi të regjistruara, 50 nga të cilat përdoren për peshkim në shkallë të gjerë dhe përdorin peshkarexha në shtretërit ranorë jashtë gjirit të Vlorës⁴⁰ dhe 171 anije peshkimi në shkallë të vogël⁴¹ që përdoren në aktivitetet e peshkimit detar dhe lagunor. Gjiri i Vlorës është gjithashtu një zonë e rëndësishme e zhvillimit të akuakulturës me sipërfaqe të caktuar prej 6.29 ha dhe kapacitet prodhues prej 15,450 tonë/vit.⁴² Aktualisht, në këtë gjiri operojnë shtatë ferma të licencuara, me kapacitet të kombinuar të prodhimit global prej 6,450 tonë/vit. Ato përqendrohen në kultivimin e krapit dhe levrekut në kafaze detare.

2.4.2 Zhvillimi urban

Në 30 vitet e fundit, Bashkia Vlorë i është nënshtruar një transformimi të thellë urban, që ka ndryshuar strukturën e territorit, dendësinë, larminë e funksioneve dhe pabarazinë e tij të theksuar në aksesin në shërbime.

Menaxhimi urban dhe infrastruktura bazë janë sfidat me të cilat përballet sot bashkia, veçanërisht në shpërndarjen e shërbimeve për shkak të shtrirjes së saj gjeografike. Vlora dhe qyteti i Orikut, si dhe fshati Radhimë kanë përjetuar në 15 vitet e fundit një bum ndërtimi, i cili ka krijuar mbingarkesë infrastrukturore dhe probleme në mjedis dhe në menaxhimin e mbetjeve të ngurta.⁴³

Sipërfaqja e tokës për banim për të gjitha njësitë administrative ka mbetur relativisht e qëndrueshme (periudha 2017-2022), me disa luhatje të vogla. Luhatje të dukshme janë vërejtur në Shushicë, ku sipërfaqja e tokës për banim është rritur ndjeshëm (70%) nga 1.8km² në vitin 2017 në 6.5km² në vitin 2022. Qyteti i Vlorës ruajti një sipërfaqe të qëndrueshme toke për banim prej rreth 8.3 km². Të dhënat mbi përdorimin e tokës për qëllime **tregtare dhe industriale** nuk janë të disponueshme për njësitë administrative Orikum, Qendër dhe Shushicë, gjë që tregon se aktivitetet tregtare dhe industriale zhvillohen në qytetin e Vlorës dhe rrethinat e tij. Sipërfaqet e tokës **bujqësore** janë të konsiderueshme dhe kanë mbetur relativisht të qëndrueshme gjatë të njëjtës periudhë.

Zgjerimi i shpejtë i qytetit të Vlorës pas viteve '90 nuk ndoqi një strategji të duhur planifikimi, por iu nënshtrua presionit të rastësishëm njerëzor duke shkaktuar efekte shumë të dëmshme në peizazhe

³⁹ Baza e të dhënave e Bashkisë Vlorë

⁴⁰ Rregullorja e MBZHR-së nr. 1/2014 "Për zbatimin e Ligjit nr. 64/2012 "Për peshkimin"", i ndryshuar, ndalon gjuetinë e peshkut me tërheqje trate në gjirin e Vlorës; MBZHR-ja rregullon gjithashtu peshkimin në lagunat e Nartës, Kallengës dhe Orikut, nëpërmjet Organizatave të Menaxhimit të Peshkimit

⁴¹ HYDRA, Raporti Përfundimtar për "Regjistrimin dhe analizën e kostos së peshkimit në shkallë të vogël (artizanale)" (2019)

⁴² VKM Nr. 461, datë 26.7.2023 "Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave për zonat e përcaktuara për akuakulturë në Shqipëri"

⁴³ Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2023—2028 (2022), f. 23

(veçanërisht në jug të qytetit), si dhe në zona të tjera bujqësore në dhe përreth qyteteve. Ato që më parë ishin terraca me ullinj, mandarina dhe portokaj (në Vlorë) dhe toka bujqësore (në Orikum) u shndërruan për qëllime zhvillimi.


2.4.3 Turizmi

Zona bregdetare e Bashkisë Vlorë shtrihet në një gjatësi mbi 90 km nga grykëderdhja e lumit Vjosa pranë njësisë administrative Novoselë deri në gjirin e Vlorës dhe deri në parkun kombëtar detar Karaburun-Sazan. Gjiri i Vlorës është ndër zonat me potencialin më të lartë turistik në vend, me dalje direkte në det dhe me pasuri natyrore, klimatike, ujore, arkeologjiko-morfologjike, historike, kulturore, njerëzore dhe ekonomike.⁴⁴

Turizmi bregdetar është aktiviteti kryesor turistik dhe katalizatori i rritjes ekonomike në Bashkinë Vlorë. Duke qenë se rritja urbane ka ndodhur paralelisht me vijën bregdetare, kryesisht me ndërtimin e hoteleve dhe bujtinave, bashkia është përballur me një numër të lartë investimesh dhe zhvillim masiv të strukturave akomoduese në zonat bregdetare. Numri i vizitorëve gjatë stinës së verës e çon popullsinë në 300,000 banorë, me një përlogaritje prej 1.6 milionë ditë qëndrimi/vit.⁴⁵

Turizmi bregdetar shpesh kombinohet me turizmin kulturor nëpërmjet **trashëgimisë kulturore dhe historike** të qarkut dhe/ose **turizmit rekreativ** në zonat rurale dhe zonat e mbrojtura përreth. **Turizmi i bazuar në natyrë** (shtigje për ecje dhe çiklizëm, vrojtim shpendësh, zhytje, etj.) po shfaqet si një formë kryesore e turizmit, e përqendruar, por jo e kufizuar, në zonat e mbrojtura natyrore të bashkisë, duke siguruar kështu diversifikimin dhe zgjatjen e sezonit siç tregohet në Figura 2.8. Efektet e ndryshimeve klimatike (dimër më i shkurtër dhe më i butë) kanë rezultuar në zgjatje të sezonit turistik.

Figura 2.8 _ Vizitorë në Parqet Kombëtare Llogara dhe Karaburun-Sazan (2018-2022)



Burimi: Të dhënat e UNDP në Shqipëri/AKZM-së bazuar në të dhënat e administruara nga dy qendrat e vizitorëve të Parkut Kombëtar Llogara dhe Karaburun-Sazan.

21,000 turistë vizituan muzetë dhe kështjellat në qarkun e Vlorës gjatë sezonit veror 2023, me një rritje prej 50% të biletave të shitura krahasuar me një vit më parë.⁴⁶

Ky qark është i njohur edhe për praktikën tradicionale të transhumancës, lëvizjen sezonale të bagëtive midis kullotave më të larta në verë dhe luginave më të ulëta në dimër, një traditë historike botërore, e listuar si **trashëgimi kulturore jomateriale** në UNESCO.⁴⁷ Bashkia Vlorë është një nga shembujt e veçantë në Shqipëri, ku zhvillimi i sistemeve të transportit/energjisë dhe rritja e tregjeve

⁴⁴ Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2023—2028 (2022), f. 22-23

⁴⁵ Po aty

⁴⁶ Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, Vlorë

⁴⁷ <https://ich.unesco.org/en/state/albania-AL?info=elements-on-the-lists>

të turizmit ushtrojnë presion mbi njëri-tjetrin dhe ndikojnë në planifikimin hapësinor. Për rrjedhojë, infrastruktura e transportit/prodhimit të energjisë dhe tregjet e turizmit konkurrojnë për përdorimin e burimeve territoriale/mjedisore dhe qeveria shqiptare nuk ka ende një strategji të qartë për zhvillimin e turizmit në Bashkinë Vlorë dhe në zonën e qytetit të Vlorës dhe njësinë administrative Novoselë në veçanti.⁴⁸

2.4.4 Energjia

Për shkak të vendndodhjes së Bashkisë Vlorë larg burimit të prodhimit primar të energjisë (kaskada e Drinit), qeveria shqiptare ka eksploruar mënyra alternative për të rritur sigurinë e furnizimit me energji dhe për të kontribuar në **diversifikimin e burimeve të energjisë** për Shqipërinë e Jugut. Ndër to është Termocentrali i Vlorës (TEC), që u ndërtua në vitin 2011 dhe që fillimisht ishte planifikuar të funksiononte me naftë. Për shkak të një defekti në sistemin e ftohjes, TEC-i me kapacitet prodhimi 97 MW nuk u vu asnjëherë në funksion.⁴⁹ Vënia në punë e impiantit (me gaz) është marrë sërish në konsideratë me ndërtimin e “Gazsjellësit Fier – Vlorë”.⁵⁰

Bashkia Vlorë është e vetmja bashki shqiptare ku janë planifikuar të gjitha llojet e **energjisë së rinovueshme**. Aktualisht janë në funksion 2 **HEC-e** me kapacitet total prodhimi prej 17.8 MW, ndërsa 14 HEC-e të tjera janë në fazë ndërtimi. Në vitin 2023, qeveria shqiptare miratoi pesë **impiante eolike** me kapacitet 3 MW dhe punime ndihmëse në fshatin Tragjas (njësia administrative Orikum). Ato pritet të jenë funksionale brenda 3 vitesh.⁵¹ Bashkia Vlorë ka qenë pararojë edhe për **prodhimin e energjisë diellore**. Ankandi i parë për impiantet e mëdha diellore në Shqipëri ishte për impiantin diellor me kapacitet të instaluar 100 MW në tokat e kripura të Akërnisë (njësia administrative Novoselë). Megjithatë, projekti është pezulluar për gati gjashtë vjet.⁵² Kapaciteti shtesë i prodhimit përfshin dy anije gjeneratore të blera në vitin 2022, të ankoruara në zonën Triportit. Ato nuk janë vënë në punë deri më sot.

12 km në veri të portit të Vlorës ndodhet porti i naftës “Vlora-1”.⁵³ Terminali bregdetar u mundëson subjekteve private të furnizojnë **me produkte naftë dhe GLN** tregun shqiptar dhe vendet fqinje nëpërmjet Korridorit Evropian III (hekurudhë plus rrugë) duke përfutur edhe nga gjiri i Vlorës, që ndodhet në hyrje të detit Adriatik dhe pranë rafinerive kryesore italiane dhe greke.⁵⁴ Më 18 dhjetor 2019, u regjistrua një **aksident/fatkeqësi me natyrë teknologjike/industriale** kur ndotja me naftë nga rrjedhja e naftës shkaktoi dëme të konsiderueshme në habitatin detar në gjirin e Vlorës.⁵⁵

Investimet e fundit në tubacionet e transmetimit të energjisë së tensionit të lartë kanë përmirësuar ndjeshëm cilësinë e **furnizimit me energji** në Bashkinë Vlorë. Problemet me furnizimin me energji elektrike ndeshen kryesisht në zonat rurale ku linjat e energjisë elektrike janë ajrore. Në qytetin e Vlorës, ato janë shtruar nën tokë dhe nuk preken nga reshjet e dendura ose ngjarjet e tjera ekstreme.⁵⁶

Me qëllim **ruajtjen e energjisë urbane**, Bashkia Vlorë ka ndërmarrë dhe zbatuar incentiva dhe

⁴⁸ Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) Plani i Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare Vjosë-Nartë, (2019) f. 33, i disponueshëm në: https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/20210707_PDZRK_Pishe-Poro_PLANI-I-ZHVILLIMIT_PDZRK.pdf

⁴⁹ <https://www.kesh.al/en/asset/tec-vlora/>

⁵⁰ Dokumentet përgatitore për ndërtimin e “Gazsjellësit Fier – Vlorë” kanë përfunduar. Kostoja e punëve të investimit është llogaritur në 17.48 milionë euro. Ndërtimi i kësaj dege gazi do të furnizojë konsumatorët në Bashkitë Vlorë, Fier, Ballsh, Tepelenë dhe Gjirokastër; më shumë informacion gjendet në: <https://wbif.eu/news-details/eu-supports-additional-technical-assistance-gas-transmission-network-albania>

⁵¹ <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/04/13/214/84371434-affc-4615-98f4-813829a52ba3;q=tragjas>

⁵² <https://balkangreenenergynews.com/consortium-led-by-india-power-corporation-wins-bid-to-build-100-mw-solar-power-plant/>

⁵³ Porti i naftës “Vlora-1” operohet nga La Petrolifera Italo Albanese Sh.A. (PIA), që është një subjekt privat

⁵⁴ <https://www.gruppopir.com/en/la-petrolifera-italo-albanese>

⁵⁵ Raporti i Vlerësimit të Riskut Teknologjik (Industrial) (2021), f. 80, i disponueshëm në: https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_510_VKRF4.pdf

⁵⁶ PM-të me Bashkinë Vlorë, 8 shtator 2022

programe që synojnë ndërhyrjet në termoizolim, ndriçimin efikas dhe/ose instalimin e fotovoltaikeve për ujë të ngrohtë në ndërtesa publike, kryesisht në çerdhe, kopshte dhe shkolla. Shumica e projekteve janë financuar nëpërmjet programeve të BE-së IPA CBC dhe INTERREG dhe kanë trajtuar nevojat afatshkurtra të bashkisë për investime, e megjithatë nevoja për ndërhyrje të mëtejshme mbetet e lartë. Gjithashtu, bashkia ka financuar një program për izolimin e ndërtesave, i aplikuar deri më tani për familjet në nevojë, por edhe për grupe ndërtesash publike në zona të ndryshme të qytetit.⁵⁷

2.4.5 Transporti

Për shkak të vendndodhjes gjeografike, të gjitha **mënyrat kryesore të transportit**, si transporti ujor, rrugor, hekurudhor dhe transporti ajror indirekt, janë të pranishme në distanca shumë të shkurtra nga qyteti i Vlorës. Kjo shoqërohet me implikime për menaxhimin e trafikut, planifikimin urban dhe politikat mjedisore, veçanërisht për sa i përket ndikimit të tyre në emetimet e karbonit dhe cilësinë e ajrit në kontekstin e ndryshimeve klimatike.

Infrastruktura detare përfaqësohet nga porti i Vlorës, porti i peshkatarëve, porti i Vlorës-1 ose porti industrial i Vlorës (terminali Petrolifera për transportin e produkteve të naftës dhe të gazit) dhe marina e Orikutit, e vetmja e këtij lloji në të gjithë bregdetin shqiptar.⁵⁸ Në jug të gjirit të Vlorës ndodhet edhe baza ushtarake e Pashalimanit.

Porti i Vlorës, është porti më i madh në jug, që u shërben të gjitha pikave qendrore jugore të Shqipërisë, dhe porti i dytë më i rëndësishëm pas Portit të Durrësit. Ai është përcaktuar si porta e dytë hyrëse e Korridorit VIII. Për sa i përket **transportit ujor**, porti i Vlorës ofron i) transportin e pasagjerëve që hipin/zbresin në anijet (tragetet) Ro-Ro Pax midis Vlorës dhe Brindisit, Itali; dhe ii) përpunimin e ngarkesave (deri në 600 mijë tonë/vit) që mbulon rreth 5% të mallrave eksportuara-importuara. Terminalët e ekzistues Portit të Vlorës nuk janë të pajisura me infrastrukturë dhe/ose godina që sigurojnë lëndë djegëse të pastër në përputhje me Strategjinë e BE-së për reduktimin e emetimeve të GES-ve nga anijet në 50% deri në vitin 2030.⁵⁹ Pas zhvillimeve të fundit, procedurat për pasagjerët dhe mallrat do të transferohen në "Portin e Integruar në Triport" vetëm 10 km në veri të Vlorës, ku ndodhet aktualisht porti i peshkimit. Porti ekzistues i Vlorës do të shndërrohet në një port turistik ku do të akomodohen anije për qëllime argëtimi.⁶⁰

Transporti hekurudhor i mallrave është i pranishëm në Bashkinë Vlorë dhe i lidhur ngushtë me industrinë e naftës. Në bazë të një kontrate koncesionare, linja hekurudhore Ballsh-Fier dhe Fier-Vlorë, ofron transport hekurudhor të naftës bruto nga Fieri në Vlorë. Aktualisht, shifrat e transportit ditor të naftës bruto kanë arritur në më shumë se 2000 tonë.⁶¹ Transporti ajror do të jetë i disponueshëm në të ardhmen pas ndërtimit të aeroportit të Vlorës⁶² në ish-aeroportin ushtarak të Akërnit, në peizazhin e mbrojtur Pishë-Poro-Nartë.

Në bashkinë Vlorë ka **shërbim të transportit publik** (linja autobusi) dhe gjithsej 130 taksi të licencuara (nga të cilat 50 janë prodhuar në vitin 2020).⁶³ Të dhënat tregojnë se në periudhën 2018-2022, mjetet ishin kryesisht vetura (81.9%), pasuar nga mjete transporti të përziera (7%), motoçikleta (4.7%) dhe lloje të tjera mjeteesh (6.4%). Në përgjithësi, të dhënat tregojnë një sektor transporti **që varet kryesisht nga automjetet me naftë dhe benzinë**.

⁵⁷ Po aty

⁵⁸ Plani Vendor i Zhvillimit i Vlorës (2016),

⁵⁹ Ndërlidhja blu: Rrugët ujore detare dhe të brendshme në Gadishullin Ballkanik (2022) Shqipëri, f. 19-25

⁶⁰ Plani Kombëtar Sektorial i Transportit Detar dhe Infrastruktura Portuale (2020), i disponueshëm në: <https://planifikimi.gov.al/index.php?id=1120>

⁶¹ <https://albrail.al/en/rreth-nesh/>

⁶² <https://www.mabetex.com/project/vlora-international-airport/>

⁶³ PM-të me Bashkinë Vlorë, 8 shtator 2022

3 Qeverisja dhe kuadrot rregullatore dhe politikat, planet e programet përkatëse

Ky kapitull përshkruan shkurtimisht aspektet e sistemit të qeverisjes së Bashkisë Vlorë që lidhen me përshtatjen. Për fat të keq, ndërkohë që në nivel kombëtar mekanizmat janë disi më të zhvilluara, **integrimi i çështjeve të ndryshimeve klimatike dhe përshtatjes** në Bashkinë Vlorë **nuk ka nisur fare** për shkak të nivelit të njohurive, ekspertizës, dhe burimeve njerëzore, teknike e financiare.

3.1 Profili i qeverisjes në Vlorë

Në Shqipëri qeverisja vendore përbëhet nga zyrtarë të zgjedhur (kryetari dhe këshilli bashkiak), drejtoritë dhe zyrat e ndryshme me staf administrativ (nëpunësit civilë) të organizuara kryesisht në bazë të funksioneve themelore që ngarkohen me ligj, të cilat kanë të bëjnë me administrimin e shërbimeve vendore si punët publike, menaxhimi i mbetjeve, infrastruktura arsimore, etj.

Reforma administrative territoriale (2015) dhe grupimi i ish-bashkive dhe komunave në njësi të reja bashkiake çuan në krijimin e Bashkisë Vlorë, të organizuar në pesë njësi administrative. Bashkia e madhe e Vlorës përfshin edhe zonat urbane të qytetit të Vlorës dhe Orikumit dhe 37 fshatra. Megjithëse reforma ka përfunduar tashmë prej shtatë vjetësh, bashkitë përballen ende me vështirësi në mbledhjen dhe konsolidimin e informacionit, organizimin dhe zbatimin e funksioneve të veta, si dhe strukturimin e burimeve njerëzore. E njëjta gjë vlen edhe për Bashkinë Vlorë.

Bashkia është e organizuar në 14 Drejtori kryesore dhe disa Njësi, ku janë punësuar 964 punonjës, një numër i madh prej të cilëve (507) ushtrojnë kompetenca të deleguara.⁶⁴ Sektorët e planifikimit urban, turizmit dhe bujqësisë janë të organizuar nën drejtori të dedikuara. **PVZH-ja e Vlorës** i parashikon **turizmin** dhe sektorin e **transportit** si forcat kryesore shtytëse për zhvillimin vendor. Megjithatë, numri i kufizuar i punonjësve në të dy sektorët e bën të pamundur koordinimin efektiv ndërmjet departamenteve. Organigrama e Bashkisë nuk parashikon një funksion/pozicion të dedikuar pune lidhur me energjinë.

3.2 Objekti i Planit Vendor të Përshtatjes

Bashkitë kanë **mandat të qartë zyrtar në lidhje me ndryshimet klimatike**. Ligji nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike” parashikon që:

- bashkitë të hartojnë dhe zhvillojnë politika dhe masa për zbutjen e ndryshimeve klimatike në fushën e pylltarisë e bujqësisë, duke synuar reduktimin e emetimeve dhe përthithjes së karbonit të çliruar nga sektorët e bujqësisë, pylltarisë, përdorimeve të tjera të tokës dhe ruajtjes së ekosistemeve; *(neni 18)*
- bashkitë, për territorin nën juridiksionin e vet, të grumbullojnë, organizojnë dhe mbajnë të dhënat e tyre për klimën, së bashku me raportet për masat e marra ose të planifikuara për zbutjen e përshtatjes, dhe t’i vënë këto në dispozicion të ministrisë përkatëse”; *(neni 23)*
- bashkitë të hartojnë politika që nxisin sektorin publik dhe privat për investime të konsiderueshme që shkarkojnë pak GES, që janë transparente, kanë rezultate të parashikueshme, janë pak të ndikuara nga ndryshimet klimatike; *(neni 29, pika 1.)*
- bashkitë të përditësojnë politikat/dokumentet kombëtare, në mënyrë që të nxisin investimet

⁶⁴ Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 92, datë 23.11.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave dhe numrit të punonjësve të bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara për vitin 2024”

për projekte miqësore ndaj klimës, të mbështesin kërkimin shkencor dhe të nxisin praktikën më të mirë në fushat prioritare të prodhimit të energjisë, eficiencës së energjisë, transportit, ujërave, menaxhimit të mbetjeve, përdorimit të tokës, përshtatjes së infrastrukturës dhe mbrojtjes së natyrës. (neni 29, pika 2.)

3.3 Lidhjet me strategjinë kombëtare të zhvillimit/kuadrin e planifikimit

Në kuadër të Veprimit Prioritar Nr. 12 “Nisma për Planet Bashkiake të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike”, dokumenti i PKP-së parashikon hartimin e Planeve të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike për bashkitë e cënueshme nga efektet e ndryshimeve klimatike.⁶⁵

Në përputhje me Planin e Përgjithshëm Kombëtar, Planin e Integruar Ndërsektorial për Bregdetin dhe disa dokumente të tjera strategjike⁶⁶, **Plani i Përgjithshëm Vendor i Zhvillimit për Bashkinë Vlorë**, i miratuar në vitin 2017, identifikon strategjinë territoriale dhe prioritetet strategjike për zhvillimin e bashkisë në 15 vitet e ardhshme. Shumica e prioriteteve strategjike të përcaktuara në këtë dokument lidhen me sektorët prioritarë të PKP-së, ku energjia nuk është identifikuar si objektiva strategjike, siç theksohet në Tabela 3.1.

Tabela 3.1 _Përmbledhje e Objektivave Strategjike të PVZH-së së Vlorës në lidhje me sektorët prioritarë të PKP-së

| Dokumenti | Sektorët prioritarë të PKP-së | | | | |
|------------------|-------------------------------|---------|----------|------------|----------|
| | Planifikimi urban | Turizmi | Bujqësia | Transporti | Energjia |
| PVZH-ja e Vlorës | √ | √ | √ | √ | |

Burimi: Plani i Përgjithshëm Vendor i Zhvillimit i Bashkisë Vlorë, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 8, datë 08.02.2017, i disponueshëm në: <https://planifikimi.gov.al/index.php?id=732&L=2>

Për më tepër, Ligji nr. 28/2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 124/2015 “Për eficiencën e energjisë””, i ndryshuar, parashikon që Bashkitë të hartojnë **plane vendore veprimi për energjinë dhe ndryshimet klimatike**, në përputhje me Planin e Integruar të Energjisë dhe Klimës.

⁶⁵ Planifikimi Kombëtar i Përshtatjes (PKP) ndaj Ndryshimeve Klimatike në Shqipëri, Kuadri për Procesin e Vendit (2021), f. 66 – 67, i disponueshëm në: https://unfccc.int/sites/default/files/resource/National_Adaptation_Plan_Albania.pdf

⁶⁶ Dokumente të tjera strategjike përfshijnë Planin Kombëtar Sektorial të Transportit Detar dhe Infrastrukturës Portuale, Projektplanin e Zonave me Rëndësi Kombëtare Vjosë-Nartë, Planet e Menaxhimit për Zonat e Mbrojtura dhe Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë, etj.

4 Proceset që mbështesin hartimin e Planit Vendor të Përshtatjes

Procesi i Planit Vendor të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike dhe “mekanizmat” e tij janë koncepte mjaft të reja në nivel vendor. Sikurse u evidentua edhe nga ushtrimi “Vlerësimi i kapaciteteve të bashkive dhe nevojave për trajnim mbi Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike”,⁶⁷ në nivel vendor nuk ka organizime institucionale, mekanizma bashkërendimi, apo procedura konsultimi me palët e interesit.

4.1 Organizimi i nevojshëm institucional për procesin e PVP-së

Megjithatë, është shumë e rëndësishme të trajtohen shkurtimisht funksionet dhe përgjegjësitë kryesore të Bashkisë Vlorë lidhur me sektorët prioritarë të PKP-së siç reflektohet në nivel vendor. Vlerësimi i mënyrës sesi çdo sektor i PKP-së rregullohet në nivel vendor, kryesisht në aspektin e burimeve njerëzore, mundëson njohje më të mirë të nevojave për ndërtimin e kapaciteteve për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike për secilin sektor të Bashkisë Vlorë.

Tabela 4.1 _ Burime njerëzore të dedikuara që mbulojnë sektorët prioritarë të PKP-së në Bashkinë Vlorë

| Sektori prioritar i PVP-së | Drejtoria/sektori përgjegjës | Pozicionet që mbulojnë detyrat | si % e të gjithë stafit | Komente |
|-----------------------------|---|--------------------------------|-------------------------|---|
| Planifikimi Urban dhe Pyjet | Drejtoria e Urbanistikës | 22 | 6.3% | Drejtoria e ngarkuar me planifikimin urban dhe zhvillimin e territorit punëson urbanistë, arkitektë, inxhinierë ndërtimi, ekspertë të GIS-it. |
| | Sektori i Pyjeve dhe Kullotave | 8 | Nuk ka | Menaxhimi i pyjeve si funksion i transferuar nuk është pjesë e organizimit strukturor. |
| Turizmi | Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit | 4 | 1.2% | Ka një drejtor të dedikuar (1+3), por nuk është e qartë se sa specialistë mbulojnë turizmin. |
| Bujqësia | Drejtoria e Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit | 5 | 1.5% | Një Drejtor dhe 4 specialistë pranë njësisë së Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit Një njësi veterinare e dedikuar (1+3) për bagëtitë |
| | Bordi i Ujitjes dhe Kullimit | 17 | Nuk ka | Ujitja dhe kullimi si funksion i transferuar nuk është pjesë e organizimit strukturor. |
| Transporti | Drejtoria e Punëve Publike dhe Strehimit / Sektori i Punëve Publike | 1 | 0.3% | Një "specialist transporti" i dedikuar, që mbulon këtë sektor. |
| Energjia | Nuk ka | 0 | 0 | në Strukturën e miratuar të Bashkisë, nuk ka pozicion të dedikuar pune; |

Burimi: Struktura Organizative e Bashkisë Vlorë, e miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 92, datë 23.11.2023

Roli i menaxherëve të nivelit të ulët duhet të forcohet, në veçanti lidhur me çështjet e transportit, duke marrë parasysh diversitetin (hekurudhor, rrugor, detar, ajror) dhe rëndësinë e këtij sektori në zhvillimin e përgjithshëm të bashkisë.

⁶⁷ Projekti UNDP-PKP, Raport mbi “Vlerësimin e kapaciteteve të bashkive dhe nevojave për trajnim mbi përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike” (shkurt 2022)

4.2 Proceset e angazhimit të palëve të interesit

Me qëllim përfshirjen e një game të larmishme palësh interesi dhe integrimin e kontributit të tyre në Planet Vendore të Përshtatjes (PVP), Projekti “Përparimi i planifikimit të përshtatjes afatmesme dhe afatgjatë të Shqipërisë, përmes zhvillimit të një procesi të planifikimit kombëtar të përshtatjes” nisi një proces konsultimi me tetë bashki partnere, përfshirë Bashkinë Vlorë. Me ndihmën e projektit UNDP-PKP, procesi në Vlorë filloi në maj të vitit 2021. Duke pranuar risinë e temës, konsultimet u shtrinë përtej drejtorive të Bashkisë Vlorë, duke përfshirë aktorë të ndryshëm vendorë. Nëpërmjet korrespondencave, takimeve teknike dhe workshop-eve nga viti 2022 deri në 2023, projekti u angazhua me 64 persona (35 femra dhe 29 meshkuj), duke përfshirë përfaqësues të Bashkisë Vlorë, Prefekturës Vlorë dhe Agjencisë Rajonale të Zonave të Mbrojtura Vlorë (ARZM), Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier (që mbulon bashkitë Fier, Vlorë dhe Gjirokastër) dhe Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Lushnjë (që mbulon bashkitë Fier, Vlorë dhe Gjirokastër).

Procesi i hollësishëm është përshkruar në Shtojca I: Qasja e palëve të interesit lidhur me përgatitjen e Planit Vendor të Vlorës për Përshtatje të këtij dokumenti.

4.3 Kërkohej informacion shtesë/rregullim institucional për procesin e LAP.

Hartimi dhe më pas zbatimi i Planit të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike të Vlorës do të kërkojë burime njerëzore të dedikuara dhe të përmirësuara me qëllim drejtimin dhe bashkërendimin e procesit. Ndër këto masa, me rëndësi të madhe është përcaktimi i një **“pike kontakti”** për ndryshimet klimatike. Duhet të theksohet se **ky roli i ri duhet të zyrtarizohet sa më shpejt që të jetë e mundur** në Bashkinë Vlorë, **në kuadër të pozicioneve të përcaktuara qartë në strukturën e propozuar ose si pozicione të reja të posaçme.**

Planifikimi i PNK-së lidhet ngushtë edhe me prodhimin e statistikave: mbledhjen e të dhënave, mbledhjen e **të dhënave të ndara sipas gjinisë** të rëndësishme për zbatimin dhe monitorimin e veprimeve mbi ndryshimet klimatike me ndjeshmëri gjinore. Ka një pozicion pune të caktuar që merret me statistikën në Bashkinë Vlorë.

Tabela 4.2_ Burimet njerëzore të dedikuara që mbulojnë funksionet mbështetëse të PNK-së në Bashkinë Vlorë

| Prodhimi i statistikave | Drejtoria/sektori përgjegjës | Pozicionet që mbulojnë detyrat | Çështjet mjedisore | Drejtoria/sektori përgjegjës | Pozicionet që mbulojnë detyrat |
|-------------------------|---|------------------------------------|--------------------|--------------------------------------|---|
| | Drejtoria e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun | 1 (një specialist statistikash) | | Sektori i Planifikimit të Territorit | 1 (një specialist “inxhinier mjedisi”) |

Burimi: Struktura Organizative e Bashkisë Vlorë miratuar me Vendim të Kryetarit për vitin 2022

Me qëllim lehtësimin e ndarjes së komunikimit ndërmjet drejtorive përgjegjëse për sektorët prioritarë të PVP-së, **me vendim të Kryetarit mund të zyrtarizohet një grup pune për PNK-në** dhe të ngarkohet me përgjegjësi të hollësishme në Rregulloret e Brendshme.

Në përgjithësi, është e domosdoshme të përcaktohen qartë rolet dhe kompetencat zyrtare të individëve në fushën e tyre të punës, së bashku me përgjegjësitë e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, si pjesë e punës së tyre të përditshme.

5 Informacioni mbi ndryshimet klimatike

Klima e Shqipërisë aktualisht po ndryshon. Gjatë shekullit të shkuar, temperaturat janë rritur dhe regjimet e temperaturave e reshjeve kanë ndryshuar me rritjen e ndryshimeve mes stinëve dhe ndikimet e motit më ekstrem. Parashikohet që këto ndryshime të vijojnë dhe të intensifikohen gjatë dhjetëvjeçarëve të ardhshëm, ndërkohë që ndryshimet klimatike në të ardhmen parashikohet të jenë shumë më të theksuara se në të shkuarën. Aktualisht, ndryshimet klimatike po ndikojnë te bashkitë shqiptare, të cilat po përballen me përmbytje dhe zjarre në pyje. Veprimi i hershëm për t'u përshtatur me këto ndryshime do të ndihmojë për përmirësimin e aftësive ripërtëritëse dhe reduktimin e riskut. Ndryshimet klimatike janë sfida komplekse, pasi risqet janë të ndërlydhura dhe kanë mundësi të shkaktojnë ndikime të njëpasnjëshme.

5.1 Përkufizimi i termave kyç

- **Risku klimatik** është rezultat i probabilitetit të një rreziku (të intensifikuar nga ndryshimet klimatike) dhe i përmasave të efekteve negative të mundshme të këtyre kërcënimeve në shoqëri, mjedis dhe ekonomi. Identifikimi i riskut ka të bëjë me vlerësimin e riskut bazuar në analizat e mëparshme të rreziqeve të mundshme, ndikimeve të tyre në sektorë dhe cenueshmërisë së sektorëve përkatës. Prioritizimi i riskut bazohet në mundësinë e ndodhshmërisë së rrezikut dhe vlerësimin e pasojave.
- **Ekspozimi:** Masa (shpeshtësia dhe ashpërsia) e përjetimit të rrezikut klimatik në fjalë në vendndodhjen përkatëse. Ky vlerësim do të bazohet fillimisht në performancën aktuale në kushtet e sotme klimatike dhe në ngjarjet e fundit ekstreme, dhe më pas në mënyrën se si mund të ndryshojë ekspozimi në ndryshimet e ardhshme klimatike.
- **Ndjeshmëria:** Masa në të cilën rreziku klimatik mund të prekë bashkinë, pavarësisht vendndodhjes. Nëse ndikimet në asete ndikojnë në përgjithësi në ofrimin e shërbimit dhe shkaktojnë ndërprerje, ky do të jetë një prioritet për trajtim në fazën e ardhshme. Gjithashtu, në këtë kuadër duhet të merren parasysh risqet e ndërvarësisë dhe se si ndikimet në sisteme të tjera prekin bashkinë; për shembull, se si ngjarjet atmosferike ekstreme mund të sjellin ndërprerje të furnizimit me energji dhe se si kjo mund të ndikojë në sisteme.
- **Kapaciteti për përshtatje** është aftësia e sistemeve, institucioneve, njerëzve dhe organizmave të tjera për t'u përshtatur ndaj dëmeve të mundshme, për të shfrytëzuar mundësitë ose për t'iu përgjigjur pasojave. Nëpërmjet këtij vlerësimi synohet të njihen burimet e qytetit/bashkisë në lidhje me mundësinë e përdorimit të tyre për t'u bërë ballë rreziqeve me të cilat përballen qyteti.
- **Cenueshmëria** përbëhet nga ndjeshmëria dhe kapaciteti për përshtatje i sektorëve. Cenueshmëria mund të përkufizohet si prirja ose predispozita e një sistemi të caktuar për t'u ndikuar nga një kërcënim. Rezultatet e vlerësimeve të ndjeshmërisë dhe kapaciteteve për përshtatje përbëjnë bazën e vlerësimit të cenueshmërisë së sektorëve.
- **Vlerësimi i rrezikut klimatik** identifikon probabilitetin, intensitetin dhe shkallën kohore të rreziqeve kryesore në një bashki/qytet dhe shpërndarjen e tyre hapësinore në zonë, duke marrë parasysh prirjet historike të qytetit dhe situatën aktuale, si dhe skenarët e ardhshëm të bazuar në provat shkencore të disponueshme.
- **Vlerësimi i ndikimit të rrezikut klimatik** shqyrton ndikimet e mundshme të ngjarjeve të rreziqeve klimatike te njerëzit, asetet dhe shërbimet. Vlerësimi duhet të identifikojë: (1) grupet e popullsisë, sistemet dhe sektorët e cenueshëm, (2) kapacitetin e popullsisë dhe

sistemeve për t'u përshtatur ndaj rreziqeve dhe (3) ndikimin e mundshëm të njerëzimit dhe sistemet.

- Vlerësimi i riskut dhe ndikimeve bazohet te **Mundësia**: sa ka të ngjarë të ndodhë rreziku deri në vitin 2050 dhe te **Pasoja**: Ashpëria ose përmasat e ndikimit të lidhur me rrezikun klimatik, nëse ai ndodh. Në këtë kuadër merret në konsideratë një gamë e gjerë ndikimesh

5.2 Informacioni mbi klimën

Fokusi i këtij kapitulli është të kuptohet klima në mbarë Shqipërinë dhe të vlerësohet niveli i saj i qëndrueshmërisë dhe cenueshmërisë. Ky vlerësim bazohet në ekspozimin e Shqipërisë ndaj rreziqeve klimatike.

Për këtë arsye, vlerësimi përqendrohet kryesisht në risqet fizike të drejtpërdrejta dhe të tërthorta (**Risku = ekspozimi ndaj rrezikut x ndjeshmëria x kapaciteti për përshtatje**) dhe mundësitë në kuadër të ndryshimeve klimatike. Në bazë të këtyre risqeve do të hartohen planet bashkiake për përshtatjen. Qëllimi është që politikëbërësve dhe vendimmarrësve t'u sigurohet informacion rreth risqeve klimatike, të cilat mund të kenë ndikimin më të madh në shoqëri, ekonomi dhe mjedis, duke u mundësuar hartimin e planeve të bazuara në prova dhe të qëndrueshme në të ardhmen. Gjetjet dhe rekomandimet e vlerësimit ofrojnë gjithashtu informacion të vlefshëm mbi risqet dhe mundësitë që duhet të trajtohen.

5.2.1 Ndryshimet aktuale klimatike në Shqipëri


Klima e Shqipërisë është klimë tipike mesdhetare, e karakterizuar nga dimri i butë me reshje të bollshme dhe vera e nxehtë dhe e thatë. Për shkak të topografisë shumë të thyer, në këtë klimë tipike mesdhetare vërehen luhajtje të konsiderueshme klimatike. Luhajtjet e vlerave mesatare vjetore të temperaturës dhe reshjeve paraqiten në Tabela 5.1.

Tabela 5.1 _ Luhajtjet e vlerave mesatare vjetore të temperaturës dhe reshjeve

| Vlerat vjetore | Min | Maks |
|---------------------|------|------|
| Tmin mesatare (°C) | -3.1 | 13.1 |
| Tmaks mesatare (°C) | 5.3 | 22.9 |
| Tmes mesatare (°C) | 1.1 | 17.4 |
| Reshjet (mm) | 370 | 3260 |

Figura 5.1 ilustrohet shpërndarjen gjeografike të mesatareve vjetore (periudha 1996-2015) të temperaturave të mesme maksimale (Tmaks) dhe minimale (Tmin)

Figura 5.1 _ Shpërndarja e temperaturave mesatare vjetore



Që nga viti 1960, klima e Shqipërisë ka ndryshuar në mbarë territorin. Vihen re dy periudha të veçanta: a) vlerat mesatare vjetore kanë pësuar rënie midis viteve 1960 dhe 1990 dhe më pas b) kanë pësuar rritje. E njëjta gjë nuk ndodh me **reshjet**. Vëzhgimet tregojnë luhatje, por jo një prirje të qartë për të gjithë vendin.

Analiza e klimës për zonën e Vlorës paraqitet shkurtimisht si më poshtë.⁶⁸

Figura 5.2 _ a) shpërndarjavjetore e Tmaks mesatare vjetore; b) shpërndarja mujore të temperaturave mesatare vjetore




Figura 5.1 paraqet shpërndarjen vjetore të temperaturës mesatare maksimale të zonës së Vlorës për


⁶⁸ Projekti UNDP-PKP, Raporti mbi cenueshmërinë klimatike dhe ndryshimet e pritshme në Bashkinë Vlorë, Bruci E. (janar 2024)

periudhën 1951-2010⁶⁹. Vija e pikëzuar paraqet prirjen polinomiale. Vihet re një variacion i temperaturës maksimale mesatare vjetore: a) vlerat kanë pësuar rënie midis viteve 1960 dhe 1980, b) rritje deri në vitin 2000 dhe më pas c) një rënie të lehtë. Në temperaturat minimale mesatare vjetore është konstatuar një prirje në rritje. Rritja e temperaturës gjatë periudhës 2001-2010 është mjaft e dukshme krahasuar me periudhën 1981-90 (Figura 5.2_ b). Për këtë arsye, numri i ditëve të nxehta ($T_{\text{maks}} \geq 35^{\circ}\text{C}$) është rritur dhe i atyre të ftohta ($T_{\text{min}} \leq 0^{\circ}\text{C}$) dhe shumë të ftohta ($T_{\text{min}} \leq -5^{\circ}\text{C}$) është ulur në periudhën 2001-2010, krahasuar me periudhën e mëparshme.

Në dallim nga shpërndarja e temperaturave, ajo e reshjeve nuk tregon një prirje të qartë, vetëm luhajtje (Figura 5.3). Sasia e reshjeve vjetore gjatë periudhës së marrë në konsideratë luhatet ndërmjet 500 mm (1953) dhe 1,350 mm (1960).

Për shkak të ndërprerjes së vëzhgimeve të reshjeve për një kohë të gjatë, nuk është e mundur të zbulohet ndonjë prirje (Figura 5.3). Sasia e reshjeve vjetore gjatë periudhës së marrë në konsideratë luhatet ndërmjet 330 mm (2003) dhe 1,574 mm (1960). Sasia e përgjithshme e dytë më e lartë e reshjeve është regjistruar në vitin 1962 me 1,540mm. Reshjet mujore deri në 100 mm/muaj janë më të shpeshta. Një rast ekstrem prej 385 mm është regjistruar në tetor të vitit 1985.

Figura 5.3_ Shpërndarja e reshjeve vjetore (1951 – 2010)



5.2.2 Parashikimet për të ardhmen për Shqipërinë


Me qëllim vlerësimin e ndryshimeve klimatike, komuniteti shkencor ka hartuar Rrugët e Përbashkëta Socio-ekonomike (SSPx-Y)⁷⁰, skenarët e ndryshimeve klimatike të ndryshimeve për ndryshimet e parashikuara socio-ekonomike botërore deri në vitin 2100, siç përcaktohet në Raportin e Gjashtë të Vlerësimit të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (PNKK). Këto përdoren për të hartuar skenarë të emetimeve të gazeve me efekt serrë, së bashku me politika të ndryshme klimatike.

Ndryshimet e vëzhguara dhe të simuluar lidhur me temperaturën e sipërfaqes në krahasim me periudhën 1850 – 1900 në shkallë botërore paraqiten në Figura 5.4.

⁶⁹ Të dhënat e ofruara nga IGEO për periudhën 2011 – 2020 nuk ishin të besueshme

⁷⁰ Në Shtojcën II të këtij dokumenti jepet një përshkrim i shkurtër i pesë SSP-ve

Figura 5.4 _ Ndryshimi botëror i temperaturës së sipërfaqes në krahasim me periudhën 1850 – 1900



Burimi: TS, Ndryshimet klimatike 2021: Baza e Shkencës Fizike. Kontributi i WGI-së për AR6 të PNNK-së (TS, Climate Change 2021: The Physical Science Basis. Contribution of WGI to the AR6 of the IPCC)

Rritja e parashikuar e temperaturës globale sipas skenarëve të ndryshëm (në shkallë globale) dhe përshkrimet e skenarëve të përshtatur për Shqipërinë janë paraqitur në Shtojca II: Parashikimet për ndryshimet klimatike.

Analiza e mëposhtme mbi ndryshimet e pritshme klimatike bazohet në skenarët e SSPx-y të hartuar për Shqipërinë⁷¹. Në shumicën e rasteve, analiza përqendrohet në SSP 1-1.9 (që janë në përputhje me Marrëveshjen e Parisit për ndryshimet klimatike)⁷² dhe skenarin e lartë SSP 3-7.0. Figura 5.5 tregon se rritja e temperaturës Tmaks ka gjasa të vërtetohet deri në vitin 2050 krahasuar me periudhën bazë. Në të gjithë vendin pritet pakësim i sasisë së përgjithshme reshjeve. Më konkretisht, për zonën e Vlorës:

Temperatura

- SSP1-1.9 dhe SSP1-2.6 parashikojnë rritjen më të ulët të Tmes. Ndryshimet vjetore të Tmes në lidhje me periudhën referencë klimatologjike (1996-2015) ka të ngjarë të arrijnë përkatësisht deri në 0.9°C (0.6°C deri në 1.3°C) dhe 1.1°C (0.7°C deri në 1.6°C) deri në vitin 2050.
- Skenari mesatar SSP2-4.5 parashikon ndryshime që ka të ngjarë të luhaten nga 1.0°C në 2.1°C (vjetor) dhe nga 1.3°C në 2.6°C (verë) deri në vitin 2050.
- Skenarët agresivë dhe shumë agresivë, SSP3-7.0 dhe SSP5-8.5, zbulojnë parashikimet më të këqija, veçanërisht në verë.
- Ndryshimet e pritshme vjetore dhe të verës ka të ngjarë të arrijnë deri në përkatësisht 1.9°C (1.4°C deri në 2.8°C) dhe 2.3°C (1.7°C deri në 3.4°C) deri në vitin 2050, dhe mund të jenë edhe më të larta deri në vitin 2100.⁷³
- Numri i ditëve të nxehta dhe valëve të të nxehtit pritet të rritet sipas të gjithë skenarëve në të gjitha zonat klimatike në krahasim me periudhën referencë, veçanërisht sipas SSP3-7.0 dhe SSP5-8.5. Nga ana tjetër, numri i ditëve të ftohta dhe shumë të ftohta dhe i valëve të të

⁷¹ Skenarët e ndryshimeve klimatike për Shqipërinë janë zhvilluar nëpërmjet zvogëlimit të skenarëve globalë SSPx-y për temperaturën dhe reshjet, me një rezolucion 1*1 km, duke përdorur SimCLIM AR6 në nivele vjetore dhe sezonale deri në vitin 2100. Viti 2005 (mesatarja e periudhës 1996-2015) përdoret si referencë për simulimet. Analiza e rezultateve përqendrohet në periudhën 2021-2040 (2030_qendër) dhe 2041-2060 (2050_qendër). Për lehtësi, në vijim, raporti do t'i referohet këtyre dy periudhave me vitet qendrore 2030 dhe 2050.

⁷² Qëllimi kryesor i Marrëveshjes së Parisit, që është traktat ndërkombëtar ligjërishit detyrues, është ta mbajë "rritjen e temperaturës mesatare botërore në vlerë dukshëm më të ulët sesa 2°C mbi nivelet paraindustriale" dhe të përpiqet "të kufizojë rritjen e temperaturës në 1.5°C mbi nivelet paraindustriale".

⁷³ Projekti UNDP-PKP, Raporti mbi cënueshmërinë klimatike dhe ndryshimet e pritshme në Bashkinë Vlorë, Bruci E. (janar 2024)

ftohtit pritet të ulet sipas të gjithë skenarëve.

- Shpeshtësia dhe intensiteti i Tmaks absolute pritet të rriten, ndërsa vlerat përkatëse për Tmes absolute të ulen.

Figura 5.5 _ Shpërndarja e ndryshimeve të Tmaks gjatë verës deri në vitin 2050





Figura 5.6 tregon ndryshimet e pritshme të Tmes vjetore në lidhje me periudhën referencë.

Figura 5.6 _ Ndryshimet e pritshme në vlerat e Tmes sezonale në Vlorë



Shënim: vijat e pandërprera tregojnë vlerat mesatare; ato pritet të ndryshojnë ndërmjet vijave me pika, të cilat u referohen përkatësisht përqindjeve 95% dhe 5%.

Parashikimet e reshjeve


- Të gjitha SPP-të tregojnë rënie të mundshme të reshjeve vjetore dhe sezonale krahasuar me periudhën 1995-2015 për të gjitha intervalet kohore deri në vitin 2100 dhe parashikimi i variacionit të vlerave mesatare (nivelet 5% dhe 95%) është i lartë.⁷⁴
- Projektet e skenarit të ulët SSP1-1.9 ulen me -2.3% (-15.5% deri në +9.9%) dhe -10.2% (-27.5% deri në +8.3%) përkatësisht për vitin dhe verën, deri në vitin 2050.
- Skenari SSP3-7.0 parashikon rënien më të lartë në përqindje të reshjeve sesa SSP1-1.9. Vlerat vjetore dhe të verës kanë gjasa të arrijnë deri në përkatësisht -4.2% (-27.8% deri në +17.7%) dhe -18.2% (-49.4% deri në +15.0%) deri në vitin 2050.
- Reduktimi i lartë në nivelin e përqindjes 5% të ndryshimeve tregon një rritje të mundshme të

⁷⁴ Po aty

frekuencave të thatësirës (ulja prej rreth -100% në kohën e verës pas vitit 2070 (Figura 5.7).

- Rritja e lartë në 95%-shin e ndryshimeve tregon risk të mundshëm më të lartë për intensifikim të reshjeve të dendura që mund të shkaktojnë përmytje.
- Periudhat e kthimit të niveleve maksimale të reshjeve pritet të bien. Reshjet intensive më të shpeshta dhe me kohëzgjatje më të madhe mund të shkaktojnë përmytje dhe dëme ekonomike.

Figura 5.7 _ Ndryshime të mundshme në reshjet e verës në Vlorë




Shënim: vijat e pandërprera tregojnë vlerat mesatare; ato pritet të ndryshojnë ndërmjet vijave me pika, të cilat u referohen përkatësisht përqindjeve 95% dhe 5%.

Rritja e nivelit të detit

Sipas skenarit mesatar SSP2-4.5, niveli i detit pritet të rritet me 24 cm (6 deri në 30 cm) dhe 65 cm (17 deri në 83 cm) përkatësisht deri në 2050 dhe 2100 në krahasim me periudhën 1995-2015. Vlerat e pritshme të rritjes së nivelit të detit sipas SSP3-7.0 kanë gjasa të arrijnë 26cm (7cm deri në 33cm) dhe 79cm (21cm deri në 100cm) përkatësisht deri në vitin 2050 dhe 2100 (Figura 5.8).

Figura 5.8 _ Ndryshime të mundshme në nivelin e detit, SSPx-y të ndryshme, Deti Adriatik



5.2.3 Rreziqet

Rreziqet natyrore në Shqipëri, si stuhitë e forta, përmbytjet, valët e të nxehtit dhe zjarret në pyje, po bëhen më të shpeshta, më të paparashikueshme dhe më të ashpra për shkak të prirjeve të parashikuara të ndryshimeve klimatike. Shqipëria përballet me shtim të sfidave për sa i përket qëndrueshmërisë bujqësore, prodhimit të energjisë dhe ruajtjes së shëndetit të popullsisë. Këto vështirësi do të përkeqësohen si pasojë e trysnive klimatike dhe degradimit mjedisor, që si pasojë do të ndikojnë të burimet ujore. Shqipëria dhe bashkitë e saj nuk po e nisin punën nga zero; planifikimi, sigurimi i fondeve dhe mbledhja e të dhënave në nivel bashkiak kanë nisur tashmë në mbështetje të përgatitjes dhe përshtatjes, në fusha kyç, me klimën që po ndryshon.

Ndikimet klimatike përfshijnë pasoja të shumëfishta të valëve të të nxehtit, thatësirave, përmbytjeve dhe rritjes së nivelit të detit, më të gjata dhe/ose më intensive, siç janë ndikimet e njëpasnjëshme në ekosistemet detare dhe tokësore, si dhe në përdorimin e tokës dhe detit (bujqësia, pylltaria, turizmi, etj.) dhe shëndetin e njeriut.

Ndikimet e pritshme klimatike nga ekspozimi ndaj këtyre rreziqeve **në të gjithë Shqipërinë** janë si më poshtë:

- **Ndryshime në temperaturë**
Shqipëria do të përballet me stres për ujë deri në vitet 2050 dhe stres të theksuar për ujë deri në vitet 2090, me thatësira të rënda në zonat qendrore dhe jugore.
- **Reshjet**
Ndryshimet klimatike pritet të rrisin rrezikun dhe intensitetin e reshjeve të dendura dhe ngjarjeve të përmbytjeve që çojnë në rritjen e rrezikut të humbjes së jetës dhe dëmtimit të pronës dhe infrastrukturës nga përmbytjet e drejtpërdrejta dhe/ose rrëshqitjet e dheut dhe erozioni i tokës. Ka gjasa që shirat intensivë, erozioni i lumenjve dhe përmbytjet të dëmtojnë infrastrukturën dhe strukturat e menaxhimit të ujërave.
- **Rritja e nivelit të detit dhe stuhitë detare**
Rritja e nivelit të detit dhe intensifikimi stuhive detare do të dëmtojnë infrastrukturën bregdetare, përfshirë objektet e turizmit dhe tokën bujqësore, dhe do të rezultojnë në

përmbytje të shtuara.


- **Zjarret në pyje**

Ndikimi i erës/temperaturave ekstreme mund të përkeqësojë ndikimin e zjarreve në pyje.

5.3 Qasja e vlerësimit të riskut dhe cenueshmërisë

Në kuadër të vlerësimit, më poshtë paraqitet një metodologji dhe qasje e zakonshme. Ky dokument udhëzues ofron informacione për secilin prej këtyre hapave:

Figura 5.9 _ Metodologjia



Në kuadër të kësaj qasjeje, kuptohet klima në mbarë Shqipërinë dhe vlerësohet niveli i qëndrueshmërisë dhe cenueshmërisë së vendit. Nuk jemi të sigurt si do të jetë klima e së ardhmes, kështu që planifikimi duhet të bëhet mbi bazën e skenarëve që pasqyrojnë klimën në ndryshim.

Hapat janë përshkruar më poshtë:

1. Fillojmë me identifikimin e rrezikut, ku vlerësojmë mangësitë kritike, mbivendosjet dhe mospërputhjet në klasifikimin e rreziqeve klimatike dhe shqyrtojmë ekspozimin e këtyre rreziqeve në Shqipëri.

2. Më pas, vlerësojmë ndikimin e rrezikut në sektorët kyç, së bashku me nivelin e ndjeshmërisë së tij.

3. Pastaj, vlerësojmë **kapacitetin për përshtatje** të sektorit.

4. Kapaciteti për përshtatje, së bashku me ndjeshmërinë e tij, lejuan vlerësimin e pikëzimit përfundimtar të cenueshmërisë. Vlerësimi i ndjeshmërisë dhe cenueshmërisë mundëson njohje të priorizimit të risqeve.

5. Hapi tjetër është vlerësimi i risqeve dhe priorizimi i tyre bazuar te mundësia dhe pasojat e ngjarjes së rrezikut.

njeriu (riformatuar nga metodologjia GCAP e BERZH-it)

Kapaciteti për përshtatje i ekosistemeve dhe sistemeve njerëzore pritet të përballet me pengesa të fuqishme për shkak të efekteve ndërvepruese, kumulative dhe të njëpasnjëshme të thatësirave, valëve të të nxehtit, rritjes së nivelit të detit, etj. Vlerësimi i kapacitetit aktual për përshtatje të burimeve të Shqipërisë në lidhje me mundësinë e përdorimit të tyre për t'u bërë ballë rreziqeve klimatike paraqitet në Tabela 5.4.

Tabela 5.4 _ Kapaciteti për përshtatje i Shqipërisë

| | | Sistemet dhe shërbimet shqiptare | Kapaciteti për përshtatje |
|----|--|----------------------------------|---------------------------|
| 1. | Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar | Siguria publike | Ndikim i moderuar |
| | | Mirëqenia sociale | Ndikim i moderuar |
| | | Strehimi | Ndikim i moderuar |
| 2. | Infrastruktura | Transporti dhe lëvizshmëria | Ndikim i ulët |
| | | TIK-u | Ndikim i ulët |
| 3. | Biznesi dhe industria | Bujqësia (Ushqimi) | Ndikim i moderuar |
| | | Turizmi | Ndikim i lartë |
| 4. | Mjedisi natyror | Biodiversiteti | Ndikim i moderuar |

Vlerësimi i cenueshmërisë së qytetit ndaj rreziqeve është rezultat i vlerësimit të ekspozimit, dhe ndjeshmërisë së qytetit dhe sektorëve të tij kyç ndaj rreziqeve dhe faktorëve klimatikë në ndryshim, si dhe i vlerësimit të kapacitetit të tij për përshtatje. Shkalla e cenueshmërisë është paraqitur në Shtojca III: Integrimi i vlerësimeve të cenueshmërisë dhe të riskut të këtij dokumenti.

Matrica e cenueshmërive aktuale të Shqipërisë paraqitet në Tabela 5.5.

Tabela 5.5 _ Matrica e cenueshmërive aktuale të Shqipërisë ndaj riskut

6 Ndikimet sektoriale

Ky seksion paraqet ndikimin e potencialit klimatik në **Bashkinë Vlorë**. Ndër të tjera, bashkitë duhet të presin si stuhi më ekstreme, ashtu edhe valë më ekstreme të të nxehtit dhe periudha të thata, për të cilat nevojiten përgatitje më afatgjata. Në këtë rast, sfida kryesore është mungesa e vlerësimeve bazë ose e strategjisë së aftësive ripërtëritëse në nivel bashkie, në të gjithë bashkitë në Shqipëri. Workshop-et me palët e interesit kanë theksuar se ndryshimet klimatike dhe moti ekstrem janë sfidat madhore për bashkitë. Këto goditje dhe strese mund të ndodhin edhe njëkohësisht në bashki, ose mund të shkaktojnë ndikime të njëpasnjëshme te bashkitë e tjera. Ky seksion **do të përqendrohet kryesisht në rreziqet më kritike dhe më të mundshme dhe ato që mund të kenë ndikim.**

Në këtë kapitull identifikohet regjistri i riskut dhe mundësive, si përgjigje për shtimin e risqeve dhe ndikimeve nga ndryshimet klimatike aktuale dhe të ardhshme në Bashkinë Vlorë, asetet dhe veprimtaritë e saj. Hapi i parë ishte përcaktimi i rreziqeve klimatike, duke identifikuar përmasën dhe natyrën e rreziqeve të shkaktuara nga ndryshimet klimatike. Më pas, ai është fokusuar dhe ndarë sipas sektorëve kyç, konkretisht: (1) njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar, (2) infrastruktura, (3) biznesi, (4) mjedisi natyror dhe (5) asetet dhe veprimtaritë e Bashkisë ku përfshihen bujqësia, energjia, transporti, zhvillimi urban dhe turizmi.

Për sa i përket qasjes metodologjike, fillimisht u vlerësua një listë e gjatë risqesh lidhur me rëndësinë e tyre për secilën bashki; ato që u konsideruan pa rëndësi u hoqën dhe u shtuan risqe të tjera specifike për secilën bashki. Më pas, u krye një vlerësim për të kuptuar më mirë kontekstin aktual vendor dhe cenueshmëritë specifike të secilës bashki, çka mundësoi vlerësimin e shkallës së çdo risku. Ky vlerësim u krye nëpërmjet hulumtimit të dokumentacionit dhe studimit të literaturës, si dhe konsultimit me palët e interesit përmes workshop-eve me ta në Tiranë dhe në secilën bashki. Së fundi, risqet u vlerësuan lidhur me ndikimin dhe gjasat e tyre, duke lejuar prioritizimin e risqeve, siç paraqiten në Figura 6.1.

Figura 6.1 _ Grafiku që tregon panoramën e përgjithshme të metodologjisë

| | |
|--|--|
| Hapi 1: Vlerësimi i ndryshimeve klimatike aktuale dhe të ardhshme | Hapi 2: Identifikimi i risqeve dhe mundësive përkatëse |
| Hapi 2a: Angazhimi i palëve të interesit dhe hulumtimi I dokumentacionit për të shqyrtuar risqet dhe për të kuptuar më mirë kontekstin vendor të risqeve | Hapi 3: Pikëzimi i risqeve |

6.1 Hapi 1: Vlerësimi i ndryshimeve klimatike aktuale dhe të ardhshme

Analiza e ndryshimeve të klimës dhe parashikimet për të ardhmen paraqiten në seksionet 5.3 dhe 5.4.

Më poshtë renditen disa ndikime kryesore të ndryshimeve klimatike në të ardhmen.

Ndryshimet në temperaturë:

- Parashikohet që për çdo skenar të ketë rritje të temperaturave në të gjitha stinët, në bashkinë e Vlorës:
 - Temperaturat mesatare, maksimale dhe minimale të verës dhe dimrit do të rriten të gjitha në mënyrë progresive përgjatë shekullit;
 - Rritja e temperaturave të dimrit ka një ndikim negativ për ngricat dhe reshjet e borës. Kjo sjell ndikime të mëtejshme mbi biodiversitetin që i është përshtatur temperaturave aktuale. Ka edhe ndikime në prurjet e lumenjve;
 - Rritja e temperaturave në verë mund të sjellë risqe të valëve të të nxehtit për popullatën. Për më tepër, disa ndërtesa, të cilat nuk janë projektuar për verëra të ngrohta, mund të mos e mbajnë temperaturën në nivele të përshtatshme.
- Disa përfitime mund të ndodhin për shkak të dimrave më të ngrohtë, si për shembull më pak ngrohje dimërore që nevojitet në shtëpi. Ka gjasa që kërkesa për energji për ftohje të rritet dhe ajo për ngrohje të ulet, duke pasur parasysh gjetjet mbi ditët e ngrohta dhe të ftohta.
- Vera më e ngrohtë mund të ndikojë pozitivisht te turizmi.
 - Zgjatja e sezonit turistik veror (kushte shumë të mira nga fundi i marsit - fillimi i tetorit deri në mes të marsit - mesi i tetorit (për SSP5-8.5)).

Ndryshimet në reshje:

- Intensifikimi i mundshëm i reshjeve të dendura dhe shpeshtësia e tyre do të përbëjë risk më të lartë për përmytje. Kjo mund të ndikojë te banesat e reja në zonat periferike të Bashkisë Vlorë. Niveli afatshkurtër i reshjeve intensive është i ngjashëm me kushtet aktuale. Kjo do të thotë që reshjet e verës pritet të jenë me intensitet të lartë dhe kohëzgjatje të shkurtër.
- Temperaturat më të larta të verës dhe një rritje e pritshme e reshjeve afatshkurtra me intensitet të lartë do të rrisë riskun për përmytje nga ujërat sipërfaqësore dhe riskun për përmytje nga rrjedhat ujore të vogla/të përkohshme. Kjo përkthehet në risk më të madh përmytjesh në muajt e dimrit, veçanërisht nëse lumenjtë apo sistemet e kullimit mbingarkohen.
- Së bashku me shtimin e reshjeve pritet edhe rritja e temperaturës në dimër, megjithëse pjesa më e madhe e këtyre reshjeve pritet të bjerë në formë shiu.

Rritja e riskut për përmytje:

- Risku për përmytje pritet të jetë i lartë në të ardhmen si pasojë e dy faktorëve:
 - Përmytjet e befasishe të lumit Vjosa për shkak të rritjes së shpeshtësisë dhe intensitetit të reshjeve të dendura. Figura 6.2 _ Përmytja nga rritja e nivelit të ujit në lumin Vjosa (periudha e kthimit një herë në 100 vjet) ilustron përmytjen e lumit Vjosa me një periudhë kthimi një herë në 100 vjet, një ngjarje që mund të ndeshet më shpesh në të ardhmen.
 - Risku në të ardhmen për shkak të rritjes së mundshme të nivelit të detit dhe rritjes së stuhive detare. Pritet një ndikim i mundshëm për shkak të rritjes së pritshme të nivelit të detit (sipërfaqet prej rreth 8,250 ha, 11,000 ha dhe 1,250 ha kanë gjasa të përmyten për 3 nivele të ndryshme, përkatësisht 0.33m, 0.9m dhe 1.0m). (Figura 6.3)
- Kjo mund të ndikojë te banesat e reja në zonat periferike të Bashkisë Vlorë.

Figura 6.2_ Përmbytja nga rritja e nivelit të ujit në lumin Vjosa (periudha e kthimit një herë në 100 vjet)



Shënim: përparitur nga A. Zotaj, burimi i të dhënave: Agjencia Evropiane e Mjedisit (2020)⁷⁵

⁷⁵ Shtirja e zonës së mundshme të predispozuar për përmbytje sipas EEA, janar 2020 <https://sdi.eea.europa.eu/catalogue/srv/eng/catalog.search#/metadata/28c36420-c31b-440e-80c5-8064696f3517>

Figura 6.3_ Përmblytje nga rritja e pritshme e nivelit të detit



Shënim: përgatitur nga A. Zotaj

6.2 Hapi 2: Identifikimi i riskut

Gjatë këtij hapi, provat e ndryshimeve klimatike për secilën bashki, të përgatitura në hapin 1, u përdorën për identifikimin e risqeve dhe mundësive. Fillimisht u vlerësua një listë e gjatë risqesh lidhur me përkatësinë e tyre për secilën bashki; ato që u konsideruan pa rëndësi u hoqën dhe u shtuan risqe të tjera të veçanta për secilën bashki. Më pas, u krye një vlerësim për të kuptuar më mirë kontekstin aktual vendor dhe cenueshmëritë specifike të secilës bashki, çka mundësoi vlerësimin e shkallës së riskut. Kjo u realizua përmes hulumtimit dhe studimit të literaturës, si dhe konsultimit me palët e interesit. Në këtë kuadër u shqyrtuan

risqet dhe u diskutua si mund të ndikojnë ato në secilën bashki në varësi të kontekstit vendor.

Risqet u ndanë në risqe për: 1) njerëzit, shëndetin, komunitetin dhe mjedisin e ndërtuar, (2) infrastrukturën, (3) biznesin dhe industrinë (përfshirë turizmin dhe bujqësinë) dhe (4) mjedisin natyror.

Në fund, u ndërmor një vlerësim shtesë për identifikimin e risqeve të lidhura drejtpërdrejt me veprimtaritë e secilës bashki. Risqet e identifikuar paraqiten së bashku me pikëzimin përkatës në Seksionin 6.3.

6.3 Hapi 3: Pikëzimi i riskut

Pasi u identifikuan të gjitha risqet, u ndërmor vlerësimi i nivelit të lartë të risqeve të mundshme, ndikimeve të tyre, probabilitetit të vërtetimit të tyre dhe përgjigjes së nevojshme nga ana e këshillit. Çdo risk u vlerësua sipas ndikimit të mundshëm të riskut që ndodhte dhe probabilitetit të vërtetimit të riskut. Ky vlerësim u bazua te të dhënat më të mira të disponueshme në momentin e vlerësimit. Të njëjtat kritere u përdorën për të dyja risqet e veçanta për secilën bashki si institucion. Parashikohet që bashkitë e Shqipërisë të përballen me një sërë rreziqesh të ndryshme klimatike në të ardhmen. Këto përfshijnë rritje/ulje të temperaturës dhe reshjeve.

Vlerësimi i probabilitetit përqendrohet te ndikimi në bashki:

- I ulët: Ky rrezik nuk ka gjasa të ndodhë dhe të ndikojë te bashkia.
- Mesatar: Ky rrezik është parashikuar të ndodhë në bashki.
- I lartë: Ky rrezik ka shumë gjasa të ndodhë në bashki.

Llogaritja e ndikimit të riskut (i ulët, mesatar, i lartë) bazohet në

Ekspozimin ndaj rrezikut x ndjeshmërinë x kapacitetin për përshtatje

Për shembull, kur "Risqet për biznesin nga përmbytjet" merren parasysh në sektorin e turizmit:

- **Ekspozimi** ndaj rrezikut është i lartë
- Matrica e ndjeshmërisë (Tabela 5.3) tregon se **ndjeshmëria** e turizmit **ndaj përmbytjeve** është e lartë (Pikëzimi 3)
- **Kapaciteti** aktual për përshtatje i sektorit të turizmit (Tabela 5.4) është i lartë (Pikëzimi 3)
- Matrica e riskut të cenueshmërisë (Tabela 5.5) tregon se cenueshmëria e sektorit të turizmit **ndaj përmbytjeve** është e lartë (3)

Kriteret për përcaktimin e riskut të ulët, mesatar ose të lartë, përfshijnë kritere financiare, sociale, shëndetësore dhe mjedisore, dhe paraqiten në *Tabela 8.5* të Shtojca IV: Kriteret e pikëzimit të riskut.

Më pas, rezultati i riskut u mor në konsideratë së bashku me provat e ndryshimeve klimatike dhe veçanërisht në shekullin kur do të konkretizoheshin risqet. Duke marrë këto dy elemente së bashku, u arrit në një kategorizim i nivelit të lartë të përgjigjes së bashkisë për secilin risk.

Nëse do të kishte mungesë provash lidhur me ndikimet e riskut, probabilitetin e tij ose cenueshmërinë e Vlorës ndaj risqeve, edhe risqet do të shënoheshin si: "*Nevojitet hulumtim/kuptim i mëtejshëm*".

Kufizimet e vlerësimit janë si më poshtë:

- Pikëzimi i risqeve u bazua te provat e mbledhura në dispozicion dhe te gjykimi i palëve të

interesuara që morën pjesë në workshop. Vlerësimi i hollësishëm sasior i secilit risk më vete ishte përtej objektit të këtij projekti.

- Kategorizimi i përgjigjes së secilës bashki bazohet në vlerësim në shkallë të gjerë dhe të bazuar në fakte, edhe pse ky sistem kategorizimi është deri diku subjektiv dhe duhet të përdoret me kujdes. Të gjitha risqet paraqesin kërcënim për bashkitë dhe për këtë arsye të gjitha risqet duhet të merren parasysh në planet e përshtatjes; ky vlerësim synon vetëm të japë udhëzime lidhur me prioritizimin. Për më tepër, disa përgjigje kërkojnë vite për t'u zbatuar, duke e detyruar secilën bashki t'i rivlerësojë rregullisht këto risqe.
- Në shumë bashki duhet ende të zbatohen ndryshimet institucionale për të rritur përgatitjen e sistemeve të shumta të qyteteve në kuadër të përmbytjeve ose goditjeve të tjera. Përgatitja për raste emergjence mund të përmirësohet përmes planifikimit më të mirë, sistemit të informacionit për risqet dhe administrimit të qarkullimit. Bashkitë duhet të punojnë për hartimin e vlerave bazë për emetimet dhe të zbatojnë ndryshimet, me qëllim arritjen e përputhshmërisë me një buxhet të emetimeve të gazeve me efekt serrë, sipas një skenari të ndryshimeve klimatike të ngrohjes me 1.5°C për deri në vitin 2100.

6.4 Analiza sektoriale dhe mundësitë për Bashkinë Vlorë

Gjatë hartimit të bazës fillestare për Bashkinë Vlorë janë marrë parasysh të dhënat e mëposhtme (Tabela 6.1):

1. Konteksti demografik, socio-ekonomik dhe mjedisor i bashkive për të kuptuar ndikimet dhe prioritetet e mundshme për bashkinë;
2. Ngjarjet e shkuara klimatike;
3. Prirjet e ndryshimeve klimatike dhe skenarët e ardhshëm, si dhe hulumtimin mbi gjasat, pasojat, shpeshtësinë dhe ndikimet e secilit lloj rreziku mbi njerëzit dhe sektorët;
4. Identifikimi i mënyrës dhe vendndodhjes së ndikimit të rreziqeve klimatike në bashki, sektorë dhe asete;
5. Identifikimi i risqeve prioritare, bazuar te ekspozimi, ndjeshmëria, ndërvarësia dhe cenueshmëria.

Analiza e dokumentacionit u krye për të identifikuar sektorët mbizotërues në bashki ku rreziqet e identifikuar do të kishin ndikim të konsiderueshëm. Ky ishte shqyrtimi fillestar paraprak i sektorëve. Lista përfundimtare e sektorëve paraqitet në Tabela 6. 2.

Tabela 6.1_ Qasja ndaj grupimit sipas sektorëve





Tabela 6. 2_ Vlerësimi Përfundimtar Sektorial për bashkitë



6.4.1 Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar

Ky seksion përmbledh faktet lidhur me **risqet dhe mundësitë kyç që ndryshimi i klimës sjell në Bashkinë Vlorë**. Ai përqendrohet te shëndeti dhe mirëqenia, si dhe te risqet për mjedisin e ndërtuar. Ai mbulon risqet dhe mundësitë për komunitetet, përfshirë ndërtesat e banimit, si dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike te shërbimet kryesore publike, konkretisht te arsimit, shëndeti dhe kujdesi social.

6.4.1.1 Risqet nga temperaturat më të larta

Ky seksion synon të ndihmojë bashkinë me identifikimin se ku është ekspozimi më i madh ndaj të nxehtit në ekspozimet e bashkisë. Informacioni mund të përdoret për të kuptuar më mirë natyrën hapësinore të risqeve, për ta ndihmuar Bashkinë Vlorë të kuptojë riskun e vet dhe për të ndihmuar në prioritizimin e përshtatjes ndaj të nxehtit.

Tabela6.3_ Përmbledhje e risqeve ndaj shëndetit dhe komuniteteve nga temperaturat e larta të verës dhe pikëzimi përkatës

| Risku | Pikëzimi i risqeve dhe veprimi | Komente |
|---|---|--|
| Risqet për cilësinë e ajrit | I lartë Monitorimi i riskut | Risk i lartë me burim kryesor ndotjeje transportin dhe ndikimin e turizmit. Ndikimi i turizmit është 3-4 herë më i madh se në periudhat e tjera të vitit. Emetimet e automjeteve/zhurmave/ajrit të kondicionuar ndikojnë në cilësinë e ajrit. Nuk ka opsione alternative për sa i përket trenave dhe kërkesës për më shumë infrastrukturë EV (automjete elektrike) për të hequr dorë nga automjetet ICE (me motorë me djegie të brendshme). Transport publik urban dhe ndërqytetës joefikas. Nevojitet monitorim i kërkesave për cilësinë e ajrit. |
| Risqet për arsimin për shkak të rritjes së temperaturës | Mesatar | Kërkohej standarde për numrin e fëmijëve në shkolla dhe infrastrukturë e përshtatshme për t'u bërë ballë temperaturave të verës. Nevojitet mbështetje financiare për rinovimin e ndërtesave të shkollave shtetërore dhe kopshteve të fëmijëve (ku nga 42 prej tyre, vetëm 2 kanë zbatuar nismat për EE). |
| Risqet për shëndetin dhe mirëqenien për shkak të rritjes së temperaturës | Mesatar | Temperaturat e larta shkaktojnë zjarre në landfille dhe zona të mbrojtura. Landfilli ekzistues i tejkalon kapacitetet. Personat e cenueshëm (sidomos të moshuarit në Vlorë) janë veçanërisht në rrezik |
| Risqet për ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe social për shkak të rritjes së temperaturës | Mesatar Monitorimi i riskut dhe ndikimit të përdoruesi | Edhe fëmijët dhe të sëmurët kronikë/personat që vuajnë nga astma ndikohen. |
| Risqet për kërkesën për energji në godina për shkak të rritjes së temperaturës | I ulët Nuk nevojiten veprime | Është vënë në zbatim programi i investimit për termoizolim me masa të eficiencës së energjisë. Plani i veprimit për EE dhe ER. Bashkia ka instaluar FV në banesa. |

Temperaturat më të larta të verës dhe shtimi i parashikuar valëve të të nxehtit paraqesin risqe të shumta ndaj shëndetit. Këto risqe shëndetësore ndikojnë drejtpërdrejt te komunitetet dhe individët, ndërkohë që drejtpërdrejt dhe tërthorazi shtojnë trysinë mbi shërbimet e kujdesit shëndetësor.

- Valët e të nxehtit mund të sjellin rritje të vdekshmërisë, veçanërisht te të moshuarit. Sëmundjet e lidhura me të nxehtin janë një risk tjetër shëndetësor për komunitetet e cenueshme, përveç atyre nga të cilat vuajnë.
- Sëmundjet e lidhura me të nxehtin përfshijnë goditjen nga i nxehti, stresin nga i nxehti, ose përkeqësimin e gjendjeve shëndetësore të mëparshme. Individët e moshuar (dhe të rinjtë) në Vlorë janë më të prekshëm nga i nxehti, për shkak të karakteristikave të veçanta fiziologjike.
- Temperaturat më të larta, mungesa e çezmave publike me ujë të pijshëm, gjithashtu mund të ndërveprojnë me cilësinë e ajrit, veçanërisht në zonat urbane, duke rezultuar sërisht në ndikime shëndetësore.

- Intensifikimi i trafikut gjatë stinës së verës (zgjatja e kohës së qëndrimit në makinë), në orët e temperaturave më të larta, rrezikon shëndetin e njerëzve të të gjitha moshave.
- Ngjarjet e fundit të valëve të të nxehtit, që shkaktojnë tharje të tokës, mund të rrisin nivelet e pluhurit dhe grimcave.
- Rritja e të nxehtit ekstrem sjell gjithashtu rrisje për funksionimin e godinave, me ndikime të tilla si mbinxehja, dhe i bën godinat të paretshme duke rritur shpenzimet e banorëve për masa të ftohjes mekanike, si ventilatorët ose ajri i kondicionuar.
- Karakteristikat specifike të godinës janë element i rëndësishëm i aftësisë së saj për të ruajtur freskinë. Në këtë kuadër, nevojiten fakte të mëtejshme për moshën e godinave dhe materialet e ndërtimit, llojet dhe vëllimet e veshjes së fasadave të godinave dhe alternativat / disponueshmërinë e ventilimit.

6.4.1.2 Mundësitë lidhur me rritjen e temperaturave

Ky seksion synon të ndihmojë bashkinë me identifikimin se ku është ekspozimi më i madh ndaj të nxehtit në ekspozimet e bashkisë. Informacioni mund të përdoret për të kuptuar më mirë natyrën hapësinore të rrisjeve, për ta ndihmuar Bashkinë Vlorë të kuptojë riskun e vet dhe për të ndihmuar në prioritizimin e përshtatjes ndaj të nxehtit.

Tabela 6.4 _ Mundësitë e identifikuar që vijnë si pasojë e rritjes së temperaturave gjatë verës dhe dimrit

| Mundësia | |
|--|--|
| Mundësi për kërkesë për energji nga familjet gjatë dimrit. | Ka gjasa që kërkesa për ngrohje në të ardhmen të ulet për shkak të ndryshimeve klimatike dhe dimrit më të ngrohtë. Kjo do të kishte si përfitime uljen e varfërisë së karburantit dhe reduktimin e emetimit të CO ₂ në dimër nga ngrohja. |
| Mundësi për shëndet dhe mirëqenie nga vera/dimrat më të ngrohta. | Përfitimet e shëndetit fizik dhe mendor nga rritja e aktivitetit fizik (veçanërisht aktiviteti në natyrë) dhe kontakti me natyrën, janë të vërtetuara gjerësisht |

6.4.1.3 Risqet nga reshjet intensive

Tabela 6.5 _ Risqet për shëndetin dhe komunitetet nga reshjet intensive

| Risku | Pikëzimi i rrisjeve dhe veprimi | Komente |
|--|---|--|
| Risqet për shëndetin dhe mirëqenien e individëve nga përmbytjet. | Mesatar Nevojiten veprime | Reshjet e dendura të shiut me sedimente nga lumenjtë sjellin ndikime nga përmbytjet në banesa, në zonat rurale të bashkisë. Gjithashtu, toka bujqësore po përmbytet. Kërkohen investime dhe mirëmbajtje në sistemet e kullimit dhe ujitjes. |
| Risqet për arsimin nga përmbytjet | Kërkohet monitorim i ulët | Reshjet intensive shkaktojnë dëme në infrastrukturë. Të monitorohet dhe mirëmbahet infrastruktura arsimore. |
| Rritja e lagështirës dhe kondensimit në shtëpi për shkak të përmbytjeve. | Mesatar Nevojiten më shumë hulumtime | Ka problematika, veçanërisht lidhur me ndikimet e përmbytjeve në ndërtesat e paligjshme. Nevojiten më shumë hulumtime për të kuptuar rëndësinë aktuale të këtij problemi. |

- Risqet për përmbytje pasqyrohen nga reshjet e dendura (duke ndikuar shpesh në aksesueshmëri dhe kanalizime dhe duke dëmtuar asetet/banesat). Përmbytjet dhe

ndërprerjet e lidhura me to, të cilat mund të kenë ndikime të rënda dhe afatgjata në shoqëri dhe shëndet.

- Gjithashtu, përmbytjet mund të kenë ndikim shkatërrimtar mbi shërbimet kryesore, si ofrimi i kujdesit shëndetësor e social, dhe arsimit.
- Gjithashtu, duhet të merret parasysh vendndodhja e aeroportit të Vlorës për sa i përket riskut për përmbytje.

6.4.2 Infrastruktura

Ky seksion përmbledh faktet lidhur me risqet dhe mundësitë kryesore që ndryshimet klimatike sjellin në infrastrukturën e Bashkisë Vlorë, duke marrë në konsideratë disa lloje kryesore të infrastrukturës, si ajo ujore, e mbetjeve, energjetike, e transportit dhe sistemeve të TIK-ut.

6.4.2.1 Risqet për infrastrukturën nga temperaturat më të larta në verë

Temperaturat e parashikuara në Vlorë për pjesën e mëvonshme të shekullit paraqesin risqe të shumta për infrastrukturën bashkiake.

Tabela 6.6 _ Risqet në shëndet dhe komunitet nga rritja e temperaturave

| Risku | Pikëzimi i risqeve dhe veprimi | Narrativa e riskut |
|--|--------------------------------|---|
| Risqet për energjinë nga temperaturat e larta. Përfshirë uljen e prodhimit | Mesatar Monitorimi i riskut | Kërkohej monitorimi dhe planifikimi i riskut, pasi ai mund të rritet me shpejtësi nga mesi deri në fund të shekullit. |
| Risqet për transportin nga temperaturat e larta. | I lartë Monitorimi i riskut | I lartë për shkak të ndikimeve në shkallë të gjerë nëse risku vërtetohet, dhe nevojitet të kuptohet më mirë sistemi dhe cënueshmëritë e tij. Situata ka gjasa të përkeqësohet nga mesi deri në fund të shekullit. |
| Risqet për argjinaturat e tokës (p.sh. digat) nga temperaturat e larta. | Mesatar Monitorimi i riskut | Risku është mesatar për shkak të ndikimeve nëse risku në fjalë vërtetohet. Të monitorohen digat. |

- Ka gjasa që valët e të nxehtit të shkaktojnë rritje të kërkesës për energji.
- Temperaturat e larta mund të ndikojnë drejtpërdrejt te sistemet e energjisë, duke ulur prodhimin e energjisë elektrike nga termocentralet dhe duke rritur mundësinë e avarive në rrjetin energjetik.
- Temperaturat e larta sjellin një gamë ndikimesh në infrastrukturën e transportit (p.sh., shkrirja e sipërfaqes së rrugës).

6.4.2.2 Risqet për infrastrukturën nga ndryshimet e reshjeve

Tabela 6. 7 _ Risqet për infrastrukturën nga ndryshimet e reshjeve dhe pikëzimi i tyre

| Risku | Pikëzimi i risqeve dhe veprimi | Narrativa e riskut |
|--|--------------------------------|---|
| Risqet për rrjetet e infrastrukturës për shkak të përmbytjeve nga lumenjtë dhe ujërat sipërfaqësore. | I lartë Nevojiten veprime | Në planet e reja të zhvillimit duhet të merret në konsideratë mbrojtja e lumenjve dhe deltave për sa i përket punimeve të ardhshme ndërtimore, si dhe reduktimi i risqeve për përmbytje. Kërkohej menaxhim i qëndrueshëm i sistemeve të ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet në të gjithë Vlorën për të |

| Risku | Pikëzimi i risqeve dhe veprimi | Narrativa e riskut |
|--|---|--|
| | | reduktuar risqet klimatike. Janë vënë në zbatim rregullat për ripyllëzim. Duhet të merret parasysh mbrojtja e brigjeve të lumenjve me zgjidhje të bazuara në natyrë. |
| Risqet për urat dhe tubacionet për shkak të përmytjeve dhe erozionit. | I lartë Nevojiten veprime | Rritja e reshjeve në basenet ujore të Vjosës dhe Vlorës (Shushicë) ka ndikuar në dëmtimin e urave, shoqëruar me ndikimin e erozionit. Ky dëmtim lidhet më shumë me erozionin e tokës ku lumenjtë kryqëzohen përgjatë bashkisë. Përgjigja ka qenë ofrimi i urave të lëvizshme. |
| Risqet për rrjetet infrastrukturës (uji, energjia, transporti, TIK-u) nga defektet në kaskadë të shkaktuara nga përmytjet. | I lartë Nevojiten veprime | I lartë për shkak të ndërprerjeve të shpeshta të energjisë elektrike si pasojë e reshjeve të dendura, që ndikojnë në rrjetin dhe energjinë elektrike në qytet. Nevojitet njohje më e mirë e sistemit dhe cenueshmërive të tij. Ndërprerjet e energjisë elektrike ndikojnë në sisteme të shumta të ndërlidhura. Njohja se ka investime të vazhdueshme për mirëmbajtjen e rrjeteve. |
| Risqet për rrjetet e transportit dhe infrastrukturës nga dëmtimi i shpateve dhe argjinaturave. | Mesatar Nevojiten veprime. Nevojitet njohje më e thelluar | Ndikimi i rrëshqitjes së zhavorrit nga argjinaturat në infrastrukturën rrugore vendore. Duke marrë parasysh terrenin kodrinor në Vlorë, parashikohen rrëshqitje dherash dhe erozion, duke e bërë tokën shumë të paqëndrueshme. |
| Risk për infrastrukturën nëntokësore dhe sipërfaqësore nga fundosja. | I lartë Nevojiten veprime. Nevojitet njohje më e thelluar | Kërkohe rinovimi i sistemit të furnizimit me ujë, pasi ai aktualisht është që prej viteve '60 dhe kërkon monitorim shtesë për të përmirësuar ruajtjen dhe për të shmangur rrjedhjet |
| Risqet për furnizimin publik me ujë nga reduktimi i sasisë dhe cilësisë së ujit të disponueshëm. | Mesatar Monitorimi i riskut | Puset janë prekur nga përmytjet dhe janë kontaminuar. Shpesh ujërat e shirave përzihen me sistemet e ujit të pijshëm. |

- Efekti i përgjithshëm i ndryshimeve klimatike është zgjerimi i sipërfaqes së prekur nga përmytjet, si për përmytjet nga lumenjtë dhe përmytjet nga ujërat sipërfaqësore. Ndikimi i reshjeve ekstreme / të shtuara në infrastrukturë shihet më qartë përmes efekteve të përmytjeve. Për shkak të ndryshimeve klimatike, ndryshimi i niveleve të reshjeve mund të shkaktojë përmytje më të shpeshta ose më me intensitet. Rritja e përhapjes dhe intensitetit të përmytjeve në zonat malore të Vlorës përbën risk.
- Risqet për urat dhe infrastrukturën e tjera të transportit mund të përkeqësohen në zonat rurale, pasi ato mund të jenë rruga e vetme e aksesit (sidomos në zonën e Novoselës dhe Orikumit). Kërkohe informacion i mëtejshëm për mënyrën se si gërryerja ndikon te urat vendore.
- Vera më e thatë mund të ndikojë në nivelet e ujërave nëntokësore dhe në furnizimin me ujë nga puset private. Reshjet e reduktuara, së bashku me rritjen e temperaturave, mund të shkaktojnë thatësi në verë. Kjo mund të jetë njëfarë risku për Vlorën. Ky ndryshim mund të vendosë nën stres furnizimin me ujë.
- Vlorë njehe nevojën për investime të reja për transportin e brendshëm detar, portet dhe lidhjet me aeroportet.

6.4.3 Biznesi (përfshirë turizmin, bujqësinë dhe pylltarinë)

Ky seksion shqyrton se si ndryshimi i kushteve klimatike do të ndikojnë te biznesi dhe industria në Vlorë. Fokusi është kryesisht te risqet dhe mundësitë vendase, që rrjedhin direkt dhe indirekt nga ndryshimet klimatike. Megjithatë, janë përfshirë edhe risqet ndërkombëtare të zinxhirëve të furnizimit. Seksioni përmbledh risqet dhe mundësitë e përgjithshme për biznesin dhe industrinë. Për më tepër, ai paraqet një përshkrim më të detajuar të risqeve specifike për bujqësinë (përfshirë pylltarinë) dhe turizmin. Këta sektorë ekonomikë shihen si kyç për ekonominë e Bashkisë Vlorë dhe ndikohen drejtpërdrejt nga ndryshimet klimatike.

Gjetjet e Raportit të Analizës së të Dhënave Bashkiake⁷⁶ paraqesin mungesë të dhënash në sektorë të ndryshëm, veçanërisht në sektorin tregtar dhe atë të banimit.

6.4.3.1 Rreziqet për biznesin nga temperaturat dhe reshjet e shtuara dhe pakësuara

Tabela 6.8 _ Risqet e identifikuar për biznesin nga temperaturat më të larta dhe pikëzimi i tyre

| Risku | Pikëzimi i risqeve dhe veprimi | Narrativa e riskut |
|--|--|---|
| Rritja e kostove në verë për shkak të energjisë për ftohje. | I ulët Monitorimi i riskut | Në fund të shekullit mund të jetë problem. |
| Risqet për bizneset nga përmbytjet. | I ulët Monitorimi i riskut | Kërkohe monitorim i vazhdueshëm për të marrë në konsideratë ndikimin e rreziqeve në biznese. |
| Risqet për bizneset nga mungesa e ujit (furnizimi me ujë të trajtuar). | I ulët Monitorimi i riskut | Mungesa e ujit përbën rrezik të mundshëm për bizneset. Nevojiten kërkime të vazhdueshme. |
| Risqet për bizneset nga ndërprerja e zinxhirëve të furnizimit dhe rrjeteve të shpërndarjes. | Mesatar Monitorimi i riskut Nevojitet njohje më e mirë | Ndryshimet klimatike përkeqësojnë shpeshhtësinë dhe ashpërsinë e ngjarjeve ekstreme të motit, përfshirë stuhitë, përmbytjet, thatësitrat, ngricat dhe zjarret në pyje. Risqet e zinxhirit të furnizimit janë më të pasigurtat dhe më të vështirat për t'u përcaktuar në terma sasiorë. Por, ato mund të kenë ndikim të rëndësishëm te biznesi, i cili mbështetet te materialet e importuara. |
| Risku nga rritja e kostove për shkak të rritjes së çmimeve të lëndës së parë dhe infrastrukturës | Mesatar Nevojitet njohje më e mirë | Teksa ndryshimet klimatike përkeqësohen, ndikimet e tyre ekonomike rriten, duke prekur burimet ujore, bujqësinë, turizmin dhe pasuritë e paluajtshme. Ekspertët paralajmërojnë se edhe rritjet e vogla të temperaturave globale shkaktojnë dëme të konsiderueshme ekonomike. Për shembull, një rritje prej 1°C mund të dyfishojë dëmin ekonomik krahasuar me një rritje prej 0.5°C. |
| Risku nga rritja e çmimeve të sigurimeve | I lartë Nevojitet njohje më e mirë | Ndryshimet klimatike mund të shkaktojnë stuhi, të nxehtë ekstrem, përmbytje dhe katastrofa të tjera. |
| Risku nga zvogëlimi i kapacitetit prodhues | Mesatar Nevojitet njohje më e mirë | Gjatë temperaturave jashtëzakonisht të larta, çmimet e energjisë elektrike përsëri rriten, ndërsa gjatë të ftohtit ekstrem, çmimet e furnizimit me ujë mund të ulen, duke ndikuar kështu te kostot e prodhimit të ndërmarrjeve. |

- Temperaturat shumë të larta kanë të ngjarë të ndikojnë te shëndeti, mirëqenia dhe

⁷⁶ Projekti UNDP-PKP, Raporti mbi "Analizën e integruar të të dhënave, gjetjet dhe rekomandimet: Dinamika demografike, profilet ekonomike dhe treguesit e klimës në bashkitë shqiptare". (nëntor 2023)

produktiviteti i punonjësve gjatë ngjarjeve ekstreme të të nxehtit. Disa punë në natyrë (sidomos ndërtimi) mund të duhet të ndërpriten nëse ka temperatura ekstreme për të garantuar sigurinë e punonjësve, pasi rrezikohen prej goditjes nga dielli.

- Reduktimi i parashikuar i reshjeve në verë mund të sjellë risqe edhe për bizneset. Mungesa e ujit mund të prishë vazhdimësinë e biznesit, veçanërisht në sektorë ku prania e tij është shumë e domosdoshme, si sektori i ushqimeve dhe pijeve.
- Rreziqet klimatike, të tilla si reshjet e dendura të shiut dhe përmytjet nga ujërat sipërfaqësore, ngrohja dhe temperaturat e larta janë llojet e motit që mund të shkaktojnë numrin më të madh të ndërprerjeve të zinxhirit të furnizimit të lidhura me motin. Këto sjellin ndikime negative te bizneset, të cilat nuk janë në gjendje të vazhdojnë prodhimin e produkteve apo ofrimin e shërbimeve. Për më tepër, këto ngjarje ndikojnë edhe te çmimet e sigurimeve, të cilat do të sjellin rritje të kostove për sektorin e biznesit.
- Përmytjet janë risku më i madh për sistemin financiar me ndikime financiare në sigurime, hipoteka dhe investime. Ndonëse nuk konsiderohen plotësisht si përmytje, pranohet se dëmet nga stuhitë cenojnë infrastrukturën e biznesit dhe për këtë arsye ndikojnë negativisht te bizneset.
- Çmimet e energjisë elektrike (furnizimit me ujë) do të rriteshin (uleshin) në temperatura jashtëzakonisht të larta, gjë që do të rriste kostot e prodhimit të ndërmarrjeve. Për të mbajtur temperaturat në vendin e punës në një nivel të përshtatshëm gjatë temperaturave shumë të larta ose shumë të ulëta dhe për të zvogëluar ndikimin të prodhimi dhe operimi, ndërmarrjet duhet të rrisin shpenzimet e tyre për ajër të kondicionuar, krahas sigurimit të pajisjeve për ftohje ose ngrohje për departamentet e tyre të prodhimit dhe menaxhimit. Çmimet e energjisë elektrike mund të rriten gjatë temperaturave ekstreme, gjë që do të rrisë më tej kostot e prodhimit dhe menaxhimit. Kostot më të larta të menaxhimit të temperaturës reduktojnë fluksin e parave të ndërmarrjeve dhe ndikojnë negativisht te prodhimi i brendshëm dhe aktivitetet operative. Me pak fjalë, ndryshimet klimatike ulin produktivitetin e punonjësve dhe rritin konsumin e energjisë, kostot e prodhimit dhe shpenzimet administrative, të cilat zvogëlojnë prodhimin dhe kapacitetin operacional të ndërmarrjeve dhe në fund ndikojnë negativisht te aftësia për shitje.

6.4.3.2 Mundësitë për bizneset

Tabela 6.9_ Mundësitë për bizneset

| Mundësia | |
|--|--|
| Mundësi për bizneset nga ndryshimet e kërkesës për mallra dhe shërbime | Moti më i ngrohtë në Vlorë, që parashikohet të jetë rrjedhojë e ndryshimeve klimatike, mund të sjellë disa përfitime për biznesin, si kosto më të ulëta për ngrohje në dimër për bizneset që e ushtrojnë aktivitetin në ambiente të brendshme, dhe verë më të thatë dhe më të ngrohtë për ata punojnë në ambiente të jashtme. Për shkak të zonave të mbrojtura përreth, si lumi i Vjosës, Llogaraja, dhe zonat e mbrojtura të Karaburunit, ekoturizmi është një tjetër mundësi për t'u marrë në konsideratë. |
| Zgjerimi i prodhimit të energjisë diellore | Duke qenë se rrezatimi diellor pritet të rritet, ekziston mundësia për të shtuar reduktimet e energjisë. |

6.4.3.3 Risqet dhe mundësitë për turizmin

- Përmytjet dhe rritja e nivelit të detit janë kërcënimi më i madh për bizneset në Vlorë. Rritja e nivelit të detit ka pushtuar tokën në mbi 75 metra e si pasojë ka ndikuar edhe në habitatet

detare.

- Risqet klimatike, që lidhen me turizmin në Bashkinë Vlorë, kanë ardhur si rezultat i rritjes së numrit të turistëve, duke shkaktuar presion mbi menaxhimin e mbetjeve, rritje të pikut për energji elektrike, bllokim të zgjatur të trafikut, erozion bregdetar, stuhi dhe zjarre në pyje.
- Menaxhimi i mbetjeve është theksuar si fushë e veçantë sfiduese, veçanërisht gjatë kulmit të sezonit. Riciklimi i mbetjeve është në nivele shumë të ulëta.
- Megjithatë, mundësitë ekzistojnë; sektorët e bujqësisë, shërbimeve dhe turizmit shfaqin rritje dhe potencial të qëndrueshëm për zgjerim të mëtejshëm, duke treguar mundësi të qëndrueshme investimi.
- Treguesit e turizmit vitet e fundit kanë qenë shumë të mirë për Vlorën, me një zgjerim të sezonit turistik nga maji deri në tetor. Kjo zgjatje e sezonit ofron mundësi si për bujqësi ashtu edhe për turizëm në saje të ndryshimit të temperaturave të verës dhe dimrit, si dhe për bizneset që synojnë ekonominë e gjelbër.

Turizmi është gjithashtu i rëndësishëm për Vlorën.

- Ndryshimi i klimës mund të paraqesë mundësi për aktivitete në natyrë në Bashkinë Vlorë, duke nxitur më shumë turistë që të vizitojnë zonën gjatë të gjitha stinëve.
- Dëmtuesit e rinj të sjellë nga ndryshimet klimatike mund të ndikojnë në zonat e mbrojtura dhe të trashëgimisë kulturore, duke infektuar bimët dhe pemët me sëmundje.
- Zbatimi i Indeksit të Klimës së Turizmit (TCI)⁷⁷, konstaton një rritje të përshtatshmërisë turistike të qarkut dhe Bashkisë Vlorë, si dhe zonave bregdetare e malore për sezonin veror.
- TCI-ja sugjeron reduktim të flukseve turistike në të ardhmen gjatë pikut të sezonit (mesit të korrikut-fundit të gushtit) për shkak të kushteve të papërshtatshme klimatike, të cilat lidhen me rritjen e temperaturave maksimale të verës dhe shfaqjen gjithnjë e më të shpeshtë të valëve të të nxehtit. Megjithatë, këto flukse mund të orientohen drejt periudhave të mëparshme ose vijuese (maj-qershor dhe shtator-tetor) dhe në sajë të planifikimit efektiv të sektorit të turizmit në rajon, mund të realizohet zhvendosja e flukseve të turistëve në periudha me temperatura të larta drejt zonave malore.

6.4.3.4 Industrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit

Risqet dhe mundësitë shtesë përfshijnë:

- Rritjen e temperaturave të larta dhe temperaturave të akumuluar, si dhe përhapjen e thatësirave, të cilat kanë gjasa të ndikojnë te cilësia e tokës së punueshme dhe prodhimtaria. Me rritjen e temperaturave, ka mundësi që të kultivohen kultura bujqësore dhe specie të reja, duke rritur kështu prodhimtarinë bujqësore dhe pyjore. Risqe të tjera përfshijnë organizmat dhe sëmundjet që ndikojnë dhe infektojnë këta sektorë.
- Rritja e nivelit të detit pritet të shkaktojë më shumë erozion bregdetar, veçanërisht përgjatë “Pyllit të Sodës” ku zona pyjore është nën stres.
- Depërtimi i ujërave të kripura në tokat bujqësore ka sjellë humbje të prodhimit dhe ulje të rendimentit.
- Nëse nuk menaxhohen siç duhet, bujqësia dhe pylltaria mund të ndikojnë te përmbytjet, në

⁷⁷ TCI – një indeks i krijuar për të vlerësuar përshtatshmërinë turistike të vendndodhjeve të ndryshme lidhur me nivelin e përshtatshmërisë ndaj klimës

zonat ku është larguar bimësia, rrjedha e ujit nuk ngadalësohet më në mënyrë aq efektive. Risku nga përmbytjet lumore ka mundësi të rritet. Madje, një pjesë e konsiderueshme e tokës bujqësore është ndikuar tashmë ose është në risk në të ardhmen.

- Rritja e reshjeve rrit mundësinë e përhapjes me lehtësi të ndotësve sikurse azoti, që vijnë nga plehëruesit.
- Rritja e reshjeve sjell degradimin e mëtejshëm të tokës të gjitha territoret ku ka pasur zjarre dhe prerje pyjesh. E shoqëruar me praktika të gabuara bujqësore, kjo do të çojë në degradimin e tokave bujqësore.

6.4.4 Risqet për natyrën

Ndryshimet klimatike do të ndikojnë në disa mënyra të mjedisit natyror në të gjithë Bashkinë Vlorë. Ky seksion paraqet gjetjet lidhur me risqet dhe mundësitë kryesore që sjellin ndryshimet klimatike si për mjedisin natyror tokësor ashtu edhe për mjedisin e ujërave të ëmbla. Megjithatë bujqësia dhe pylltaria janë të ndërlidhura me natyrën, ato trajtohen në seksionin e mëparshëm.

Habitatet dhe speciet do të vuajnë ose do të përfitojnë në varësi jo vetëm të ndryshimeve klimatike, por edhe të një sërë faktorësh të tjerë, përfshirë shpërndarjen bioklimatike, konkurrencën ndërmjet specieve, presionet në përdorimin e tokës dhe lidhjen ekologjike.

Ky seksion synon të përshkruajë prirjet e përgjithshme dhe ndikimet që ndryshimet klimatike do të sjellin në mjedisin natyror, duke i evidentuar këto ndryshime me disa shembuj specifikë, në vend të një studimi të thelluar të të gjithë peizazhit natyror të larmishëm të Vlorës.

6.4.4.1 Risqet dhe mundësitë për speciet tokësore në Bashkinë Vlorë

Tabela 6.10_ Risqet e identifikuar për speciet tokësore në Bashkinë Vlorë dhe pikëzimi i tyre

| Risku | Pikëzimi i risqeve dhe veprimi | Narrativa e riskut |
|--|--|--|
| Risqet nga ndryshimi i kushteve klimatike dhe ngjarjet atmosferike ekstreme: Ndryshimet në temperaturë | I lartë Nevojiten veprime dhe njohje më e mirë e risqeve specifike dhe e mënyrës se si ato mund të ndikojnë te speciet më të cenueshme. Nevojitet njohje më e thelluar | Ndikimi, veçanërisht ndikimi klimatik, është i lartë në specie, duke sjellë humbjen e bredhit në Parkun Kombëtar të Llogarasë, dhe ndryshimi morfologjik në pyll mund të ndikojë në llojin e pyllit dhe rrjedhimisht në gjendjen për speciet e tjera, habitatit i të cilave është parku, veçanërisht ato stenoendemike, që janë të pranishme në zonë. Ndërkohë që kohët e fundit fermerët po përdorin serrat dhe plastikën si mbulim ndaj kushteve klimatike në ndryshim, speciet invazive vazhdojnë të ndikojnë në pemët e ullirit në të gjithë Vlorën. Terreni kodrinor ku rriten ulliri dhe rrushi janë në rrezik nga ndryshimi i kushteve klimatike. Një tjetër ndikim klimatik vihet re në ndryshimin e periudhës kohore për sistemet e mbjelljes dhe të kultivimit. Nevojiten më shumë hetime, përfshirë rishikimin e kurrikulës dhe forcimin e njohurive për ngritjen e kapaciteteve në universitete. Rritja e temperaturave ndikon negativisht edhe në sipërfaqet e kullotave në Llogara dhe Karaburun përmes zjarreve dhe në cilësinë e tyre, duke marrë parasysh periudhat e gjata të thatësisë. Ndryshimet në kushtet klimatike kanë ndryshuar regjimin e mbarështimit të kafshëve, nga regjimi tradicional i kullotjes, tashmë mbizotëron regjimi i qëndrueshëm, pra, blegtoia intensive; po ashtu vihet re ndryshimi gradual i racave të demave në ato autoktone, duke futur raca më të |

| Risku | Pikëzimi i risqeve dhe veprimi | Narrativa e riskut |
|--|---|--|
| | | qëndrueshme ndaj kushteve të reja klimatike. Rritja e temperaturave ndikon negativisht edhe në temperaturat dhe qarkullimin e ujit në lagunën e Nartës dhe të Orikumit, duke ndikuar te habitatit dhe speciet. |
| Risqet nga ndryshimi i kushteve klimatike dhe ngjarjet atmosferike ekstreme: Nga ngjarjet e stuhive | I lartë Nevojiten veprime. Nevojitet njohje më e thelluar | Rritja e shpeshtësisë dhe intensitetit të ngjarjeve të stuhisë do të ndikonte mbi speciet tokësore, veçanërisht speciet e pemëve dhe bagëtinë gjithashtu. Sidomos në “Pyllin e Sodës” dhe të “Pishë-Poro-Nartës”. |
| Risqet për speciet dhe habitatet tokësore dhe detare nga organizmat e dëmshëm dhe patogjenët, përfshirë speciet e huaja invazive | I lartë Nevojiten veprime Nevojitet njohje më e thelluar. | Specia invazive, gaforrja blu, po shkakton humbje të specieve të tjera në lagunat e Bashkisë Vlorë. Për shkak të ndikimit të klimës, speciet invazive, që vijnë nga Deti i Kuq, janë tashmë të pranishme në ujërat vendore të Vlorës Organizmat e dëmshëm (4-5 gjenerata) vazhdojnë të ndikojnë në sektorin e bujqësisë. Nevojitet më shumë monitorim pasi edhe biologjia dhe sjellja e organizmave të dëmshëm (si karkalecat marokenë) kanë ndryshuar Duhet të kuptojmë më mirë se çfarë është e cënueshme dhe cilët dëmtues/patogjenë kanë gjasa të jenë kërcënuesit më të mëdhenj. |
| Rreziqet nga përmbytjet për shkak të rritjes së nivelit të detit | I lartë Nevojiten veprime Nevojitet njohje më e thelluar | Rritja e nivelit të detit pritet të intensifikojë erozionin bregdetar dhe përmbytjen e zonës bregdetare në lartësi të ulët. |

- Vlorë ka një rrjet të madh lumenjsh, përrenjsh dhe ujërash të ëmbla. Për shkak të reshjeve intensive, ka gjasa që lumenjtë të bëhen më vërshues, më gërryes dhe të kenë prurje bazë më të ulëta në verë. Ngjarjet e reshjeve intensive të shiut do të sjellin më shumë sedimente, duke shtuar lëndët ushqyese dhe lymin në sistemet lumore, dhe do të rrisin mundësinë e shkarkimit të ujërave të tepërta të shiut.
- Në të ardhmen, stuhitë e erës dhe ngricës mund të kenë ndikim te pemët, në varësi të ndryshimit të intensitetit dhe shpeshtësisë së stuhive, të cilat janë një faktor kryesor risku.
- Rënia e pemëve mund të ketë një ndikim më të gjerë, duke shkaktuar bllokime ose dëmtime në infrastruktura të tjera. Rritja e stuhive të verës është veçanërisht e rrezikshme, për shkak se pemët janë plot gjethe dhe rrjedhimisht edhe të rënda. Largimi i specieve të cënueshme/të papërshtatshme ka një ndikim në kosto për ata që kryejnë menaxhimin.
- Speciet e shumta të jovertebrorëve, që janë të lidhura ngushtë me bimë specifike, kanë gjasa të pësojnë një zhvendosje ose humbje shoqëruese të shpërndarjes gjeografike.
- Risku për erozion dhe degradim të tokës është i pranishëm në të gjithë territorin e Bashkisë Vlorë

Tabela 6.11_ Mundësitë për speciet tokësore

| Mundësia | |
|---|--|
| Mundësi për kolonizimin e habitateve tokësore nga speciet e reja. | Mundësi për rritje pozitive të bimëve mjekësore që janë rritur pa kujdesin e njeriut |

6.4.4.2 Risqet dhe mundësitë për tokat dhe për speciet e ujërave të ëmbla

Tabela 6.12_ Risqet e identifikuara për tokat, rezervat e karbonit dhe speciet e ujërave të ëmbla

| Risku | Pikëzimi i risqeve dhe veprimi | Narrativa e riskut |
|--|--------------------------------|---|
| Risqet për tokat nga ndryshimi i kushteve klimatike, përfshirë thatësinë dhe lagështirën sezonale. | Mesatar Nevojiten veprime | Ky risk është mesatar. Dheu dhe tokat janë bërë të kripura për shkak të afërsisë me detin. Depërtimi i ujërave të kripura në tokat bujqësore ka sjellë humbje të prodhimit dhe ulje të rendimentit. Prodhimi i perimeve kërkon më shumë hulumtime mbi zgjidhjet për të përmirësuar tokat dhe për të hequr dorë nga përdorimi në rritje i pesticideve. Reshjet e dendura të shiut po shkaktojnë degradim dhe erozion të tokës. Kërkohen më shumë hulumtime për të përmirësuar elementet kimike dhe fizike të tokës |
| Risqet dhe mundësitë për rezervat e karbonit natyror, sekuestrimin e karbonit dhe emetimet GES nga ndryshimi i kushteve klimatike, përfshirë ndryshimin e temperaturës dhe mungesën e ujit. | Mesatar Nevojiten veprime | Kërkesa për të përmirësuar elementet kimike dhe fizike të tokës në të gjithë Vlorën. |
| Për shkak të ndryshimeve të kushteve klimatike dhe ngjarjeve ekstreme, speciet dhe habitatet e ujërave të ëmbla rrezikohen edhe nga temperaturat e larta të ujit, përmbytjet dhe erozioni i brigjeve, mungesa e ujit dhe ndryshimet fenologjike. | Mesatar Nevojiten veprime | Rritja e temperaturës së ujit ndryshon sezonin, duke ndërprerë mbarëshkrimin e specieve të peshqve gjatë sezonit maj-tetor. |
| Risqet për speciet dhe habitatet e ujërave të ëmbla nga organizmat e dëmshëm, patogjenët dhe speciet e huaja. | I ulët | Speciet tokësore, dëmtuesit, patogjenët dhe speciet invazive paraqesin gjithashtu rreziqe për speciet e ujërave të ëmbla. |

- Ndryshimet klimatike dhe ndryshimet në reshje sjellin reshje shiu më intensive, që do të thotë se ka gjasa që lumenjtë të bëhen më vërshues, më gërryes dhe të kenë prurje bazë më të ulëta në verë. Prurjet më të larta dhe më intensive mund të shkaktojnë rritje të erozionit të brigjeve, duke ndikuar në speciet që jetojnë përreth brigjeve të lumenjve. Prurjet më të larta të pikut të lumenjve mund të sjellin vërshime më të drejtpërdrejta në ujëmbledhës të ndjeshëm, gjë që do të ndikojë negativisht te speciet e ujërave të ëmbla.
- Verat më të thata të parashikuara për Vlorën mund të rezultojnë në pakësim të prurjeve të lumenjve gjatë muajve të verës. Për më tepër, prurjet e ulëta të lumit mund të rrisin temperaturën e ujit, të ulin cilësinë e habitatit për peshqit e ujërave të ëmbla dhe të rrisin përqendrimin e lëndëve ushqyese dhe të ndotësve të tjerë.
- Në verë pritet rritje e deficiteve të lagështirës së tokës, gjë që mund të shkaktojë humbje të biodiversitetit dhe lëndës organike. Reshjet intensive të shiut mund të prekin edhe cilësinë e ujit, biodiversitetin e ujërave të ëmbla dhe emetimet GES.
- Me ngrohjen e klimës, ekziston mundësia që ajo të ndikojë në aftësinë e tokës për të ruajtur karbonin dhe lëndët ushqyese, për shkak të dobësisë së efektit izolues të dëborës. Kjo mund të çojë në shtim të humbjeve të substancave të shpërbëra.
- Speciet tokësore, dëmtuesit, patogjenët dhe speciet invazive paraqesin gjithashtu rreziqe për speciet e ujërave të ëmbla.
- Verat më të thata dhe më të ngrohta mund të nxisin mbijetesën e sëmundjeve të reja dhe specieve të huaja invazive, të cilat mund të kërcënojnë habitatet dhe speciet.

Tabela 6.13_ Mundësitë për habitatet e ujërave të ëmbla

| Mundësia | |
|---|--|
| Mundësitë për kolonizimin e habitateve të ujërave të ëmbla nga speciet e reja | Mund të ketë mundësi nga ardhja e specieve të tjera të reja përmes përmirësimit të biodiversitetit, megjithëse provat për këtë aktualisht janë të pakta. |

6.4.4.3 Risqet dhe mundësitë nga ndryshimet klimatike në karakterin e peizazhit

Tabela 6.14_ Risqet nga ndryshimet klimatike në karakterin e peizazhit dhe pikëzimi i tyre

| Risku | Pikëzimi i risqeve dhe veprimi | Narrativa e riskut |
|--|--|---|
| Risqet nga ndryshimet klimatike në karakterin e peizazhit. | Mesatar Monitorimi i riskut Nevojitet njohje më e thelluar | Në të gjithë Vlorën, peizazhi aktual është i rëndësishëm për industri të tilla si turizmi dhe ky risk vlerësohet mesatar dhe kërkon monitorim e njohje më të mirë. Karakterin e peizazhit do të modifikohet gjithashtu nga efektet indirekte të klimës në ndryshim, si zjarret në pyje, prerja e pyjeve dhe ndryshimi i përdorimit të tokës, si për shembull sistemet e reja të mbjelljes. |

Tabela 6.15_ Mundësitë për peizazhin

| Mundësia | |
|-------------------------|--|
| Mundësitë për peizazhin | Biodiversiteti i përmirësuar mbështet një sërë shërbimesh të ekosistemit, veçanërisht ato kulturore, si zbavitjet (peshkimi dhe kafshët e egra). |

6.4.5 Asetet dhe veprimtaritë e bashkisë

Seksionet e mëparshme të vlerësimit të riskut kanë dhënë një panoramë të përgjithshme mbi risqet klimatike me të cilat përballen banorët, bizneset, infrastruktura, mjedisi natyror dhe kultura në Bashkisë Vlorë. Ky seksion ofron një panoramë të përgjithshme të risqeve klimatike me të cilat përballen organizimi i Bashkisë Vlorë, asetet e saj dhe veprimtaritë e lidhura me to.

6.4.5.1 Risqet për asetet në pronësi të bashkisë ose që mirëmbahen nga Bashkia Vlorë

Tabela 6.16_ Risqet e identifikuara për tokat, rezervat e karbonit dhe speciet e ujërave të ëmbla

| Risku | Pikëzimi i risqeve dhe veprimi | Narrativa e riskut |
|--|--------------------------------|---|
| Risqet për pasuritë në pronësi të bashkisë dhe hapësirat komunitare që mirëmbahen nga këshilli | Mesatar | Disa banesa mund të jenë më të rrezikuara se të tjerat nga ndikimet e përmbytjeve—veçanërisht apartamentet përdhese dhe ato në kat të parë. |
| Risqet nga përmbytjet për pasuritë e Vlorës. | Mesatar | Dëmtimi i zyrave ose pajisjeve mund të shkaktojë probleme në funksionimin normal |
| Risqet nga përmbytjet për infrastrukturën rrugore. | I lartë | Disa rrugë që mirëmbahen nga bashkia shtrihen në zona përmbytjesh dhe nëse ky risk ndodh do të sjellë kosto shoqërore të larta |

- Temperaturat e larta mund të rrisin mundësinë e mbinxehjes së ndërtesave. Nëse kjo ndodh në ndërtesa brenda juridiksionit të bashkisë, do të ketë ndikime të shumta negative,

veçanërisht për përdoruesit e cenueshëm. Shtimi i dëmtimeve në infrastrukturën rrugore nënkupton rritje të kostove të riparimit dhe mirëmbajtjes.

- Rritja e reshjeve të shiut dhe përmbytjeve mund të ketë një sërë ndikimesh negative te pronat dhe banesat në pronësi dhe në përdorim nga këshilli bashkiak. Risk i shtuar për shtëpitë ose ndërtesat e tjera, për shkak të reshjeve më intensive të shiut dhe dëmtimeve nga përmbytjet. Kostot e regjimit të riparimit dhe mirëmbajtjes do të rriten për shkak të trajtimit të problemeve të materialeve të ndërtimit, si rrjedhjet në çati, amortizatori i materialeve të ndërtimit dhe përmbytjet brenda zonës së ndërtimit.
- Thatësitrat kanë kufizuar përdorimin e kullotave verore në përdorim të bashkisë (ose Agjencisë së Zonave të Mbrojtura), për shkak të mungesës së ujit në rezervuarët e ujit për gjedhët (të ndërtuara para viteve '90 dhe të pamirëmbajtura). Këta rezervuarë kanë pasur dhe kanë funksion të rëndësishëm edhe në rastet e zjarreve në kullota, por për shkak të dëmtimeve, që kanë pësuar, dhe mungesës së reshjeve të shiut nuk mund të mbushen sa duhet.

6.5 Përfundimet

Në këtë kapitull janë identifikuar shumë risqe dhe vetëm disa mundësi për Bashkinë Vlorë që lidhen me ndryshimet klimatike. Sektorët e vlerësuar që do të preken përfshijnë:

1. Njerëzit, shëndetin, komunitetet dhe mjedisin e ndërtuar.
2. Infrastrukturën.
3. Biznesin dhe industrinë.
4. Mjedisin natyror.
5. Asetet dhe veprimtaritë e bashkisë.

Për sa i përket risqeve të Bashkisë Vlorë për shkak të ndryshimeve klimatike, janë evidentuar disa cenueshmëri dhe shumë pak mundësi.

- Risqet kryesore të shtëpive ose ndërtesave të tjera, të cilat menaxhohen nga Bashkia Vlorë, përfshijnë rritjen e temperaturave, duke sjellë kështu verë më të nxehtë dhe më të thatë. Ndikimet klimatike shkaktojnë stuhi më të shpeshta dhe më intensive.
- Vera më e nxehtë dhe më e thatë do të kërkojë instalimin e më shumë teknologjive të ajrit të kondicionuar te shtëpitë ose ndërtesat e tjera. Nga ana tjetër, ka përfitime të mundshme për zvogëlimin e emetimeve nga përdorimi i energjisë dhe ngrohja, pasi vera më e thatë do të thotë më pak re dhe rrjedhimisht më shumë rrezatim diellor, mbështetje më e mirë për kalimin në instalimet diellore fotovoltaike në shkallë të vogël dhe në shkallë të madhe në të gjithë Vlorën.
- Ndryshimi i klimës drejt ekstremeve më dramatike të motit pritet të përbëjë risk për biodiversitetin tokësor dhe të ujërave të ëmbla, për tokat dhe karakterin e peizazhit.
- Ekziston risku që me ngrohjen e klimës, toka të mos jetë në gjendje të ruajë të mënyrë efektive karbonin dhe lëndët ushqyese. Kjo mund të sjellë rritje të emetimeve të GES-ve dhe ndikim negativ te cilësia ujit dhe te biodiversiteti i ujërave të ëmbla.
- Speciet e ujërave të ëmbla janë në risk për shkak të ndryshimeve në regjimin hidrologjik dhe të rritjes së ndotjes nga vërshimet gjatë muajve të dimrit për shkak të rritjes së shpeshtësisë dhe intensitetit të reshjeve të dendura.

- Rritja e temperaturave dhe reshjeve të dendura të shiut/përmytjeve ka gjasa të sjellë ndikime negative në veprimtaritë, shërbimet dhe asetet e Bashkisë Vlorë, në rast se Bashkia Vlorë nuk ndërmerr asnjë masë pas këtij vlerësimi të riskut klimatik.

Përfundimet e nxjerra nga vlerësimi i rrezikut janë si më poshtë:

- Përmytjet dhe ndikimet e tyre janë kërcënimi më i ngutshëm i ndryshimeve klimatike për Vlorën dhe prekin të gjithë sektorët. Tani po ndodhin përmytje, të cilat do të vazhdojnë të jenë kërcënim gjatë këtij shekulli, për shkak se intensiteti i reshjeve të shiut po rritet.
- I nxehti ka të ngjarë të shkaktojë ndikime në Bashkinë Vlorë pasi temperaturat e verës rriten dhe valët e të nxehtit bëhen më të shpeshta dhe më ekstreme. Pakësimi i reshjeve të dëborës ka të ngjarë të ketë ndikim të madh në botën e egër malore, si dhe në hidrologjinë e Vlorës. Rritja e temperaturave do të ndikojë në shëndetin e banorëve të Vlorës.
- Shumë prej risqeve me të cilat përballet natyra kategorizohen si risqe me ndikim të lartë, duke pasur parasysh rëndësinë që ka natyra si në turizëm, ashtu edhe në disa industri kyç në Vlorë.
- Ndikim negativ do të kenë edhe asetet dhe veprimtaritë e Bashkisë Vlorë, përfshirë aftësinë për të reduktuar emetimet e karbonit nëpërmjet risqeve kalimtare. Miratimi i masave të përshtatjes që në fillim do ta zvogëlonte këtë ndikim.
- U identifikuan disa mundësi, vera më e thatë dhe dimri më i ngrohtë, sjellin disa ndikime pozitive. Në veçanti lidhur me përdorimin e energjisë, shëndetin e njeriut dhe turizmin e sidomos aktivitetet në natyrë. Megjithatë, nëse i baraspeshojmë, risqet e ndryshimeve klimatike janë shumë më të mëdha sesa mundësitë.

Ky vlerësim i mundësive është hapi i parë për hartimin e një plani të integruar për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike për Bashkinë Vlorë, gjë që do të forcojë më tej qëndrueshmërinë. Hapi tjetër do të jetë përdorimi i vlerësimit të riskut për hartimin e një plani veprimi për përshtatje për t'u zbatuar nga Bashkia Vlorë dhe qytetarët e saj, krahas masave që janë tashmë në proces zbatimi. Propozohet që vlerësimi i riskut të monitorohet çdo vit, pasi me kalimin e kohës risqet nga rritja e temperaturës mund të shtohen.

- Gjatë viteve të ardhshme, duhet të shihen me prioritet kërkimi ose mbledhja e provave për risqet e kategorizuara si "*nevojitet njohje më e mirë*". Këto risqe duhet të rivlerësohen kur të ketë më shumë prova në dispozicion.
- Për risqet më të larta dhe për ato të kategorizuara si "*nevojiten veprime*", palët kyç të interesit duhet të identifikohen dhe edukohen mbi risqet, si dhe të bashkëpunojnë me organizata të ndryshme për hartimin e planeve të suksesshme për përshtatje.
- Megjithëse mundësitë janë identifikuar, nevojitet më shumë punë për të kuptuar se si këto mundësi mund të optimizohen më mirë.
- Duhet të hartohet dhe zbatohet një plan pune, i cili duhet të përcaktojë masat që duhen rishikuar rregullisht, për t'u siguruar se çdo e dhënë e re është përditësuar dhe marrë parasysh. Më pas, ky rend specifik pune për riskun klimatik duhet të integrohet në strukturat ekzistuese të qeverisjes klimatike në Bashkinë Vlorë.
- Të vijojë angazhimi me palët e interesit.

7 Plani Vendor i Veprimit

Ka të dhëna se klima e Vlorës po ndryshon në përputhje me prirjet globale të ndryshimeve klimatike. Gjatë dekadave të fundit, klima e tokës është ngrohur, niveli i detit është rritur, regjimi i reshjeve të shiut ka ndryshuar dhe Bashkia Vorë është prekur nga ngjarjet atmosferike të shpeshta, intensive dhe ekstreme.

Ndryshimet klimatike kanë pasur ndikime të ndryshme dhe të gjera në burimet ekonomike dhe natyrore të Vlorës, përfshirë:

- Ndryshime të temperaturave mesatare në të gjitha stinët, me valë të nxehti, që priten të ndodhin më shpesh.
- Vlora mund të preket nga lloje të ndryshme thatësirash, për shkak të ditëve të nxehta dhe valëve të të nxehtit. Këto, së bashku me mungesën e ujit në verë, do të rrisin riskun e organizmave të dëmshëm dhe sëmundjeve të reja.
- Në të ardhmen, valët e të nxehtit do të rriten në shpeshtësi (dhe në kohëzgjatje sipas SSP5-8.5). Mund të ketë mungesë prurjesh të ujërave sipërfaqësore ose nënsipërfaqësore nga deficitin në basenin e lumit. Pritet që derdhjet e lumenjve në pranverë të rriten ndjeshëm për shkak të reshjeve të shiut dhe disa prurjeve malore.
- Ndryshimi i regjimit të reshjeve do të ndikojë te bujqësia, shëndeti i njerëzve, blegtoaria, furnizimi me ujë. Ndërsa, përmybtjet, rrëshqitjet e dheut dhe erozioni i tokës do të shkaktojnë mbytjen e të mbjellave, uljen e rendimentit dhe rritjen e pasigurisë ushqimore.

7.1 Qëllimi i Planit Vendor të Veprimit

Si niveli i qeverisjes më i afërt me komunitetet dhe sipërmarrjet vendore, dhe si një nga reaguesit e parë në shumë emergjenca, Bashkia Vlorë është vendi i duhur për të sjellë ndryshime reale e pozitive lidhur me ofrimin e një të ardhmeje me karbon të ulët dhe qëndrueshmëri ndaj ndryshimeve klimatike. Ky Plan Vendor Veprimi, krahas vlerësimit të riskut klimatik të Vlorës, synon:

- (i) të sigurojë të kuptuarit e duhur të risqeve dhe cenueshmërive kryesore, që vijnë nga ndryshimet klimatike;
- (ii) të çojë përpara zbatimin e veprimeve për qëndrueshmëri ndaj ndryshimeve klimatike, në mënyrë të planifikuar dhe proaktive;
- (iii) të sigurojë se konsideratat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike do të përfshihen në të gjitha planet dhe politikat, si dhe do të integrohen në të gjitha veprimtaritë dhe funksionet e Bashkisë Vlorë.

Ky Plan Vendor Veprimi i shërben Bashkisë Vlorë për realizimin e:

- shërbimit ndaj klientit, me fokus te efektiviteti i biznesit, përmirësimi i efikasitetit dhe ruajtja e mirëqenies së stafit, dhe
- shërbimeve bashkiake, ofrimin e shërbimeve dhe funksioneve në të gjithë zonën administrative dhe gjeografike të Vlorës.

7.1.1 Konteksti i këtij plani për Bashkinë Vlorë

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike synon të ndërtojë komunitete të qëndrueshme ndaj

ndryshimeve klimatike, të mbrojtë njerëzit, ekosistemet, bizneset, infrastrukturën dhe ndërtesat nga ndikimet negative të ndryshimeve klimatike. Është thelbësore që përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike të përfshihet te proceset vendimmarrëse të Bashkisë Vlorë dhe të zbatohet në mënyrë proaktive gjatë kryerjes së detyrave të bashkisë. Për më tepër, përfitimet dhe mundësitë, që mund të vijnë si rezultat i ndryshimeve klimatike, duhet të kapitalizohen në raport me kursimet e kostove dhe mënyrat e reja për të nxitur qëndrueshmërinë mjedisore.

Bashkia Vlorë ka për detyrë të përfshijë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike me kalimin e kohës të të gjitha funksionet, operacionet dhe shërbimet e bashkisë. Ky plan synon të ofrojë informacione dhe të përfshijë ndryshimet klimatike në planet dhe politikat ekzistuese të hartuara dhe të zbatuara prej saj. Kjo gjë siguron një qasje të mirëmbledhur, të qëndrueshme dhe koherente për t'u bërë ballë sfidave të klimës në ndryshim dhe për të krijuar qëndrueshmëri në bashki dhe në të gjitha komunitetet.

7.2 Procedura dhe kriteret e prioritizimit

Në seksionin vijues, ndikimet e rreziqeve të ndryshimeve klimatike (të renditura në kapitullin 5 dhe 6) janë marrë parasysh si përgjigje nga Bashkia Vlorë për ofrimin e shërbimeve dhe funksioneve. Pas marrjes në konsideratë të rreziqeve klimatike dhe të vlerësimeve për risqet shoqëruese, të cilat kanë ndikuar te Bashkia Vlorë (kapitulli 6), hapi tjetër për përgatitjen e planit vendor të veprimit është identifikimi i veprimeve të duhura, për të ndihmuar Bashkinë Vlorë të përmirësojë qëndrueshmërinë e saj ndaj ndryshimeve klimatike. Këto veprime janë kategorizuar sipas 5 fushave sektoriale, të cilat janë më të përshtatshmet për t'u synuar:

- Njerëzit, shëndetin, komunitetet dhe mjedisin e ndërtuar.
- Infrastrukturën.
- Biznesin dhe industrinë.
- Mjedisin natyror.
- Asetet dhe veprimtaritë e bashkisë.

Për të përmbushur objektivat e nivelit të lartë, të përshkruara në secilën nga pesë fushat sektoriale, dhe procesin gjithëpërfshirës të planeve vendore të përshtatjes, do të duhet të zbatohen një sërë veprimesh përshtatjeje në seksione të ndryshme të bashkisë, të cilat shtrihen në afate të ndryshme kohore (referojuni Tabelave A.1-A.6 në Shtojca V: **Lista e masave të përshtatjes** të propozuara).

Për më tepër, progresi dhe zbatimi i këtyre veprimeve do të kërkojë sigurimin dhe shpërndarjen e burimeve të duhura, si për financat ashtu edhe për personelin. Tabelat A.1-A.6 përshkruajnë gamën e veprimeve që duhen çuar përpara. Duke qenë se këto veprime për përshtatje mund të përfshijnë një përzierje masash infrastrukturore, ekologjike dhe të buta, përparimi dhe zbatimi i këtyre veprimeve do të kërkojë përfshirjen e departamenteve të ndryshme në bashki.

Te tabelat, çdo zonë sektoriale e identifikon Bashkinë Vlorë si “Drejtues”, duke kuptuar se mund të kërkojë mbështetje për të ndihmuar në realizimin e çdo veprimi, të përcaktuar si “Partneri”. Për më tepër, jepet një vlerësim i afatit kohor të mundshëm që nevojitet për të përfunduar çdo veprim, me afate kohore të përcaktuara si: Afatshkurtër (1-3 vjet), Afatmesëm (4-5 vjet) dhe Afatgjatë (5+ vjet).

Si rezultat i kësaj procedure, në Shtojca V: Lista e masave të përshtatjes të propozuara të këtij dokumenti është identifikuar dhe paraqitur një liste e gjatë me 81 masa/veprime, përgjegjësitë e zbatimit (drejtuesi dhe partnerët) dhe afati kohor i këtij dokumenti (i shkurtër-i mesëm-i gjatë).

Meqenëse lista është mjaft e gjatë, është ndërmarrë një hap i dytë për prioritizimin e masave/veprimeve për përshtatje, duke aplikuar metodologjinë e priorizimit (shihni Shtojca VI: Metodologjia për prioritizimin e masave për përshtatje), të përdorur tashmë në kuadrin e KKP-së dhe KK4 të rishikuar të Shqipërisë⁷⁸.

Në fillim, në këtë hap të dytë u përcaktuan (Tabela 7.1) kategori të shumta përshtatjeje dhe u krijua një listë me 44 veprime prioritare, në përputhje me rrethanat. Këto përfshinin bashkimin dhe riformulimin e disa prej veprimeve të parashikuara në këtë Raport. Metodologjia e përdorur është paraqitur në Shtojca VI: Metodologjia për prioritizimin e masave për përshtatje.

Ndër të tjera, vlerësohen me përparësi të lartë dhe shumë të lartë masat si më poshtë:

- Krijimi i një grupi drejtues me përfaqësues të duhur stafi nga të gjitha drejtoritë kryesore të Bashkisë Vlorë për të garantuar zbatimin me sukses të veprimeve të Planit Vendor të Veprimit dhe për të raportuar mbi progresin.
- Identifikimi i zonave me risk dhe përgatitja e një harte cenueshmërie klimatike për Bashkinë Vlorë, duke përdorur informacionin përkatës për risqet nga përmbytjet (përfshirë stuhitë detare), valët e të nxehtit dhe thatësitat, për të ndërmarrë veprime efektive për përshtatjen.
- Kryerja e një vlerësimi cenueshmërie dhe risku nga ndryshimet klimatike për infrastrukturën rrugore. Identifikimi i pjesëve të rrjetit/infrastrukturës, që kanë nevojë për shtim të qëndrueshmërisë.
- Krijimi dhe zhvillimi i një fushate ndërgjegjësimi për rolin e mjedisit natyror dhe kontributin e tij pozitiv të Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike.
- Punimet ekzistuese të mbrojtjes së bregdetit dhe krijimi i argjinaturave për përmbytjet nëpërmjet zbatimit të zgjidhjeve të bazuara në natyrë (Nbs) ose ndërhyrjeve gri (p.sh., integrimi i brigjeve me bimësi për të përmirësuar mbrojtjen nga përmbytjet duke zbutur forcën e valëve, mbështetja e një shumëllojshmërie specimesh bimore, mundësitë rekreative dhe habitatet e reja).
- Hartimi dhe zbatimi i masave për të luftuar erozionin e bregdetit në “Pyllin e Sodës” dhe erozionin e tokës në basenin lumor të Shushicës.
- Identifikimi i vendeve ose projekteve për gjelbërim të përkohshëm në tokë të lirë dhe të braktisur. Ndërhyrjet për mbrojtjen e maleve dhe pyllëzimi për shmangien e erozionit përgjatë Bypass-it të Vlorës, Rrugës së Orikumit - Tunelit të Llogarasë, etj. Përdorimi i specieve vendase me rezistencë të lartë për fiksime, formim humusi dhe rezistencë ndaj zjarrit.
- Restaurimi, përmes qasjes NbS, i zonave të degraduara, duke trajtuar zonat pyjore të djegura nga zjarret (Dukat, Llogora, Karaburun dhe Pylli i Pishë-Poros) dhe zonat e kullotave të djegura nga zjarret (Dukat, Llogora, Karaburun).
- Ndërhyrjet në pyllëzimin në fshatin “Dukat i Vjetër” për të rikuperuar 300 ha pyll të dëmtuar që nuk po rikuperohej për shkak të erozionit dhe shpëlarjes së dheut.
- Zbatimi i masave, përmes qasjes NbS, për mbrojtjen nga erozioni i tokave bujqësore në fshatin Trevllazër.
- Krijimi i kapaciteteve vendore për prodhimin e fidanëve të pemëve vendase për projektet e

⁷⁸ Kjo metodologji konsideron se, në përputhje me objektivat e përshtatjes së Marrëveshjes së Parisit, masat/veprimet e përshtatjes do të rrisin kapacitetin për përshtatje, do të forcojnë qëndrueshmërinë dhe do të reduktojnë cenueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike, me qëllim dhënien e kontributit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe sigurimit të një përgjigjeje të përshtatshme për kontekstin e objektivit të temperaturës, të përmendur në nenin 2 të Marrëveshjes së Parisit


pyllëzimit, përmes ngritjes së fidanishteve pyjore në vende strategjike, si fshatrat Dukat, Kaninë dhe Tragjas. Në këto fidanishte do të kultivohen fidanë vendas të përshtatur me kushtet klimatike vendore, duke siguruar furnizim të qëndrueshëm për përpjekjet për restaurim të përshtatura për speciet karakteristike të zonës.

- Përmirësimi i kullotave dhe përdorimi i specieve vendase, nëpërmjet farërave të grumbulluara në zonat përkatëse: Karaburun, Dukat, Tragjas, Shashicë, Kaninë, etj.
- Promovimi i restaurimit të shtresave pyjore midis sipërfaqeve bujqësore, Dukat i Ri, Tragjas Radhimë, për krijimin e mikrohabitave dhe mbrojtjen e kulturave bujqësore nga erërat e forta.

Vendndodhjet për zbatimin e mundshëm të qasjeve të integruara, të bazuara te ekosistemi (EbA), zgjidhjeve të bazuara te natyra (NbS) dhe/ose ndërhyrjet inxhinierike janë paraqitur në mënyrë skematike në

Figura 7.1
Figura 7.2, Figura 7.3 në vijim.

Figura 7.1 _ Vendndodhjet për EbA, NbS dhe/ose ndërhyrjet inxhinierike



Shënim: Ndërhyrjet e propozuara synojnë a) luftimin e erozionit të dheut në tokat e punueshme në fshatin Trevllazër; b) restaurimin e zonave të degraduara dhe zonave pyjore të djegura nga zjarret dhe c) rehabilitimin e argjinaturave të kanalit ujtitës Vjosë-Levan-Fier.

Figura 7.2 _ Zgjidhje të bazuara te natyra (NbS) dhe/ose ndërhyrje inxhinierike për të luftuar erozionin e tokës në fshatin Trevllazër



Figura 7.3 _ Masa për të restauruar zonat e degraduara dhe zonat pyjore të djegura nga zjarret



Tabela 7.1 _ Masat/veprimet e mundshme prioritare për përshtatje

| Masat për përshtatje | | | Niveli i prioritetit | Afati kohor S/M/L |
|--------------------------------|--|---|----------------------|------------------------|
| Politikat dhe qeverisja | Forcimi i kuadrit institucional (p.sh., koordinimi) | Ngritja e një Ekipi për Veprimin mbi Klimën me përfaqësues nga të gjitha funksionet kryesore të Bashkisë Vlorë, për të mbikëqyrur zbatimin e veprimeve të planit të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe për të raportuar mbi progresin. | Shumë i lartë | Afatshkurtër |
| | Forcimi i kuadrit të politikave: rregulloret dhe planet, përfshirë planet e veprimit dhe integrimin. | Hartimi i rregullores për të përfshirë konsideratat klimatike në projektimin, planifikimin dhe ndërtimin e të gjitha projekteve infrastrukturore të ndërmarra nga Bashkia Vlorë. | Mesatar | Afatshkurtër-afatmesëm |
| | | Krijimi i një sistemi efektiv komunikimi që: (i) mbështet pronarët e banesave private, (ii) ofron udhëzime për banorët e prekur nga ngjarjet ekstreme të motit, (iii) zhvillon fushatë komunikimi për të inkurajuar ndryshimin dhe për të krijuar qëndrueshmërinë e komuniteteve ndaj ndryshimeve klimatike dhe ngjarjeve të rënda të motit, (iv) rrit ndërgjegjësimin e publikut rreth rolit të Bashkisë Vlorë për sa i përket përgjigjes ndaj emergjencave klimatike, (v) lehtëson vlerësimin e ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe mundëson vlerësimin ekonomik të projekteve për përshtatje. | Mesatar | Afatmesëm |
| | | Hartimi dhe zbatimi i vlerësimit të riskut dhe planit korrigjues për stokun e identifikuar të banesave për Vlorën | I lartë | Afatmesëm |
| | | Hartimi dhe përshtatja e Strategjisë së Infrastrukturës së Gjellbër për të siguruar praninë e më shumë habitateve dhe habitateve të përmirësuara. Garantimi që hapësirat e gjelbra të sigurojnë gjithashtu përmirësime të biodiversitetit dhe promovimi i efikasitetit të eficiencës së energjisë, zgjidhjeve të energjisë së rinovueshme dhe masave të ruajtjes së ujit | I lartë | Afatshkurtër-afatmesëm |
| | | Hartimi/përditësimi i Planit të Biodiversitetit për të siguruar identifikimin e risqeve të ndryshimeve negative klimatike, vlerësimin e ndryshimeve të ardhshme dhe identifikimin e masave për trajtimin e çështjeve. | Mesatar | Afatmesëm |
| | | Përditësimi dhe përgatitja e Planeve të Menaxhimit të Kullotave dhe Pyjeve. Ndërhyrja për përmirësimin e kullotave dhe praktikave që qëndrueshme për të reduktuar intensitetin në zonat e mbishfrytëzuara (menaxhimi nëpërmjet kontratave, rotacioneve dhe përcaktimit të llojit dhe sipërfaqes për bagëtitë, si dhe rindërtimit të rezervuarëve të ujit, etj.) | I lartë | Afatmesëm-afatgjatë |
| | | Hartimi dhe miratimi i një Strategjie Peizazhi për të siguruar që planifikimi strategjik i peizazhit të marrë parasysh ndryshimet klimatike. | Mesatar | Afatmesëm |
| | | Zhvillimi i një sistemi për të dokumentuar, monitoruar dhe analizuar të dhënat mbi ndikimin e ngjarjeve atmosferike ekstreme në Bashkinë Vlorë. | Mesatar | Afatshkurtër-afatgjatë |
| | Rritja e financimit për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike: financimi dhe | Shërbimi si lehtësues në prezantimin e Pagesave për Shërbimet e Ekosistemit (PES), veçanërisht në sektorin e bujqësisë, për të kontribuar te një strategji e qëndrueshme financimi. | Mesatar | Afatshkurtër-afatmesëm |

| Masat për përshtatje | | Niveli i prioritetit | Afati kohor S/M/L | |
|---|---|--|-------------------|------------------------|
| | planifikimi fiskal | Zhvillimi i nismave të tjera për financimin mbi klimën, të tilla si modeli i koncesionit të tarifave të hyrjes, lejet e hyrjes, miratimi i zhvillimit dhe dhënia e kredive të kushtëzuara për zhvillimin e strategjisë së financimit të qëndrueshëm. | I lartë | Afatshkurtër-afatmesëm |
| Kapaciteti shkencor, teknik dhe shoqëror | Gjenerimi i provave shkencore për të mbështetur vendimmarrjen mbi PNK-së | Identifikimi i zonave me risk dhe përgatitja e një harte cenueshmërie klimatike për Bashkinë Vlorë, duke përdorur informacionin përkatës për risqet nga përmbytjet (përfshirë stuhitë detare), valët e të nxehtit dhe thatësitat, për të ndërmarrë veprime efektive për përshtatjen. Identifikimi dhe trajtimi i mungesës së njohurive në menaxhimin e riskut për përmbytje dhe vlerësimet e riskut për përmbytje. Angazhimi i palëve vendore të interesit për të mbledhur të dhëna mbi praktikatat aktuale të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike që përdoren nga fermerët dhe pylltarët. Rishikimi i studimeve të mëparshme mbi cenueshmëritë që vijnë nga ndryshimet klimatike dhe mbi përshtatjen ndaj tyre; Hartëzimi GIS i cenueshmërive; identifikimi i zonave prioritare me risk; | Shumë i lartë | Afatshkurtër |
| | | Kryerja e një vlerësimi cenueshmërie dhe risku nga ndryshimet klimatike për infrastrukturën rrugore. Identifikimi i pjesëve të rrjetit/infrastrukturës, që kanë nevojë për shtim të qëndrueshmërisë dhe integrimi i tyre në proceset vendimmarrëse për programimin (projektimin, planifikimin dhe mirëmbajtjen) e infrastrukturës rrugore; | Shumë i lartë | Afatmesëm |
| | | Përmirësimi i bashkëpunimit me akademikët në mënyrë që të shkëmbehen praktikatat dhe njohuritë më të mira. Pjesëmarrja në projekte rajonale dhe evropiane për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike | Mesatar | Afatshkurtër |
| | | Mbështetja e bizneseve për prezantimin e sektorëve të menaxhimit të riskut në shoqëritë e tyre | Mesatar | Afatshkurtër-afatmesëm |
| | Rritja e kapaciteteve teknike | Krijimi dhe prezantimi i një programi trajnimi për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke siguruar se të gjithë anëtarët e stafit bashkiak janë të informuar për rolin e tyre për realizimin i veprimeve për ndryshimet klimatike. | I lartë | Afatshkurtër-afatmesëm |
| | | Përmirësimi i provave dhe njohjes së risqeve ndërvepruese dhe të njëpasnjëshme në të gjithë zinxhirin e furnizimit. Gjithashtu, ekziston nevoja për të kuptuarit më të mirë vendor të rreziqeve komplekse të klimës, siç janë stuhitë dhe lloje të tjera të thatësitave | I lartë | Afatshkurtër-afatmesëm |
| Rritja e ndërgjegjësimit | Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit publik dhe programeve trajnuese mbi ndryshimet klimatike për të rritur njohuritë, për të inkurajuar ndryshimin e sjelljes dhe për të krijuar qëndrueshmëri në komunitetet ndaj ndryshimeve klimatike dhe ngjarjeve të rënda atmosferike (p.sh., përmbytjet, ndikimi në shëndet, etj.). | I lartë | Afatmesëm | |
| | Zhvillimi dhe zbatimi i ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit për zonat e mbrojtura (si lumi i Vjosës, laguna e Nartës dhe laguna e Orikut) dhe efektet e ndryshimeve klimatike në to. | Shumë i lartë | Afatmesëm | |

| Masat për përshtatje | | | Niveli i prioritetit | Afati kohor S/M/L |
|--|---|--|----------------------|------------------------|
| | | Zbatimi i një plani gjithëpërfshirës komunikimi për të siguruar shpërndarje efektive të informacionit në lidhje me masat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në bujqësi dhe pylltari | I lartë | Afatmesëm |
| Realizimi i masave ndaj ndryshimeve klimatike | Mbrojtja e ndërtesave dhe objekteve nga faktorët klimatikë për të parandaluar dëmtimin dhe degradimin e mëtejshëm | Sigurimi i programeve të rinovimit të banesave për realizimin e objektivave për eficiencën e energjisë, të tilla si: masat për eficiencën e ujit, opsionet e hijezimit, ajrimi natyror, tarracat e gjelbra, gjelbërimi vertikal, për të përmirësuar performancën termike dhe për të garantuar rehati gjatë valëve të të nxehtit, | I lartë | Afatgjatë |
| | | Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave lidhur me ndikimet e ngjarjeve klimatike ekstreme, përfshirë: <ul style="list-style-type: none"> - Hulumtimin, grumbullimin dhe dokumentimin e ndikimeve të ngjarjeve klimatike ekstreme në Vlorë. - Evidentimi i ndikimeve të ngjarjeve klimatike në ndërtesa dhe infrastrukturë kritike përmes hartëzimit në GIS, për të ndihmuar në identifikimin e rreziqeve dhe zonave të cenueshme, për të mundësuar planifikimin për përshtatje në të ardhmen. - Vazhdimi i aktivizimit të Protokollit të Emergjencave për Kushte Atmosferike të rënda gjatë periudhave të motit ekstrem, duke siguruar aksesin në strehim të personave të pastrehë. - Vazhdimi i monitorimit të cilësisë së ajrit duke garantuar që është në nivel të sigurt gjatë periudhave me temperatura të larta. | I lartë | Afatshkurtër |
| | | Termoizolimi i të gjitha objekteve publike, veçanërisht shkollave, kopshteve dhe çerdheve; | I lartë | Afatgjatë |
| | | Futja e një sistemi raportimi dhe monitorimi për izolimin e ndërtesave, për të siguruar ndërtesa të qëndrueshme ndaj nxehtësisë. | Shumë i lartë | |
| Bujqësia | | Monitorimi dhe menaxhimi i përhershëm i organizmave të dëmshëm dhe sëmundjeve në kulturat bujqësore dhe pemë. Identifikimi i varieteteve të kulturave bujqësore rezistente ndaj klimës, të përshtatshme për kushtet klimatike në ndryshim të Vlorës. | I lartë | Afatshkurtër-afatmesëm |
| | | Përgatitja e një plani qëndrueshmërie për vënien në kontroll të infektiveve nga parazitët, insektet dhe speciet invazive, që lidhen me të nxehtin. | I lartë | Afatmesëm |
| | | Vlerësimi, identifikimi dhe zbatimi i veprimeve pilot për të testuar teknologjitë dhe praktikat novatore për bujqësinë e qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike, duke përfshirë metoda novatore për mbrojtjen e vreshtave nga rrezatimi diellor, si përdorimi i mbulesave mbrojtëse për të reduktuar ekspozimin e drejtpërdrejtë të bimëve ndaj rrezatimit. | Mesatar | |
| | | Përmirësimi i sistemeve të ujitjes duke siguruar burime ujore (përmirësimi i rezervuarëve të ruajtjes së ujit) | Shumë i lartë | Afatshkurtër-afatmesëm |

| Masat për përshtatje | | Niveli i prioritetit | Afati kohor S/M/L |
|----------------------|---|----------------------|------------------------|
| Pylltaria | Rigjenerimi i pyjeve të Vlorës / pyllëzimi i ri përmes mbjelljes së fidanëve vendas dhe me qëndrueshmëri të lartë për të mundësuar përmirësimin e pyllëzimit, dhe hartimi i një plani zbatimi/planeve përgatitore për të minimizuar ndikimin e zjarreve në pyje. | I lartë | Afatmesëm-afatgjatë |
| | Vëzhgimi i pemëve dhe strukturave që janë të cenueshme nga erërat e forta dhe që mund të paraqesin risk dëmtimi nëse shemben/bien gjatë erërave të forta. Vlerësimi i ndikimit të ngjarjeve atmosferike ekstreme dhe i praktikave të pyllëzimit në "Pyllin Pishë-Poro" dhe "Pyllin e Sodës". | I lartë | Afatmesëm-afatgjatë |
| | Pyllëzimi i zonave bregdetare me <i>Tamarix parviflora</i> dhe specie të tjera shkurrësh vendase, veçanërisht në zonat bregdetare të Pishë-Poros, deltës së lumit Vjosë, deri në "Pyllin e Sodës". | I lartë | Afatmesëm-afatgjatë |
| | Ndërhyrja përmes masave të pylltarisë dhe pyllëzimi me synim krijimin e shtresave natyrore, pa skema uniformë mbjelljeje, ndryshe nga pylli ekzistues i Sodës, i cili është i mbjellë me një skemë sipërfaqësore sistemi rrënjor 2*3 dhe është shumë i kërcënuar nga erërat e forta. | I lartë | Afatmesëm-afatgjatë |
| Biodiversiteti | <p>Mbrojtja dhe përmirësimi i ambienteve të gjelbra të hapura, habitateve dhe korridoreve ekologjike në nivel peizazhi nëpërmjet projekteve të peizazhit, duke zbatuar një skemë zhvilluesi me Fitim Neto të Biodiversitetit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sigurimi që të mirëmbahen dhe mbrohen zonat e përshtatshme buferike për të shmangur ndikimet e mundshme në habitatet e përcaktuara, ose speciet dhe habitatet e mbrojtura, dhe për të mbrojtur dhe përmirësuar biodiversitetin më të gjerë. Identifikimi dhe mbrojtja e habitateve dhe specieve të Natura 2000 në territorin e Bashkisë Vlorë, duke përfshirë zonat brenda dhe jashtë Zonave të Mbrojtura - Nxitja e krijimit dhe respektimit të zonave buferike të Parkut Kombëtar të Mbrojtur të Lumit Vjosa. - Identifikimi i vendeve ose projekteve për gjelbërim të përkohshëm në tokë të lirë dhe të braktisur. Ndërhyrjet për mbrojtjen e maleve dhe pyllëzimi për shmangien e erozionit përgjatë Bypass-it të Vlorës, Rugës së Orikumit - Tunelit të Llogarasë, etj. Përdorimi i specieve vendase me rezistencë të lartë për fiksion, formim humusi dhe rezistencë ndaj zjarrit. - Krijimi i korridoreve të mbrojtjes nga zjarri në zonat natyrore, veçanërisht në pyje | Shumë i lartë | Afatshkurtër-afatmesëm |
| Energjia | Inkurajimi i më shumë komuniteteve që të ndjekin në mënyrë aktive projektet për reduktimin e konsumit të energjisë dhe për pakësimin e sasisë së karbonit. | Shumë i lartë | Afatshkurtër-afatmesëm |

| Masat për përshtatje | | Niveli i prioritetit | Afati kohor S/M/L |
|---|---|----------------------|------------------------|
| | Hartimi i planit të përshtatjes, veçanërisht për rehabilitimin dhe forcimin e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes për përgjigje ndaj erërave më të forta dhe më të shpeshta. | Shumë i lartë | Afatshkurtër-afatgjatë |
| Transporti | Përfshirja e konsideratave klimatike në projektimin, planifikimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha rrugëve, trotuareve, urave dhe projekteve të tjera ndërtimore | I lartë | Afatmesëm-afatgjatë |
| | Përgatitja e Planit të Lëvizshmërisë Urbane të Qëndrueshme të qytetit të Vlorës me angazhimin e palëve të interesit dhe krijimi i Partneriteteve me bizneset private për të promovuar veprimin për Lëvizshmëri të Qëndrueshme, si instalimi i stacioneve të karikimit të automjeteve elektrike në objektet e tyre. Ndërmarrja e ndryshimeve strukturore afatgjata në organizimin e transportit dhe lëvizshmërisë (p.sh., ndryshimi i sjelljes ndaj transportit dhe kërkesat për transport). | I lartë | Afatmesëm-afatgjatë |
| Shëndeti | Rishikimi i listës së banorëve të cenueshëm për të mundësuar identifikimin e atyre që mund të jenë më të rrezikuar nga ndryshimet klimatike, veçanërisht nga moti ekstrem, dhe për të ofruar përgjigje proaktive sipas nevojës. | I lartë | Afatshkurtër-afatmesëm |
| Popullsia | Eksplorimi i mënyrave se si Bashkia Vlorë mund të ndihmojë grupet e cenueshme (p.sh., gratë kryefamiljare, romët dhe egjiptianët, etj.) dhe njerëzit e izoluar (të moshuarit) dhe komunitetet që të jenë më të qëndrueshme ndaj klimës. | I lartë | Afatshkurtër-afatmesëm |
| Infrastruktura urbane | Planifikimi i zgjidhjeve të Qëndrueshme të Kullimit Urban për Menaxhimin e Ujërave Sipërfaqësore dhe Parandalimin e Përmbytjeve. Hartimi i një plani gjithëpërfshirës për zgjidhje të qëndrueshme të kullimit urban për të menaxhuar në mënyrë efektive ujërat sipërfaqësore dhe për të zbutur riskun nga përmbytjet në mjediset urbane. Sigurimi që për të gjitha zhvillimet e reja tregtare të kërkohej përfshirja e një sistemi të qëndrueshëm të kullimit urban. | I lartë | |
| Turizmi | Identifikimi i masave për rritjen e qëndrueshmërisë së ndërtesave të trashëgimisë/historike, në pronësi dhe në operim të Bashkisë Vlorë, ndaj ngjarjeve atmosferike ekstreme. Identifikimi i masave ripërteritëse për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore të Gjirit të Vlorës, e cila ndikohet edhe nga ndryshimi i temperaturave të detit | Shumë i lartë | Afatshkurtër-afatmesëm |
| Përshtatja e mjedisit natyror mbështetës | Përshtatja e qasjeve të integruara të bazuara te ekosistemi (EbA), e zgjidhjeve të bazuara te natyra (NbS) dhe/ose e ndërhyrjeve inxhinierike | Shumë i lartë | Afatshkurtër-afatgjatë |
| | Punimet ekzistuese të mbrojtjes së bregdetit dhe krijimi i argjinaturave për përmbytjet nëpërmjet zbatimit të zgjidhjeve të bazuara në natyrë ose ndërhyrjeve gri (p.sh., integrimi i brigjeve me bimësi për të përmirësuar mbrojtjen nga përmbytjet duke zbutur forcën e valëve, mbështetja e një shumëllojshmërie specimesh bimore, mundësitë rekreative dhe habitatet e reja). Marrja në konsideratë dhe shqyrtimi i përdorimit të masave ruajtje natyrore të ujit në zona të caktuara të përshtatshme si një metodë për menaxhimin e riskut për përmbytje, përmirësimin e cilësisë së ujit, përmirësimin e biodiversitetit, menaxhimin e tokës dhe sedimenteve dhe krijimin e zonave atraktive të reja ose shtesë. | I lartë | Afatmesëm |

| Masat për përshtatje | Niveli i prioritetit | Afati kohor S/M/L |
|---|----------------------|---------------------|
| <p>Hartimi dhe zbatimi i masave për të luftuar erozionin e bregdetit në “Pyllin e Sodës”; Shpallja e “Pyllit të Sodës” dhe hapësirave të tjera të gjelbra përreth qytetit të Vlorës “Park Bashkiak” ose “Kurorë e Gjelbër” e qytetit të Vlorës (hartimi i planit të menaxhimit të tij).</p> | Shumë i lartë | Afatmesëm-afatgjatë |
| <p>Hartimi dhe zbatimi i masave për të luftuar erozionin e tokës në basenin lumor të Shushicës. Nxitja e ruajtjes së leshterikëve të detit (Posidonia) të grumbulluar në brigjet e detit dhe përdorimit të zonave natyrore të plazhit. Nxitja e ruajtjes dhe restaurimit të habitatit të livadheve të leshterikëve të detit (Posidonia) në Gjirin e Vlorës.</p> | Shumë i lartë | Afatmesëm-afatgjatë |
| <p>Restaurimi, përmes qasjes NbS, i zonave të degraduara dhe zonave pyjore të djegura nga zjarret (Llogara, Karaburun, pylli i Pishë-Poros, etj.). Ndërhyrjet në pyllëzimin në fshatin “Dukat i Vjetër” për të rikuperuar 300 ha pyll të dëmtuar që nuk po rikuperohej për shkak të erozionit dhe shpëlarjes së dheut.</p> | I lartë | Afatmesëm-afatgjatë |
| <p>Zbatimi i masave, përmes qasjes NbS, për mbrojtjen nga erozioni i tokave bujqësore në fshatin Trevllazër</p> | I lartë | Afatmesëm-afatgjatë |
| <ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i kapaciteteve vendore për prodhimin e fidanëve të pemëve vendase për projektet e pyllëzimit, përmes ngritjes së fidanishteve pyjore në vende strategjike, si fshatrat Dukat, Kaninë dhe Tragjas. Në këto fidanishte do të kultivohen fidanë vendas të përshtatur me kushtet klimatike vendore, duke siguruar furnizim të qëndrueshëm për përpjekjet për restaurim të përshtatura për speciet karakteristike të zonës. - Përmirësimi i kullotave dhe përdorimi i specieve vendase, nëpërmjet farërave të grumbulluara në zonat përkatëse Karaburun, Dukat, Tragjas, Shushicë, Kaninë, etj. - Promovimi i restaurimit të shtresave pyjore midis sipërfaqeve bujqësore, Dukat i Ri, Tragjas Radhimë, për krijimin e mikrohabitateve dhe mbrojtjen e kulturave bujqësore nga erërat e forta. | I lartë | |
| <p>Marrja e masave për mbrojtjen ndaj përmytjeve për segmentin Mifol – Portokalle.</p> <p>Kontrolli dhe mirëmbajtja e prurjes së rregullt të ujit në Nartë dhe në Lagunën e Orikumit. Sigurimi i qarkullimit të brendshëm të ujit në laguna nëpërmjet mirëmbajtjes së kanaleve të brendshme dimërore e verore, dhe</p> <p>Rindërtimi i 2 stacioneve të pompimit në Akërnë (zona e aeroportit) dhe Orikum. Rigjenerimi i zonave breglumore/moçalore të luginës së Dukatit të Ri/Orikumit, rreth 300 ha tokë të bonifikuar. Promovimi i ruajtjes së “pellgjeve ujore” natyrore në zonë për të siguruar ruajtjen e habitateve të shpendëve të ujit.</p> | I lartë | Afatmesëm-afatgjatë |

| Masat për përshtatje | | Niveli i prioritetit | Afati kohor S/M/L |
|--|---|----------------------|------------------------|
| Forcimi i menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë | Garantimi që planet e përgjigjes ndaj emergjencave të përmbytjeve të rishikohen çdo vit për të siguruar që është vënë në dispozicion kapaciteti i duhur i burimeve për të ofruar përgjigje efektive ndaj emergjencave. Rishikimi dhe përditësimi i Planeve të Përgjigjes ndaj Emergjencave për të marrë parasysh ndryshimet klimatike, shpeshtësinë dhe ashpërsinë e ngjarjeve klimatike. | Shumë i lartë | Afatshkurtër-afatgjatë |
| | Krijimi i Regjistrit për Riskun dhe Mundësitë për mbrojtjen e infrastrukturës nga përmbytjet. | I lartë | Afatmesëm-afatgjatë |

7.3 Qeverisja, monitorimi dhe vlerësimi

Për sa i përket mbikëqyrjes dhe zbatimit të planit, është thelbësore të krijohet një kuadër në Bashkinë Vlorë për të mbështetur zbatimin e suksesshëm dhe praktik të veprimeve të përshtatjes. Duke pasur parasysh se kjo strategji përfaqëson të gjitha funksionet dhe operacionet e Bashkisë Vlorë.

Gjatë zbatimit të veprimeve të këtij plani, Bashkia Vlorë do të përpiqet të sigurojë minimizimin e çdo ndikimi të mundshëm mjedisor. Veprimet do të shqyrtohen në kontekstin e përfitimeve të përbashkëta të mundshme, përfshirë masat si: shëndeti i njeriut, rritja dhe mbrojtja e biodiversitetit, përmirësimi i cilësisë së ujit, administrimi i zonave në risk nga përmblytjet dhe përcaktimi i qëndrueshëm i përdorimit të tokës, si dhe praktikatat e zhvillimit. Është e rëndësishme të prioritetizohen veprimet, të cilat sjellin përfitime të shumta mjedisore dhe sociale.

7.3.1 Përfaqësimi

Është e rëndësishme që Grupi Drejtues të bëjë bashkë përfaqësues të të gjitha fushave kyç funksionale me ekspertiza të ndryshme teknike, operacionale dhe menaxheriale, të cilët mund të kryejnë me sukses detyrat e nevojshme dhe të zbatojnë veprimet e përfshira në strategji.

7.3.2 Zbatimi

Grupi drejtues do të jetë përgjegjës për realizimin dhe do të hartojë një metodologji për zbatimin e këtij Plani Vendor Veprimi, që do të përfshijë:

- Prioritetizimin e veprimeve të përshtatjes për realizim brenda periudhave kohore afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, sikurse përcaktohen në planin vendor të veprimit;
- Identifikimin e autoritetit përgjegjës/drejtues, caktimin e përgjegjësisë për realizim / Identifikimin e personit përgjegjës për zbatimin e veprimeve të përshtatjes;
- Zhvillimin e një qasjeje dhe fillimin e zbatimit të veprimeve;
- Identifikimin e fondeve të nevojshme për veprimet;
- Identifikimin/përcaktimin e treguesve ose objektivave kryesore si mekanizma për matjen e rezultateve;
- Ndërlidhjen me palët e interesit dhe sektorët e tjerë, si në nivel vendor ashtu edhe në atë rajonal, aty ku kërkohet zbatimi i veprimeve / Bashkëpunimin e kërkuar me palët e tjera të interesit;
- Identifikimin se ku mund të përfshihen veprimet në planet, politikat dhe buxhetet ekzistuese.

7.3.3 Raportimi

Grupi Drejtues duhet të:

- Monitorojë dhe vlerësojë zbatimin e veprimeve dhe të caktojë afatin kohor kur do të zbatohen masat;
- Përdorë rezultatet nga programi i monitorimit dhe vlerësimit për të rishikuar vlerësimet e riskut, për të bërë ndryshime aty ku është e nevojshme bazuar te monitorimi i rezultateve/ndryshimeve/shkencës së klimës;
- Identifikojë risqet për zbatimin e veprimeve dhe të raportojë mbi progresin te ekipi i menaxhimit.

8 Shtojcat

Shtojca I: Qasja e palëve të interesit lidhur me përgatitjen e Planit Vendor të Vlorës për Përshtatje

Tabela 8.1 _ Qasje për përgatitjen e Planit të Vlorës për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike

| Nr. | Afati kohor | Vendi | Aktivitetet e ndërmarra dhe qëllimi |
|-----|--------------------------|----------------------------|---|
| 1 | Maj 2022 | Tiranë | Përzgjedhja e Bashkisë Vlorë si bashkia partnere e projektit PKP, bazuar në një vlerësim “me shumë kritere”. |
| 2 | 8 korrik 2022 | Vlorë | Takimi fillestar prezantues me punonjësit e Bashkisë Vlorë; Takimi u organizua në formën e një workshop-i, ku morën pjesë kryetari i bashkisë, zëvendës kryetari dhe përfaqësuesit e drejtorive kryesore. Marrëveshja për nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit midis Bashkisë dhe UNDP-së për të zyrtarizuar partneritetin ndërmjet palëve. Marrëveshja për caktimin e një pikë kontakti koordinuese në bashki dhe për krijimin e një grupi teknik pune me përfaqësues nga sektorët prioritarë të identifikuar, si dhe nga departamenti i statistikave. |
| 3 | 8 shtator 2022 | Vlorë | Takimet e dedikuara teknike me palët e interesit të Bashkisë Vlorë. Takimet dhe diskutimet me përfaqësuesit e pesë sektorëve prioritarë të PKP-së në Bashkinë Vlorë, si dhe takimet me përfaqësuesit e Prefekturës Vlorë dhe të Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Vjosë u zhvilluan për të kuptuar më mirë çështjet e qeverisjes, koordinimin ndërinstitucional, procedurat dhe/ose qasjet si dhe aftësitë, kapacitetet dhe kapacitetet teknike për përshtatje. Në Bashkinë Vlorë u takuan gjithsej 14 përfaqësues vendorë (5 femra dhe 9 meshkuj). |
| 4 | 19 – 20 dhjetor 2022 | Tiranë | U zhvillua workshop-i për punë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të nivelit kombëtar dhe nënkombëtar, gjatë të cilit u prezantuan dhe u diskutuan gjetjet paraprake të vlerësimit, së bashku me qasjen e propozuar për ngritjen e kapaciteteve. |
| 5 | 7 – 9 mars 2023 | Tiranë | Workshop-i për vlerësimin e cenueshmërisë. Qëllimi i workshop-it ishte të mbështeste kryerjen e vlerësimeve vendore të riskut dhe cenueshmërisë të bazuara në fakte, dhe të ofronte trajnime për stafin bashkiak mbi analizimin e informacionit për klimën, kryerjen e vlerësimeve të cenueshmërisë dhe përshtatjes dhe mbi skenarët klimatikë për përgatitjen e planeve vendore të përshtatjes dhe trajnimin e autoriteteve vendore në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile. Në workshop-in në Tiranë morën pjesë 3 përfaqësues të grupeve të interesit nga Vlora (2 femra dhe 1 mashkull). |
| 6 | Mars deri në prill 2023 | Korrespondencë elektronike | Raporti mbi “Vlerësimin e kapaciteteve të bashkive dhe nevojave për trajnime lidhur me Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike” iu shpërnda të gjithë stafit të bashkive për komente dhe vlerësime. |
| 7 | Maj deri në qershor 2023 | Korrespondencë elektronike | Nisja e përgatitjes së Planeve Vendore të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike Modeli udhëzues për Vlerësimet e Riskut dhe Cenueshmërisë, si dhe tabelat në “Excel” për mbledhjen e kategorive të të dhënave i) demografike, ii) socio-ekonomike si dhe iii) klimatike/mjedisore në dispozicion në nivel vendor u shpërndanë me synim për të vlerësuar riskun dhe cenueshmërinë e Bashkisë Vlorë ndaj ndryshimeve klimatike, për të hartuar Planin Vendor të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike. |
| 8 | 4 maj 2023 | Vlorë | Takimi teknik për përgatitjen e Planeve Vendore të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike Takimet ndihmuan për nisjen zyrtare të përgatitjes së Planeve Vendore të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike; Shënimi udhëzues dhe bazat e të dhënave në “Excel” u |

| Nr. | Afati kohor | Vendi | Aktivitetet e ndërmarra dhe qëllimi |
|-----|------------------------------|----------------------------|--|
| | | | <p>ndanë me të gjitha bashkitë përpara organizimit të takimeve.</p> <p>Në takim morën pjesë 8 përfaqësues të bashkisë (5 femra dhe 3 meshkuj).</p> |
| 9 | Qershor deri në shtator 2023 | Korrespondencë elektronike | <p>Mbledhja e të dhënave nga bashkitë.</p> <p>Pati vonesa gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave, u vërejt vështirësi në komunikim dhe koordinim i brendshëm i dobët mes bashkive lidhur me sigurimin e të dhënave të nevojshme në formatin e kërkuar; shumica e të dhënave të marra nuk ishin në rend kronologjik për të kuptuar prirjet.</p> |
| 10 | Gusht 2023 | Korrespondencë elektronike | <p>Kërkesa zyrtare të posaçme për informacion në lidhje me të dhënat e nevojshme janë hartuar dhe i janë dërguar pikës së kontaktit të Projektit PKP në Drejtorinë e Ndryshimeve Klimatike në MTM për t'ua përcjellë institucioneve të tjera kombëtare, gjithsej shtatë agjencie/institucioneve vartëse kombëtare, që mbledhin të dhëna nga zyrat e tyre rajonale.</p> <p>Përveç Institutit Kombëtar të Tokës dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, nuk pati asnjë përgjigje apo reagim nga ndonjë Agjenci tjetër Kombëtare.</p> |
| 11 | Gusht deri në shtator 2023 | Nuk ka | <p>Të gjitha të dhënat e mbledhura janë formatuar, përmirësuar, përkthyer, komentuar (aty ku ka qenë e nevojshme) dhe janë ndarë me Ekspertin Ndërkombëtar të Klimës për vlerësim dhe referencë të mëtejshme në PVP-të, që do të hartohen.</p> |
| 12 | 5 tetor 2023 | Vlorë | <p>Workshop-i trajnues i Bashkisë Vlorë për përshtatjen</p> <p>Workshop-i i palëve të interesit pati në fokus identifikimin e rreziqeve klimatike dhe vlerësimin e risqeve klimatike; gjatë tij u bë edhe pikëzimi i risqeve sipas sektorëve prioritarë kyç.</p> <p>Në workshop morën pjesë 25 persona (11 femra dhe 14 meshkuj), duke përfshirë përfaqësues të Bashkisë Vlorë, Prefekturës Vlorë dhe Agjencisë Rajonale të Zonave të Mbrojtura Vlorë (ARZM), Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier (që mbulon bashkitë Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë) dhe Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Lushnjë (që mbulon bashkitë Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë).</p> |
| 13 | Tetor 2023 | Korrespondencë elektronike | <p>Në vijim të diskutimeve në workshop, një email i posaçëm iu dërgua përfaqësuesve të Bashkisë Vlorë dhe palëve kryesore vendore të interesit për të ofruar masa prioritare “specifike” për bashkinë e tyre.</p> <p>Bashkia Vlorë shpërndau masat kryesore të PNK-së bazuar te dokumentet strategjike vendore të disponueshme.</p> |
| 14 | Tetor deri në janar 2023 | Nuk ka | <p>Përgatitja dhe konsolidimi i draftit të parë PVP të Vlorës.</p> |
| 15 | Janar deri në shkurt 2024 | Korrespondencë elektronike | <p>Ndarja dhe konsultimi i draftit PVP dhe i bazave të të dhënave me Bashkinë Vlorë.</p> <p>Në vijim të konsolidimit të draftit të parë PVP të Vlorës, ai iu shpërndo Bashkisë Vlorë, dhe jo vetëm, për komente dhe/ose reagime. Qëllimi ishte përgatitja e një dokumenti, që pasqyron nevojat reale dhe që do të përdoret në vijim nga bashkitë për mobilizimin e fondeve për trajtimin e ndërhyrjeve të PNK-së.</p> <p>Hartimi dhe miratimi i PVP-së përfundimtare të Vlorës.</p> |
| 16 | Mars / prill 2024 | Tiranë | <p>Prezantimi zyrtar i PVP-së së Vlorës.</p> <p>Miratimi i PVP-së së Vlorës nga Këshilli Bashkiak.</p> |

Shtojca II: Parashikimet për ndryshimet klimatike

Në kuadër të mbështetjes për planifikimin për risqet, duhet të kuptojmë ndikimin më të keq të mundshëm të ndryshimeve klimatike, rastin më ekstrem të parashikimeve për ndryshimet klimatike. E gjithë shkenca dhe modelimi i klimës u nënshtrohet supozimeve, paralajmërimeve dhe kufizimeve, të cilat nënkuptojnë se asnjë vlerësim nuk mund të konsiderohet si reflektim ose parashikim absolut i kushteve të së ardhmes. SSP-të e përditësuara janë emërtuar "SSPx-y", ku "SSPx" u referohet pesë skenarëve socio-ekonomikë dhe "y" u referohet niveleve të përafërta të forcës rrezatuese. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i pesë SSP-ve:

- **SSP1: Të përbashkëtat globale po ruhen:** kufijtë e natyrës po respektohen. Fokusi është më shumë te mirëqenia njerëzore sesa te rritja ekonomike. Madje, pabarazitë e të ardhurave ndërmjet dhe brenda shteteve po pakësohen. Konsumi është orientuar drejt minimizimit të burimeve materiale dhe përdorimit të energjisë.
- **SSP2: Zhvillimi në të ardhmen:** Prirjet e të ardhurave në vende të ndryshme po ndryshojnë ndjeshëm. Ekziston një bashkëpunim i caktuar ndërmjet shteteve, i cili nuk është zgjeruar thuajse fare. Rritja globale e popullsisë është mesatare, duke mbetur konstante në gjysmën e dytë të shekullit. Sistemet mjedisore po përballen me një degradim të caktuar.
- **SSP3: Rivaliteti rajonal:** Rikthimi i nacionalizmit dhe konflikteve rajonale i çon çështjet globale në plan të dytë. Politikat po përqendrohen gjithnjë e më shumë te çështjet e sigurisë kombëtare dhe rajonale. Madje, investimet në arsim dhe zhvillim teknologjik janë në rënie. Pabarazia po rritet. Disa rajone po pësojnë dëme drastike mjedisore.
- **SSP4: Pabarazia:** Hendeku mes shoqërive të zhvilluara, që bashkëpunojnë globalisht, dhe atyre, që kanë mbetur në një fazë të ulët zhvillimi, me të ardhura të ulëta dhe me nivel të ulët arsimor po zgjerohet. Politikat mjedisore janë të suksesshme për trajtimin e problemeve vendore në disa rajone, por jo te të tjerat.
- **SSP5: Zhvillimi i nxitur nga lëndët djegëse:** Tregjet globale po integrohen gjithnjë e më shumë, duke sjellë inovacione dhe përparime teknologjike. Megjithatë, zhvillimi social dhe ekonomik bazohet në shfrytëzimin intensiv të burimeve të lëndëve djegëse fosile me përqindje të lartë qymyri dhe në jetesën e varur kryesisht nga energjia në mbarë botën. Ekonomia botërore po rritet dhe problemet vendore mjedisore si ndotja e ajrit po trajtohen me sukses.

Për çdo skenar parashikohet një rritje e temperaturës globale, siç paraqitet në tabelën më poshtë:

Tabela 8.2 _ Rritja e parashikuar e temperaturës globale sipas skenarëve të ndryshëm

| Skenari | Afatshkurtër, 2021–2040 | | Afatmesëm, 2041–2060 | | Afatgjatë, 2081–2100 | |
|----------|-------------------------------|------------------------------|-------------------------------|------------------------------|-------------------------------|------------------------------|
| | Përlllogaritja më e mirë (°C) | Intervali më i mundshëm (°C) | Përlllogaritja më e mirë (°C) | Intervali më i mundshëm (°C) | Përlllogaritja më e mirë (°C) | Intervali më i mundshëm (°C) |
| SSP1-1.9 | 1.5 | 1.2 deri në 1.7 | 1.6 | 1.2 deri në 2.0 | 1.4 | 1.0 deri në 1.8 |
| SSP1-2.6 | 1.5 | 1.2 deri në 1.8 | 1.7 | 1.3 deri në 2.2 | 1.8 | 1.3 deri në 2.4 |
| SSP2-4.5 | 1.5 | 1.2 deri në 1.8 | 2 | 1.6 deri në 2.5 | 2.7 | 2.1 deri në 3.5 |
| SSP3-7.0 | 1.5 | 1.2 deri në 1.8 | 2.1 | 1.7 deri në 2.6 | 3.6 | 2.8 deri në 4.6 |
| SSP5-8.5 | 1.6 | 1.3 deri në 1.9 | 2.4 | 1.9 deri në 3.0 | 4.4 | 3.3 deri në 5.7 |

Burimi: TS, Ndryshimet klimatike 2021: Baza e Shkencës Fizike. Kontributi i WGI-së për AR6 të PNNK-së (TS, Climate Change 2021: The Physical Science Basis. Contribution of WGI to the AR6 of the IPCC)

Shtojca III: Integrimi i vlerësimeve të cenueshmërisë dhe të riskut

Vlerësimi i ndjeshmërisë

Tabela 8.3 _ Shkalla e ndjeshmërisë

| Shkalla e vlerësimit | Niveli i ndjeshmërisë | Përkufizimi |
|----------------------|-----------------------|---|
| 0 | Nuk ka ndjeshmëri | Nuk rrezikohet jeta dhe shëndeti i njeriut; nuk ka viktimë; nuk ka humbje financiare; nuk ka ndërprerje të funksionimit të sistemit |
| 1 | Ndjeshmëri ulët | Rrezik për qetësinë e jetës; raste të veçanta lëndimesh; humbje të vogla financiare, ndërprerje të vogla të funksionimit të një sistemi të dhënë |
| 2 | Ndjeshmëri mesatare | Rrezik për shëndetin; një numër i konsiderueshëm njerëzish të lënduar, biznesesh, infrastrukturash dhe shërbimesh të ndërprera, problemesh shëndetësore, zhvendosjesh nga shtëpitë; humbje të konsiderueshme financiare, ndërprerje të konsiderueshme të funksionimit të një sistemi të dhënë |
| 3 | Ndjeshmëri lartë | Rrezik për jetën e banorëve; numër i lartë viktimash, ndërprerjesh të funksionimit të veprimtarive, infrastrukturave dhe shërbimeve ekonomike, problemesh shëndetësore, zhvendosjesh nga shtëpitë; humbje të mëdha financiare; parandalimi i funksionimit të një sistemi të dhënë |

Kapaciteti për përshtatje

Tabela 8.4 _ Shkalla e cenueshmërisë

| Shkalla e vlerësimit | Niveli i ndjeshmërisë | Përkufizime |
|----------------------|-----------------------|---|
| 0 | Nuk ka ndjeshmëri | Nuk rrezikohet jeta dhe shëndeti i njeriut; nuk ka viktimë; nuk ka humbje financiare; nuk ka ndërprerje të funksionimit të sistemit |
| 1 | Ndjeshmëri e ulët | Rrezik për qetësinë e jetës; raste të veçanta lëndimesh; humbje të vogla financiare, ndërprerje të vogla të funksionimit të një sistemi të dhënë |
| 2 | Ndjeshmëri mesatare | Rrezik për shëndetin; një numër i konsiderueshëm njerëzish të lënduar, biznesesh, infrastrukturash dhe shërbimesh të ndërprera, problemesh shëndetësore, zhvendosjesh nga shtëpitë; humbje të konsiderueshme financiare, ndërprerje të konsiderueshme të funksionimit të një sistemi të dhënë |

| | | |
|---|--------------------|---|
| 3 | Ndjeshmëri e lartë | Rrezik për jetën e banorëve; numër i lartë viktimash, ndërprerjesh të funksionimit të veprimtarive, infrastrukturave dhe shërbimeve ekonomike, problemesh shëndetësore, zhvendosjesh nga shtëpitë; humbje të mëdha financiare; parandalimi i funksionimit të një sistemi të dhënë |
|---|--------------------|---|

Shtojca IV: Kriteret e pikëzimit të riskut

Tabela 8.5 _ Kriteret e pikëzimit të riskut

| Rezultati numerik | Ndikimi | Pikëzimi i mundësisë |
|-------------------|---|---|
| 1 | <p>Risqet me ndikim të ulët përfshijnë:</p> <p><u>Ndikimin financiar</u> Kostoja e vlerësuar nën 1 milion euro.</p> <p><u>Ndikimin social</u> Është prekur 10% e popullsisë së secilës bashki.</p> <p><u>Ndikimin shëndetësor</u> Ndikimi i ulët nënkupton pak shqetësime për njerëzit. Ndikime të vogla shëndetësore për një pjesë më të vogël të popullsisë.</p> <p><u>Ndikimin mjedisor</u> Vetëm ndikim i ulët mjedisor – nuk ka dëme të konsiderueshme, nuk ka zona ose specie të mbrojtura të prekura dhe nuk ka zona të vogla gjeografike të prekura</p> | <p>Mundësia e ulët i referohet një situatë ku risku nuk ka gjasa të ndodhë për shkak të karakteristikave specifike të secilës bashki.</p> <p>Ose ndryshimi i klimës që mund të shkaktojë riskun është një rast ekstrem dhe që mund të ndodhë vetëm më vonë gjatë shekullit.</p> |
| 2 | <p>Risqet me ndikim mesatar përfshijnë:</p> <p><u>Ndikimin financiar</u> Kostoja e vlerësuar mbi 1 milion euro deri në 10 milion paunde.</p> <p><u>Ndikimin social</u> Është prekur më shumë se 10% dhe më pak se 50% e popullsisë.</p> <p><u>Ndikimin shëndetësor</u> Ndikimi mesatar nënkupton shqetësime më të mëdha për njerëzit. Ndikime të mëdha shëndetësore për një pjesë më të vogël të popullsisë. Ose ndikime të vogla shëndetësore për një pjesë të madhe të popullsisë.</p> <p><u>Ndikimin mjedisor</u> Vetëm ndikim i ulët mjedisor – ka disa dëmtime mjedisore, nuk ka zona ose specie të mbrojtura të prekura, por një zonë gjeografike rajonale ose ndërrajonale të prekura</p> | <p>Mundësi mesatare, ndryshimi klimatik që shkakton riskun ka mundësi të ndodhë sipas RCP 8.5. Ekzistojnë disa cenueshmëri të qenësishme për secilën bashki, të cilat e bëjnë riskun më të mundshëm</p> |
| 3 | <p>Risqet me ndikim të lartë përfshijnë:</p> <p><u>Ndikimin financiar</u> Kostoja e vlerësuar mbi 10 milionë euro.</p> <p><u>Ndikimin social</u> Është prekur 50% ose më shumë e popullsisë.</p> <p><u>Ndikimin shëndetësor</u> Ndikimi i lartë nënkupton shqetësime të mëdha për shumë njerëz. Ndikime të mëdha shëndetësore për një pjesë të konsiderueshme të të prekurve dhe/ose me disa raste vdekjesh.</p> <p><u>Ndikimin mjedisor</u> Ndikim mjedisor në shkallë të gjerë – ka dëme mjedisore të konsiderueshme, ka zona ose specie të mbrojtura të prekura dhe/ose një zonë me shtrirje gjeografike të madhe të prekura.</p> | <p>Mjafton një ndryshim i vogël klimatik që risku të ndodhë. Ose risku tashmë po ndodh dhe do të rritet nga ndryshimet klimatike.</p> |

Burimi:

Autori

Shtojca V: Lista e masave të përshtatjes të propozuara

A.1 Qeverisja, monitorimi dhe vlerësimi

| A.1 Qeverisja, monitorimi dhe vlerësimi | | | |
|---|---|-------------------------------------|-----------------------|
| Për të siguruar ecurinë, integrimin dhe zbatimin e veprimeve vendore për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike në Bashkinë Vlorë. | | | |
| Nr. | Veprimi | Drejtuesi dhe Partneri(ët) | Afati dhe kohor S/M/L |
| 1 | <p>Ngritja e një Ekipi për Veprimin mbi Klimën me përfaqësues nga të gjitha funksionet kryesore të Bashkisë Vlorë, për të mbikëqyrur zbatimin e veprimeve të planit të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Ky ekip do të zbatojë veprime, do të raportojë mbi progresin e strategjisë e do ta shqyrtojë atë dhe do të nxisë novacionin vendor. Kjo gjë synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sigurimin e zbatimit të suksesshëm të këtij Plani Veprimi dhe mbikëqyrjen e integritit të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike në të gjitha planet, programet, strategjitë dhe politikat e Bashkisë Vlorë, përfshirë planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe politikat e menaxhimit të ujit. - Integrimin e veprimit klimatik në Programet e Ofrimit të Shërbimeve të Bashkisë Vlorë dhe sigurimin e konkretizimit të tij në Planet e Zhvillimit të Ekipeve dhe Planet e Zhvillimit Personal, për të mundësuar ndjekjen e veprimeve nga të gjitha njësitë përkatëse të biznesit. - Garantimin që veprimi klimatik u referohet dhe përputhet me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së (SDG), veçanërisht SDG 13: Veprimi Klimatik - Sigurimin që veprimi klimatik të jetë konsideratë kyç në vlerësimin e të gjitha aplikimeve të planifikimit dhe dhënien e udhëzimeve për veprimin klimatik për zhvilluesit në Bashkinë Vlorë. - Koordinimin e hartimit të Planeve të Zbatimit për secilin veprim të identifikuar. - Menaxhimin dhe mbikëqyrjen e integritit efektiv të masave të Përshtatjes në të gjitha planet, projektet, programet, strategjitë dhe politikat e Vlorës. - Krijimin dhe forcimin e partneriteteve dhe promovimin e komunikimit dhe bashkëpunimit ndërdepartamental; - Përpilimin një listë të të gjitha planeve, projekteve, strategjive dhe politikave, përfshirë rishikimin/përditësimin e parashikuar - Ofrimin e një kuadri për projektet e veprimit klimatik, që do të përfshihen në realizimin e shërbimeve të ardhshme - Zhvillimin e treguesve kyç të performancës, që do të përdoren për të gjurmuar dhe monitoruar veprimet dhe për të raportuar mbi progresin e këtij Plani Vendor të Përshtatjes. - Lehtësimin e partneriteteve të mundshme dhe/ose burimeve të financimit për të çuar përpara projektet në të gjithë bashkinë. - Identifikimin, sigurimin dhe shfrytëzimin e burimeve të financimit për zbatimin e veprimeve për ndryshimet klimatike (përfshirë përshtatjen | Ekipi i Menaxhimit i Bashkisë Vlorë | Afatshtkurtër |

A.1 Qeverisja, monitorimi dhe vlerësimi

Për të siguruar ecurinë, integrimin dhe zbatimin e veprimeve vendore për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike në Bashkinë Vlorë.

| Nr. | Veprimi | Drejtuesi dhe Partneri(ët) | Afati dhe kohor S/M/L |
|-----|--|--|------------------------|
| | dhe zbutjen). | | |
| 2 | Përgatitja e një raporti vjetor progresi për Planin e Përshtatjes të Vlorës, që do t'i paraqitet bashkisë së bashku me projektbuxhetin. | | Afatshkurtër |
| 3 | Garantimi që nëpërmjet ofrimit të të gjitha shërbimeve, funksioneve dhe aktiviteteve të ketë zbatim më efektiv të rregulloreve, politikave, planeve dhe strategjive përkatëse, që luajnë rol në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit | Ekipi i Menaxhimit dhe Përgjegjësit e Sektorëve | Afatshkurtër |
| 4 | Krijimi dhe prezantimi i një programi trajnimi për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke siguruar se të gjithë anëtarët e stafit bashkiak janë të informuar për rolin e tyre për realizimin i veprimeve për ndryshimet klimatike. Ky program përfshin: <ul style="list-style-type: none"> - Ndërgjegjësimin për parashikimet e ndryshimeve klimatike dhe ndërlikimet e ndryshimeve klimatike në Vlorë. - Krijimin e ekspertizës, kapaciteteve dhe rritjen e bazës së njohurive nëpërmjet programeve përkatëse të trajnimit për Ndryshimet Klimatike dhe ndërlikimet e tij te operacionet/funksionet e Bashkisë Vlorë. - Identifikimin dhe trajtimin e mungesës së njohurive në menaxhimin e riskut për përmbajtje dhe vlerësimet e riskut për përmbajtje. - Edukimin e stafit mbi ndërlikimet e ndryshimeve klimatike dhe si të trajtohen në mënyrë efektive efektet e ndryshimeve klimatike në operacionet dhe shërbimet e bashkisë dhe se si të ndërtohen kapacitetet në Bashkinë Vlorë dhe ato të partnerëve përkatës. | | Afatshkurtër-afatmesëm |
| 5 | Emërimi i një punonjësi të posaçëm për Veprim Klimatik që mbështet zbatimin në nivel vendor të politikës së ndryshimeve klimatike, duke identifikuar se si mund të respektohen prioritetet vendore në përputhje me objektivat e ndryshimeve klimatike, për të siguruar reduktimin e të gjitha formave të pabarazisë klimatike | Ekipi i Menaxhimit dhe Burimet Njerëzore të Bashkisë Vlorë | Mesatar |
| 6 | Rishikimi dhe përditësimi i deklaratave të Shëndetit dhe Sigurisë dhe i Vlerësimeve të Riskut për të marrë parasysh ndryshimet klimatike, shpeshësinë dhe ashpërsinë e ngjarjeve klimatike: <ul style="list-style-type: none"> - Sigurimi se deklaratat dhe vlerësimet e riskut janë plotësuar për pozicionet e punës në secilën zonë operative, duke marrë parasysh risqet e mundshme ndaj punës nga ngjarjet atmosferike ekstreme. - Rishikimi i planeve operacionale dhe sinjalizimeve për punëtorët që punojnë në ambiente të jashtme dhe të brendshme kur ndodhin ngjarje klimatike. - Hartimi i një protokollit komunikimi të brendshëm për ngjarjet atmosferike ekstreme për të shmangur paqartësitë dhe për të shtuar stafin. | | Mesatar |

A.1 Qeverisja, monitorimi dhe vlerësimi

Për të siguruar ecurinë, integrimin dhe zbatimin e veprimeve vendore për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike në Bashkinë Vlorë.

| Nr. | Veprimi | Drejtuesi dhe Partneri(ët) | Afati S/M/L kohor |
|-----|--|---|---------------------------------------|
| 7 | <p>Zbatimi i veprimeve dhe masave për përshtatje në të gjithë Bashkinë Vlorë, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbështetja e Grupit Drejtues për mbikëqyrjen e integritetit efektiv të masave të Përshtatjes në të gjitha planet, programet, strategjitë dhe politikat e Bashkisë Vlorë. - Identifikimi dhe sigurimi i burimeve të financimit për masat - Mbështetja dhe plotësimi i zbatimit në praktikë të veprimeve, të identifikuar nga Shqipëria në nivel kombëtar. | Ekipi i Menaxhimit i Bashkisë Vlorë, Shërbimet Mjedisore. | Mesatar |
| 8 | <p>Promovimi i prokurimeve të gjelbra për mallrat, shërbimet dhe punimet, për të mbështetur objektivat mjedisore dhe objektivat më të gjera të zhvillimit të qëndrueshëm, të cilat ndihmojnë në balancimin e efektivitetit të kostove dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke përfaqësuar vlerën afatshkurtër dhe afatgjatë të parasë.</p> | Përgjegjësit për Prokurimet | Afatshkurtër-afatgjatë (e në vazhdim) |
| 9 | <p>Lidhja, bashkëpunimi dhe puna në partneritet me komunitetet vendore dhe me sektorët e identifikuar të PKP-së, që janë subjekt i financimit, për realizimin e veprimeve sektoriale për përshtatje.</p> | Përgjegjësit e seksioneve | Afatmesëm-afatgjatë |
| 10 | <p>Krijimi i një sistemi të centralizuar raportimi për të gjitha informacionet që lidhen me ngjarje atmosferike ekstreme. Informacioni i dhënë në këtë sistem arkivimi mund të përfshijë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përshkrimin e ndikimeve në ofrimin e shërbimit - Raportet e incidenteve të mbështetura me prova fotografike dhe detaje të vendndodhjes. - Vlerësimet e kostove të shkaktuara nga riparimet. - Detajet e burimeve të mobilizuara gjatë dhe pas ngjarjes. - Detajet e çdo financimi të departamentit të marrë dhe të kompensuar për punime riparimi ose parandaluese. - Krijimin e një mekanizmi monitorimi dhe raportimi për Emetimet e Gazeve me Efekt Serrë në nivel bashkiak, për të mundësuar çështje konkrete të mbështetjes/kontributeve institucionale. | Departamenti i Emergjencave Civile | Afatshkurtër-afatmesëm |
| 11 | <p>Mbështetja e politikave të Menaxhimit të Mbetjeve për reduktimin e mbetjeve dhe e nismave të tjera që nxisin kalimin në ekonominë qarkulluese.</p> | | Afatshkurtër-afatmesëm |
| 12 | <p>Shqyrtimi i mënyrave për të reduktuar/shmangur udhëtimet e panevojshme të personelit dhe promovimi i nismave për të nxitur forma më të</p> | | |

| A.1 Qeverisja, monitorimi dhe vlerësimi | | | |
|---|---|----------------------------|-------------------|
| Për të siguruar ecurinë, integrimin dhe zbatimin e veprimeve vendore për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike në Bashkinë Vlorë. | | | |
| Nr. | Veprimi | Drejtuesi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
| | qëndrueshme transporti për të gjithë stafin e Bashkisë Vlorë. | | |

A.2 Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar nga njeriu

| A.2 Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar nga njeriu | | | |
|--|---|--|-------------------|
| Për t'u përgjigjur në mënyrë efektive ndaj ngjarjeve atmosferike të rënda përmes rritjes së kapaciteteve dhe të qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike në Bashkinë Vlorë | | | |
| Nr. | Veprimi | Drejtuesi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
| 1 | <p>Rishikimi i studimeve të mëparshme lidhur me cenueshmëritë klimatike dhe hartëzimin e përshtatjes në të gjitha bashkitë për të krijuar një hartë Cenueshmërie Klimatike për Bashkinë Vlorë, duke përdorur informacionin lidhur me risqet nga përmbytjet, valët e të nxehtit, thatësisrat dhe të ftohtit, përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identifikimin e zonave prioritare për sektorin vullnetar, komunitar dhe të ndërmarrjes sociale dhe mbështetjen e çdo mase të kërkuar përshtatjeje dhe qëndrueshmërie. - Përpilimin e një inventari të aseteve dhe shërbimeve të cenueshme - Identifikimin e zonave të prekshme nga izolimi si pasojë e përmbytjeve dhe caktimi i masave për ta trajtuar këtë çështje. Përdorimin e hartave të përmbytjeve për skenarë të së ardhshmes për të identifikuar komunitetet dhe asetet që mund të jenë të cenueshme. | <p>Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike;</p> <p>Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit</p> | Afatshkurtër |
| 2 | <p>Identifikimi i zonave dhe komuniteteve të izoluar si pasojë e përmbytjeve dhe ndërmarrja e masave për të reduktuar riskun, për t'u përgjigjur me gatishmëri dhe për të rritur ndërgjegjësimin dhe qëndrueshmërinë vendore ndaj ndikimeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vijimi i qasjes së bazuar te risku i minimizuar për zhvillime në zonat në risk për përmbytje (bregdetare, baticore, lumore, nga shiu dhe ujërat nëntokësore) - Shqyrtimi i hartave aktuale të përmbytjeve të zonave të cenueshme nga përmbytjet dhe identifikimi i niveleve të përmbytjeve për një sërë skenarësh të ardhshëm - Analizimi i informacionit nga ngjarjet e kaluara dhe ndikimet e përmbytjeve për ngjarjet e ardhshme - Shqyrtimi i vazhdueshëm i të dhënave të riskut nga përmbytjet dhe marrja në konsideratë nga këshilli bashkiak e rritjes së përmasave dhe | <p>Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve</p> <p>Bordi i Ujitjes dhe Kullimit</p> | Afatshkurtër |

A.2 Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar nga njeriu

Për t'u përgjigjur në mënyrë efektive ndaj ngjarjeve atmosferike të rënda përmes rritjes së kapaciteteve dhe të qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike në Bashkinë Vlorë

| Nr. | Veprimi | Drejtuuesi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
|-----|---|---|------------------------|
| | thellësisë së përmbytyjeve në projektimin, planifikimin dhe ndërtimin/realizimin e infrastrukturës së re, për të shmangur zonat e mundshme/të ardhshme të prira për t'u prekur nga përmbytjet dhe për të siguruar që infrastruktura e re të jetë e qëndrueshme ndaj risqeve të ndryshimeve klimatike | | |
| 3 | <p>Krijimi dhe zbatimi i një fushate ndërgjegjësimiti për rolin e mjedisit natyror dhe kontributin e tij pozitiv në Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike duke reduktuar efektet e ngjarjeve atmosferike ekstreme (ndikimi i shiut të dendur dhe përmbytjeve të shkaktuara nga ruajtja natyrore e ujit, reduktimi i efektit të të nxehtit nëpërmjet mbjelljes së pemëve, etj.) përmes veprimeve të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e strategjisë për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut rreth rolit të Bashkisë Vlorë në përgjigjen ndaj emergjencave klimatike. - Nxitja për përdorimin e tabelave informuese në zonat atraktive, turistike, të botës së egër, me peizazh natyror, të trashëgimisë kulturore dhe zonat e tjera të përshtatshme të bashkisë, për të nxitur dhe për të rritur ndërgjegjësimin lidhur me respektimin e mjedisit natyror dhe rolin e tij në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. - Ndërgjegjësimi nëpërmjet Turizmit, Trashëgimisë dhe çdo Programi Artistik për ndryshimet klimatike, si dhe për rëndësinë dhe potencialin e zgjidhjeve të gjelbra në trajtimin e ndryshimeve klimatike. Duhet të krijohen sisteme komunikimi për të paralajmëruar publikun për çdo ndikim të ofrimi i shërbimit në rast prekjeje nga ngjarjet atmosferike ekstreme - Përdorimi i projekteve edukative në shkolla ose në komunitet si mundësi për të shpërndarë informacion për ndryshimet klimatike te publiku. | Drejtorja e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun | Mesatar |
| 4 | <p>Rishikimi i Planeve të Vlorës për Përgjigje ndaj Emergjencave, përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rishikimin dhe përditësimin i Planeve të Përgjigjes ndaj Emergjencave për të marrë parasysh ndryshimet klimatike, shpeshësinë dhe ashpërsinë e ngjarjeve klimatike. - Sigurimin që Planet e Përgjigjes ndaj Emergjencave të rishikohen çdo vit për të pasqyruar seriozitetin në rritje të ngjarjeve klimatike, mësimet e nxjerra nga ngjarjet e së kaluarës dhe praktikatat më të mira. - Përpjekjen për të siguruar që komunikimi, sinjalizimet dhe sistemet rezervë të reaguesve ndaj emergjencave janë të përshtatshme për mbajtjen e komunikimeve gjatë ngjarjeve ekstreme. - Sigurimin që shërbimet e urgjencës të kenë akses në ujë gjatë ngjarjeve atmosferike ekstreme (borë, ngrica, akull dhe thatësi). - Identifikimin e mësimet të nxjerra, rasteve studimore dhe programeve të trajnimit për të kuptuar dhe për t'u aftësuar mbi menaxhimin e Përgjigjes ndaj Emergjencave përballë risqeve dhe cenueshmërive në rritje nga ndryshimet klimatike. - Zhvillimin e një sistemi për të dokumentuar, monitoruar dhe analizuar të dhënat mbi ndikimin e ngjarjeve atmosferike ekstreme në Bashkinë Vlorë. Në këtë mënyrë do të identifikohen veprimet e nevojshme për t'u përshtatur shpejt dhe në mënyrë efektive ndaj ngjarjeve atmosferike ekstreme dhe për të rikthyer në punë shërbimet publike | <p>Drejtorja e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike</p> <p>Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit</p> | Afatshkurtër-afatgjatë |

A.2 Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar nga njeriu

Për t'u përgjigjur në mënyrë efektive ndaj ngjarjeve atmosferike të rënda përmes rritjes së kapaciteteve dhe të qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike në Bashkinë Vlorë

| Nr. | Veprimi | Drejtesi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
|-----|--|--|------------------------|
| | <ul style="list-style-type: none"> - Krijimin e programeve të komunitetit për qëndrueshmëri, për t'u siguruar se komunitetet vendase do të jenë më të përgatitura për ngjarjet atmosferike ekstreme më të shpeshta dhe më intensive (përmytje, valë të nxehti, stuhi) dhe se mund të përgjigjen dhe rimëkëmben në mënyrë më efektive. | | |
| 5 | <p>Sigurimi që vlerësimet rutinë të ndikimit në shëndet të përfshijnë konsideratat e ndikimeve nga ndryshimet klimatike, veçanërisht nga moti ekstrem, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ofrimi i mbështetjes për reduktimin e rrëshqitjeve, pengimeve dhe rrëzimeve gjatë motit ekstrem nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të një Strategjie Parandaluese që synon të moshuarit dhe qytetarët e cenusshëm | Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve | Afatshkurtër-afatmesëm |
| 6 | <p>Hartimi i planeve të komunikimit në fusha të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rritja e ndërgjegjësimit të pronarëve të shtëpive private për ndikimet e mundshme të ngjarjeve të ndryshimeve klimatike në strehim dhe për mënyrën se si të kujdesen më së miri për shtëpinë e tyre, me qëllim shmangien ose pakësimin e ndikimeve. - Informimi i banorëve se si mund të reduktojnë përdorimin e ujit, duke ndihmuar në kursimin e ujit. - Informimi i Bashkisë Vlorë duke përdorur parashikimet e sakta të motit, duke dhënë alarme, sinjale të paralajmërimit të hershëm, këshilla dhe mbështetje përpara ngjarjeve atmosferike ekstreme. - Promovimi nëpër shkolla i përshtatjes dhe qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike dhe promovimi i fizibilitetit të zgjidhjeve të bazuara te natyra, për të trajtuar ndryshimet klimatike dhe për të përmirësuar biodiversitetin. - Krijimi dhe zbatimi i një fushate komunikimi, e cila detajon ndikimet që mund të kenë ndryshimet klimatike në shëndet dhe mirëqenie. - Hartimi i këshillave dhe udhëzimeve se çfarë duhet bërë nëse banorët preken nga ngjarjet atmosferike ekstreme (p.sh., përmytje, valë të të nxehtit etj.), duke u dhënë përparësi komuniteteve të cenusshme, në mënyrë që të mund të përgjigjen më shpejt në rast të motit ekstrem. - Vlerësimi i zonave, që mund të jenë më të prira ndaj zjarreve në pyje dhe vendosja e sinjalistikës dhe udhëzimeve në këto zona për t'i nxitur përdoruesit që të mos e përkeqësojnë riskun, për shembull, duke ndezur skarën ose zjarre në kamping. | Drejtoria e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun | Afatshkurtër-afatmesëm |
| 7 | <p>Hartimi dhe zbatimi i një programi për të rritur kapacitetin e qytetarëve, bizneseve dhe komuniteteve për t'u përgjigjur dhe për t'u rimëkëmbur nga ngjarjet atmosferike ekstreme, me synime specifike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dhënie e këshillave mbi riskun për ngjarje ekstreme që prekin zonën e tyre; - Hartimin e veprimeve për përshtatje për të përmirësuar përgatitjen dhe për të reduktuar varësinë nga përgjigja emergjente e autoriteteve vendore; | Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike; Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit | |

A.2 Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar nga njeriu

Për t'u përgjigjur në mënyrë efektive ndaj ngjarjeve atmosferike të rënda përmes rritjes së kapaciteteve dhe të qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike në Bashkinë Vlorë

| Nr. | Veprimi | Drejtuuesi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
|-----|--|---|------------------------|
| | <ul style="list-style-type: none"> - Ofrimin e mbështetjes për të ndërmarrë rregullime të përshtatshme për qëndrueshmërinë për të mundësuar përgjigjen dhe rimëkëmbjen - Integrimin e konsideratave kryesore për barazinë dhe drejtësinë klimatike. | | |
| 8 | <p>Hartimi dhe zbatimi i një plani ndryshimi të sjelljes për qytetarët, bizneset dhe komunitetet për të ndryshuar sjelljet, për të kuptuar dhe për të trajtuar më mirë ndryshimet klimatike dhe ngjarjet atmosferike ekstreme.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sigurimi i përfitimeve (mundësive) të përbashkëta të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike për mjedisin përmes uljes së emetimeve të gazeve me efekt serrë ose reduktimit të presioneve mbi burimet dhe promovimit të përfitimeve për komunitetet. | Drejtorja e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun | |
| 9 | Zhvillimi i trajnimeve për stafin e bashkisë për të ofruar mbështetje dhe asistencë lidhur me shërbimet thelbësore për banesat dhe komunitetet e cenushme në të gjithë Bashkinë Vlorë, duke krijuar ekspertiza, kapacitete dhe duke zgjeruar bazën e njohurive të komunitetit nëpërmjet programeve të synuara dhe përkatëse të trajnimit përkrahje Ndryshimet Klimatike dhe ndikimet e tyre. | Drejtorja e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun | Afatshkurtër |
| 10 | <p>Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave lidhur me ndikimet e ngjarjeve klimatike ekstreme, përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hulumtimin, grumbullimin dhe dokumentimin e ndikimeve të ngjarjeve klimatike ekstreme në Vlorë. - Evidentimin e ndikimeve të ngjarjeve klimatike në ndërtesa dhe infrastrukturë kritike përmes hartëzimit në GIS, për të ndihmuar në identifikimin e rreziqeve dhe zonave të cenushme, për të mundësuar planifikimin për përshtatje në të ardhmen. - Krijimin e një sistemi raportimi dhe shkëmbimi informacioni, që bën të mundur vlerësimin e ndikimeve të plota të ndryshimeve klimatike dhe mbështet vlerësimin e drejtë ekonomik të projekteve për përshtatje në të ardhmen. - Vazhdimin e aktivizimit të Protokollit të Emergjencave për Kushte Atmosferike të rënda gjatë periudhave të motit ekstrem, duke siguruar aksesin në strehim të personave të pastrehë. - Vazhdimin e monitorimit të cilësisë së ajrit duke siguruar që është në nivel të sigurt gjatë periudhave me temperatura të larta. | Drejtorja e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike | Afatshkurtër-afatgjatë |
| 11 | Shfrytëzimi i verës më të gjatë dhe më të thatë duke inkurajuar zgjedhje të një mënyre jetese fleksibel për përmirësimin e shëndetit dhe të mirëqenies. Përfshirja e ndryshimeve në regjimin e punës, promovimi i përdorimit të hapësirave të jashtme ose inkurajimi i shfrytëzimit të kohës së lirë në ambiente të jashtme për t'i dhënë shtysë turizmit vendor dhe mundësive ekonomike. | Drejtorja e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun | Afatshkurtër |
| 12 | <p>Prioritizimi i masave për përshtatje, si përmirësimi i sistemit të kullimit, integrimi i infrastrukturës së gjelbër dhe vendet për freskim si: burime uji dhe stola me hije në rrugët më të frekuentuara për ecje dhe ciklizëm në të gjithë Bashkinë Vlorë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Marrja në konsideratë dhe shqyrtimi i përdorimit të masave ruajtje natyrore të ujit në zona të caktuara të përshtatshme si një metodë | Bordi i Ujitjes dhe Kullimit | Mesatar |

A.2 Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar nga njeriu

Për t'u përgjigjur në mënyrë efektive ndaj ngjarjeve atmosferike të rënda përmes rritjes së kapaciteteve dhe të qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike në Bashkinë Vlorë

| Nr. | Veprimi | Drejtuuesi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
|-----|--|---|-------------------------------|
| | <p>për menaxhimin e riskut për përmbytje, përmirësimin e cilësisë së ujit, përmirësimin e biodiversitetit, menaxhimin e tokës dhe sedimenteve dhe krijimin e zonave atraktive të reja ose shtesë.</p> <p>- Marrja në konsideratë e zëvendësimit/riparimit për të kapërcyer tharjen e puseve/lumenjve nga thatësira.</p> | | |
| 13 | <p>Eksplorimi i mënyrave se si Bashkia Vlorë mund të ndihmojë grupet e cënueshme (p.sh., gratë kryefamiljare, etj.) dhe njerëzit e izoluar (të moshuarit) dhe komunitetet që të jenë më të qëndrueshme ndaj klimës.</p> | <p>Drejtorja e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun</p> | <p>Afatshkurtër-afatmesëm</p> |
| 14 | <p>Nxitja e të gjitha grupeve të komunitetit për të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Marrë parasysh përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në planet dhe programet e tyre shumëvjeçare. - Promovuar çiklizmin dhe ecjen aktive në qytetin e Vlorës, duke reduktuar kështu emetimet e karbonit dhe duke përmirësuar cilësinë e ajrit. - Nxitur heqjen dorë nga përdorimi i makinave private përmes politikës së planifikimit të përdorimit të tokës, menaxhimit të zhvillimit dhe nismave dhe promovimeve vendore - Ndjekur në mënyrë aktive projektet për reduktimin e konsumit të energjisë dhe për pakësimin e sasisë së karbonit. - Mbështetur identifikimin e atyre që janë më të rrezikuar nga skenarët e përcaktuar dhe për të dhënë përgjigje proaktive sipas rastit. | <p>Drejtorja e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun</p> <p>Drejtorja e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve</p> | <p>Mesatar</p> |
| 15 | <p>Bashkëpunimi me organizatat përkatëse qeveritare, agjencitë dhe palët e interesit për të rritur ndërgjegjësimin për ndikimet e ndryshimeve klimatike te përmbytjet dhe te cilësia e ujit, dhe të punuarit me këto palë të interesuara për krijimin dhe zbatimin e masave të përshtatjes.</p> | | <p>Afatshkurtër-afatgjatë</p> |
| 16 | <p>Promovimi i zhvillimit që nxit përdorimin e energjisë elektrike të pastër, që minimizon konsumin e lëndëve djegëse fosile në Vlorë, përfshirë ndërmarrjen e veprimeve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Angazhimi me ofruesit e energjisë dhe shërbimeve për të siguruar se infrastruktura dhe shërbimet e energjisë janë të qëndrueshme ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike - Marrja në konsideratë, gjatë planifikimit të ndërtesave, e masave për izolim ndaj nxehtësisë, si përdorimi i fasadave të bardha, grilave, tarracave të gjelbra, dhe teknologjive efikase të ftohjes. Futja e një sistemi raportimi dhe monitorimi për izolimin e ndërtesave, për të siguruar ndërtesa të qëndrueshme ndaj nxehtësisë. - Sigurimi se programet e rinovimit të banesave, që kërkohen krahas realizimit të objektivave të eficiencës së energjisë, përfshijnë masat e përshtatjes aty ku është e mundur, të tilla si masat për eficiencën e ujit, opsionet e hijezimit, ajrimi më i mirë për reduktimin e riskut të | <p>Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit</p> <p>Drejtorja e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike</p> | <p>Afatgjatë</p> |

A.2 Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar nga njeriu

Për t'u përgjigjur në mënyrë efektive ndaj ngjarjeve atmosferike të rënda përmes rritjes së kapaciteteve dhe të qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike në Bashkinë Vlorë

| Nr. | Veprimi | Drejtesi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
|-----|--|---|------------------------|
| | <p>mbinxehjes dhe për përmirësimin e cilësisë së ajrit në ambientet e brendshme, etj. Këtu mund të përfshihen ajrimi natyror për të përmirësuar performancën termike dhe për të garantuar rehati gjatë valëve të të nxehtit, gjelbërimi natyror, shtresat reflektuese për soleta, trotualet e depërtueshëm nga uji dhe grumbullimi i ujërave të shiut për të reduktuar përdorimin e ujërave të ëmbla.</p> <p>- Termoizolimi i të gjitha objekteve publike, veçanërisht shkollave, kopshteve dhe çerdheve</p> | | |
| 17 | Marrja parasysh se si temperaturat e larta dhe valët e të nxehtit mund të shtojnë shqetësimet për shëndetin publik dhe garantimi që kjo gjë të merret në konsideratë gjatë alokimit të burimeve. | Drejtorja e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun | Mesatar |
| 18 | Hartimi dhe zbatimi i vlerësimit të riskut dhe planit korrigjues për stokun e identifikuar të banesave për Vlorën dhe integrimi i tyre në proceset vendimmarrëse për programimin, projektimin, planifikimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore. Vlerësimi i riskut duhet të përfshijë: <ul style="list-style-type: none"> - mbledhjen dhe krahasimin e të dhënave historike mbi ngjarjet e motit për rajonin e Bashkisë Vlorë; - mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave ndërkombëtare dhe kombëtare mbi regjimet e parashikuara klimatike dhe risqet e mundshme për Vlorën | Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik | Mesatar |
| 19 | Identifikimi i masave për rritjen e qëndrueshmërisë së ndërtesave të trashëgimisë/historike, në pronësi dhe në operim të Bashkisë Vlorë, ndaj ngjarjeve atmosferike ekstreme. | Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik | Afatshkurtër-afatmesëm |
| 20 | <p>Organizimi i një fushate informuese për efektet e rrezatimit në prodhimet bujqësore. Përdorimi i mediave sociale dhe kanaleve të tjera të komunikimit për të angazhuar palët e interesit.</p> <p>Hartimi dhe zbatimi i një plani gjithëpërfshirës komunikimi për të siguruar shpërndarje efektive të informacionit në lidhje me masat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në bujqësi dhe pylltari.</p> <p>Ofrimi i kurseve të trajnimit dhe ndërgjegjësimin për fermerët dhe pylltarët mbi zbatimin e praktikave inteligjente ndaj klimës, që kontribuojnë në reduktimin e emetimeve.</p> <p>Identifikimi i varieteteve të kulturave bujqësore rezistente ndaj klimës, të përshtatshme për kushtet klimatike në ndryshim të Vlorës.</p> <p>Vlerësimi, identifikimi dhe zbatimi i veprimeve pilot për të testuar teknologjitë dhe praktikat novatore për bujqësinë e qëndrueshme ndaj</p> | <p>Drejtorja e Bujqësisë dhe Mjedisit.</p> <p>Drejtorja e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun</p> | |

A.2 Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar nga njeriu

Për t'u përgjigjur në mënyrë efektive ndaj ngjarjeve atmosferike të rënda përmes rritjes së kapaciteteve dhe të qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike në Bashkinë Vlorë

| Nr. | Veprimi | Drejtuesi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
|-----|--|---|---------------------|
| | <p>ndryshimeve klimatike, duke përfshirë metoda novatore për mbrojtjen e vreshtave nga rrezatimi diellor, si përdorimi i mbulesave mbrojtëse për të reduktuar ekspozimin e drejtpërdrejtë të bimëve ndaj rrezatimit.</p> <p>Angazhimi i palëve vendore të interesit për të mbledhur të dhëna mbi praktikat aktuale të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike që përdoren nga fermerët dhe pylltarët.</p> | | |
| 21 | <p>Përgatitja dhe rishikimi i planeve të lëvizshmërisë urbane të qëndrueshme për Vlorën. Angazhimi i palëve të interesit nga bashkia, operatorët e transportit dhe organizatat e komunitetit për hartimin e një Plani të Lëvizshmërisë Urbane të Qëndrueshme (PLUQ).</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kryerja e vlerësimeve gjithëpërfshirëse të modeleve aktuale të transportit, infrastrukturës dhe ndikimeve mjedisore mbi bazën e të cilave do të hartohet PLUQ-i. - Identifikimi i projekteve dhe investimeve prioritare për të mbështetur menaxhimin e trafikut dhe mënyrat e qëndrueshme të transportit, përfshirë ecjen, çiklizmin dhe transportin publik. - Sigurimi i aksesueshmërisë së informacionit për transportin publik, nëpërmjet krijimit të një aplikacioni në celular ose faqeje interneti të lehta për t'u përdorur, që ofrojnë informacion në kohë reale mbi oraret, itineraret dhe disponueshmërinë e transportit publik; Vendorsja e sinjalistikës digjitale në stacionet e autobusëve për të shfaqur kohën e mbërritjes dhe informacionin mbi itinerarin; Zbatimi i një sistemi të centralizuar për menaxhimin dhe përditësimin e orareve dhe itinerareve të transportit publik për të përmirësuar efikasitetin dhe besueshmërinë. - Përmirësimi i Shërbimeve të Transportit Publik nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës, shpeshtësisë dhe mbulimit të rrugëve të transportit publik (përfshirë atë ndërqytetas) për të inkurajuar më shumë njerëz të përdorin transportin publik. | <p>Drejtorja e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike; Drejtorja e Planifikimit Urban, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit</p> <p>Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.</p> <p>Drejtorja e Bujqësisë dhe Mjedisit.</p> | Afatmesëm-afatgjatë |

A.3 Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar

A.3 Infrastruktura

Për të rritur qëndrueshmërinë e aseteve infrastrukturore në Bashkinë Vlorë

| Nr. | Veprimi | Drejtuesi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
|-----|---------|----------------------------|-------------------|
|-----|---------|----------------------------|-------------------|

A.3 Infrastruktura

Për të rritur qëndrueshmërinë e aseteve infrastrukturore në Bashkinë Vlorë

| Nr. | Veprimi | Drejtori dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
|-----|--|--|-------------------------------|
| 1 | <p>Përfshirja e konsideratave klimatike në projektimin, planifikimin dhe ndërtimin e të gjitha projekteve infrastrukturore të ndërmarra nga Bashkia Vlorë, për të reduktuar cenueshmërinë e Bashkisë Vlorë nga ndikimet e ndryshimeve klimatike. Veprimet e mundshme përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Promovimin e projektimit dhe ndërtimit cilësor me aftësi ripërtëritëse dhe qëndrueshmëri ndaj ndryshimeve klimatike. - Përfshirjen e rolit të mjedisit natyror për promovimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike përmes promovimit të infrastrukturës së gjelbër, të tilla si tarracat dhe muret e gjelbra në vende të përshtatshme. - Promovimin e projektimit dhe ndërtimit të zhvillimeve të reja për të krijuar lagje me karbon të ulët dhe me mundësi për shëtitje, si dhe hapësira pune me infrastrukturë të gjelbër dhe blu të cilësisë së lartë. - Rishikimin e kërkesave të projektimit për sisteme kullimi urbane të qëndrueshme në kuadër të planifikimit të Vlorës - Zbatimin e Udhëzuesit të Planifikimit për Përmbytjet dhe praktikave më të mira për zvogëlimin e riskut të zhvillimeve të reja nga përmbytjet bregdetare, lumore, përmbytjet nga reshjet ose ujërat nëntokësore. - Mbrojtjen e ambienteve të hapura, me infrastrukturë shumëfunktionale të gjelbër dhe blu, me lidhje me rrjetin më të gjerë të ambienteve të hapura dhe habitateve. | <p>Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik</p> <p>Drejtorja e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban</p> | <p>Afatshkurtër-afatgjatë</p> |
| 2 | <p>Krijimi i një sistemi për të dokumentuar, monitoruar dhe analizuar infrastrukturën rrugore dhe të transportit, të cenueshme nga ndikimet e ndryshimeve klimatike/ngjarjeve atmosferike ekstreme, përfshirë rrugët, urat, hapësirat për ecje dhe çiklizëm, linjat hekurudhore dhe të autobusëve, përmes veprimeve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shqyrtimit të informacionit të disponueshëm për ngjarjet e së kaluarës dhe sistemeve ekzistuese të menaxhimit të aseteve - Përpilimit të një inventari për infrastrukturën e cenueshme për të ndihmuar me prioritizimin e punëve dhe për të hartuar planet e prioritizimit të rrugëve - Përcaktimit të një procedure për vlerësimet e integritetit strukturor të infrastrukturës pas ngjarjeve atmosferike ekstreme - Komunikimit me palët e jashtme të interesit për asetet, që kërkohen gjatë një ngjarjeje atmosferike ekstreme, si borëpastruese, zhavorr dhe kripë, sinjalistikë dhe ndriçim i lëvizshëm për emergjenca, gjeneratorë rezervë të energjisë elektrike, barriera të lëvizshme për përmbytjen, pompa, etj. - Hartimit të një plani transporti për një ngjarje atmosferike të rëndë dhe shpërndarjes së tij te palët e jashtme përkatëse të interesit | <p>Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik;</p> <p>Drejtorja e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban</p> | |
| 3 | <p>Krijimi i një Regjistri Risku dhe Mundësish dhe i një kuadri menaxhues për të gjitha infrastrukturën dhe ndërtesat kritike në pronësi të Bashkisë Vlorë, përfshirë rrugët, ndërtesat, infrastrukturën e TI-së, pajisjet kritike, mbetjet, përmes nismave si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndërmarrja e Vlerësimit të Riskut të infrastrukturës ekzistuese rrugore/të transportit te zonat e cenueshme për të identifikuar seriozitetin e risqeve të ndryshimeve klimatike për funksionimin dhe gjendjen e tyre. | <p>Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik</p> | <p>Afatmesëm -afatgjatë</p> |

A.3 Infrastruktura

Për të rritur qëndrueshmërinë e aseteve infrastrukturore në Bashkinë Vlorë

| Nr. | Veprimi | Drejtuesi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
|-----|--|---|----------------------------|
| | <ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i një regjistri, që përfshin shpeshhtësinë dhe ndikimet e mundshme të ndryshimeve klimatike në infrastrukturën kritike. - Zbatimi i një plani monitorimi për të inspektuar integritetin e infrastrukturës ekzistuese. - Përfshirja e konsideratave klimatike në projektimin, planifikimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha rrugëve, trotuareve, urave dhe projekteve të tjera ndërtimore - Hartimi i udhëzuesit të projektimit për projektet e mëdha të investimeve kapitale, që përcaktojnë mënyrën e përdorimit të parashikimeve klimatike specifike rajonale dhe të opsioneve të përshtatjes. - Identifikimi i planeve rezervë dhe të emergjencës për ngjarjet klimatike, që mund të ndikojnë te infrastruktura kritike. - Vazhdimi i zhvillimit të bazës së të dhënave për hartëzimin e riskut, pasi zonat e njohura për përmbytje po zgjerohen gjithnjë e më shumë në të gjithë Bashkinë Vlorë. - Hartimi i Regjistrit të Infrastrukturës së Mbrojtjes nga Përmbytjet dhe Planet e Menaxhimit. | | |
| 4 | <p>Krijimi i Regjistrit për Riskun dhe Mundësitë për mbrojtjen e infrastrukturës nga përmbytjet.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kryerja e Vlerësimeve të Riskut për Përmbytje, specifike për zonën, për infrastrukturën dhe ndërtesat e reja, që shërbejnë për të hartuar vendimet e planifikimit dhe kërkesat e duhura të përshtatjes, duke siguruar që në zhvillimet e reja për sistemet e kullimit të ujërave të shiut të merren parasysh ndikimet e mundshme të ardhshme të ndryshimeve klimatike në projektimet e tyre, përfshirë përdorimin e sistemeve të qëndrueshme të kullimit urban. - Hartimi i Planeve për Menaxhimin e Ujërave Sipërfaqësore, në mënyrë që të menaxhohen risqet për përmbytje nga ujërat sipërfaqësore në zonat e identifikuar. - Identifikimi dhe hartimi i një regjistri për infrastrukturën ekzistuese fizike dhe jo fizike të mbrojtjes nga përmbytjet në Vlorë. - Rishikimi i qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike dhe vlerësimi i riskut, duke marrë parasysh gjendjen e infrastrukturës së mbrojtjes nga përmbytjet, kapacitetin e projektimit dhe cënueshmërinë e receptorëve nëse infrastruktura dështon. - Krijimi dhe zbatimi i protokolleve për vlerësimet e integritetit strukturor të infrastrukturës së mbrojtjes nga përmbytjet pas ngjarjeve ekstreme. - Krijimi i një programi mirëmbajtjeje për ruajtjen e integritetit të infrastrukturës. - Identifikimi i zhvillimeve te zonat prioritare të riskut për përmbytje dhe pikat e nxehta në të gjithë bashkinë dhe testimi i përdorimit të teknologjisë së sensorëve në distancë për vlerësimin e zonave të njohura për përmbytje në të gjithë rrejetin e autostradave dhe në bashki, për të ndërmarrë veprime përpara ngjarjeve të rënda të reshjeve të shiut. - Hartimi i planeve të rrugëve alternative në rast përmbytjeje për të minimizuar ndërprerjen e shërbimeve. - Priorizimi i projekteve për reduktimin e riskut për përmbytje dhe sigurimi i hartëzimit të detajuar të zonave të prira ndaj riskut për | <p>Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik</p> <p>Drejtorja e Planifikimit Urban</p> | <p>Afatmesëm-afatgjatë</p> |

A.3 Infrastruktura

Për të rritur qëndrueshmërinë e aseteve infrastrukturore në Bashkinë Vlorë

| Nr. | Veprimi | Drejtuesi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
|-----|---|---|---------------------|
| | <p>përmbytje nga ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi dhe forcimi i këmbëve të urave, që rrezikohen të dëmtohen nga përmbytjet. - Garantimi se sistemet e duhura të kullimit të ujërave të shiut për zhvillime të reja ofrojnë siguri për ndikime të mundshme të ndryshimeve klimatike në të ardhmen. - Krijimi i një sistemi për përmirësimin e rrjeteve të kullimit, përfshirë ndarjen e kanalizimeve dhe ujërave sipërfaqësore për të shtuar kapacitetet për qëndrueshmëri. | | |
| 5 | <p>Hartimi i një Plani Vijimësie të Biznesit për të identifikuar dhe adresuar në mënyrë specifike ndikimet që lidhen me ngjarjet atmosferike ekstreme në të gjitha funksionet/shërbimet e Bashkisë Vlorë dhe për të eksploruar mundësitë për rritje të qëndrueshmërisë. Kjo do të përfshijë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përgatitjen për ndikimet në ndërprerjen e shërbimit dhe minimizimin i tyre; - vlerësimin i infrastrukturës së sistemeve rezervë të Bashkisë Vlorë (përfshirë procedurat rezervë për ndërprerjet e energjisë elektrike) për të siguruar qëndrueshmëri; - shqyrtimin e potencialit për zgjidhje të bazuara në teknologji për koordinimin e përgjigjeve ndaj ngjarjeve klimatike në fushat e TIK-ut dhe GIS-it - vlerësimin e ndikimeve të ngjarjeve klimatike gjatë vizitave të punës në ambiente të hapura/në terren dhe ndikimeve në afatet dhe nivelet e ofrimit të shërbimit; - vlerësimin e ambienteve të punës për stafin gjatë ngjarjeve atmosferike ekstreme dhe rishikimin e mënyrave të mundshme për të ruajtur kushtet e sigurta të punës, si dhe sigurimin e vendndodhjeve alternative të punës; dhe - hartimin e planeve për mobilizimin dhe disponueshmërinë e stafit për shkak të kufizimeve të udhëtimit. | <p>Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik</p> <p>Drejtorja e Planifikimit Urban</p> | Mesatar |
| 6 | <p>Hartimi i një plani shërbimi për të mobilizuar burime për ruajtjen e qëndrueshmërisë së rrjetit të autostradave dhe vendeve kritike në territorin e bashkisë gjatë gjithë muajve të dimrit, përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kryerjen e një studimi për të identifikuar llojet e motit ekstrem, që do të prekin zona të ndryshme të rrjetit të autostradave dhe infrastrukturës kritike. - Identifikimin e pjesëve të rrjetit/infrastrukturës, që kanë nevojë për shtim të qëndrueshmërisë. - Shqyrtimin e qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike të materialeve të përdorura për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve. | Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik | Afatmesëm-afatgjatë |
| 7 | <p>Eksplorimi i potencialit për të ndërmarrë trajtime parandaluese lidhur me mirëmbajtjen gjatë dimrit të shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta, duke ulur riskun/përgjegjësinë e mundshme për dëmtime të komuniteteve vendase.</p> | Drejtorja e Planifikimit Urban | Mesatar |

A.3 Infrastruktura

Për të rritur qëndrueshmërinë e aseteve infrastrukturore në Bashkinë Vlorë

| Nr. | Veprimi | Drejtuesi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
|-----|---|---|------------------------|
| 8 | Angazhimi në procesin e konsultimit mbi planifikim për të siguruar që ndikimet në disponueshmërinë e ujit dhe cilësinë e ajrit të merren parasysh në fazën e zbatimit të planifikimit. | Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik | Afatmesëm-afatgjatë |
| 9 | Vlerësimi i politikës së Bashkisë Vlorë për lëvizjen e automjeteve dhe kryerja e vlerësimeve të përshtatshmërisë së automjeteve për funksionimin efektiv në kushte sfiduese. Nxitja e politikës për mbështetjen dhe zhvillimin e Infrastrukturës së karikimit të Automjeteve Elektrike (EV) te Zonat në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Vlorë. - Mbështetja për vënien në dispozicion të automjeteve elektrike dhe infrastrukturës së karikimit të tyre, si dhe infrastrukturës përkatëse në qytetin e Vlorës, duke filluar me flotën e mjeteve të Bashkisë Vlorë. | Drejtorja e Planifikimit Urban; Drejtorja e Bujqësisë dhe Mjedisit. Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe Njësia e Prokurimit Publik; | Afatmesëm-afatgjatë |
| 10 | Kryerja e një Vlerësimi Risku për ndikimet e mundshme të ndryshimeve klimatike në objektet e menaxhimit të mbetjeve të Vlorës, për të identifikuar vendet dhe proceset më të prekura nga ndryshimet klimatike dhe për të përpiluar planet e duhura të veprimit për të trajtuar ndikimet e mundshme. | Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik | Mesatar |
| 11 | Bashkëpunimi me kompaninë e furnizimit me ujë të pijshëm dhe e ujërave të zeza për të garantuar që sistemet janë të qëndrueshme për të parandaluar kontaminimin e kryqëzuar gjatë ngjarjeve të zgjatura të përmytjeve; auditimi i sistemeve dhe i mirëmbajtjes parandaluese. | | Afatshkurtër-afatmesëm |
| 12 | Garantimi që planet e përgjigjes ndaj emergjencave të motit ekstrem të rishikohen çdo vit për të siguruar se është vënë në dispozicion kapaciteti i duhur i burimeve për të ofruar përgjigje efektive ndaj emergjencave. | | Afatshkurtër |

A.4 Biznesi dhe industria

A.4 Biznesi dhe industria

Për të identifikuar dhe çuar përpara mundësitë nëpërmjet përpjekjeve për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike në Vlorë

| Nr. | Veprimi | Drejtesi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
|-----|---|--|------------------------|
| 1 | <p>Hartimi i një Programi Ndërgjegjësimi për Ndryshimet Klimatike për bizneset dhe nismat e reja për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Informimin e tyre lidhur me masat për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike, që mund të integrohen në aktivitetet e biznesit. - Identifikimin e mbështetjes së biznesit dhe opsionet e financimit për bizneset, që kërkojnë të jenë më të qëndrueshme ndaj ngjarjeve të ndryshimeve klimatike. - Edukimin e bizneseve vendore lidhur me rëndësinë e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. - Promovimin e përshtatjes përmes ofrimit të këshillave dhe mbështetjes për bizneset dhe organizatat vendore dhe kryerjen e kërkimeve për trajtimin e sfidave të ndryshimeve klimatike (si për shembull, kërkimi dhe hartëzimi për zonat, që konsiderohen të dobishme për t'u përdorur si kompensime karboni në nivel vendor përmes sekuestrimit të karbonit). - Komunikimin e çështjeve strategjike me komunitetin e biznesit, duke ofruar trajnime dhe këshilla për kryerjen e kontrollit të Qëndrueshmërisë së Biznesit, për t'u siguruar se bizneset mund të reagojnë mirë ndaj presioneve të jashtme si moti ekstrem. - Përfshirjen e konsideratave të ndryshimeve klimatike te praktikat dhe operacionet ekzistuese të biznesit dhe zhvillimin e ideve ekzistuese dhe të reja, që synojnë të shfrytëzojnë mundësitë lidhur me përparimet mjedisore dhe teknologjike, që mbështesin kalimin te karboni i ulët. - Bashkëpunimin dhe të punuarit me bizneset për kërkimin e ideve të reja për të njohur risqet e ndryshimeve klimatike dhe mënyrat e ndërtimit të qëndrueshmërisë afatgjatë - Shfaqjen e praktikave më të mira në të gjithë industrinë dhe përmes punës së zbatuar nga Bashkia Vlorë. | Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit | Afatshkurtër-afatmesëm |
| 2 | Sigurimi që për të gjitha zhvillimet e reja tregtare të kërkohet përfshirja e një sistemi të qëndrueshëm të kullimit urban. | Bordi i Ujitjes dhe Kullimit | Mesatar |
| 3 | Garantimi që risqet klimatike të përfshihen në vlerësimet e riskut për korporatën. | Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit | Afatshkurtër |
| 4 | <p>Zbatimi i Strategjisë së Riskut dhe Mundësive për Kulturën dhe Trashëgiminë, duke përfshirë veprime për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hartimin e një regjistri për vendet e trashëgimisë dhe kulturës në Vlorë, i cili do të marrë parasysh ndikimet dhe çdo mundësi potenciale nga ndryshimet klimatike, përfshirë ndikimet indirekte në komunitetet dhe identitetin e tyre kulturor. - Hartimin, në partneritet, të protokolleve dhe procedurave për monitorimin e efekteve të ndryshimeve klimatike në zonat kulturore dhe të trashëgimisë në Vlorë, që përmes politikave kombëtare dhe vendore për përshtatje dhe menaxhim të hartohen programet e përshtatshme për mirëmbajtje dhe riparim. - Krijimin e një regjistri risku për asetet natyrore, kulturore dhe të trashëgimisë së ndërtuar nga njeriu. - Prezantimin e 'kontabilitetit të kapitalit natyror', që i jep trashëgimisë natyrore një vlerë monetare në sajë të lidhjes së saj me turizmin dhe shëndetin e mirëqenien e përgjithshme. | <p>Drejtoria Kombëtare e Kulturës – Ministria e Kulturës; Sektori i Pyjeve dhe Kullotave; Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit</p> <p>Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura (ARZM)</p> | Afatshkurtër-afatmesëm |

A.4 Biznesi dhe industria

Për të identifikuar dhe çuar përpara mundësitë nëpërmjet përpjekjeve për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike në Vlorë

| Nr. | Veprimi | Drejtesi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
|-----|--|--|------------------------|
| 5 | Hartimi i regjistrit të Riskut dhe Mundësive për Turizmin, duke përfshirë veprime për: - Analizimin e potencialit për humbjen e burimeve turistike si pasojë e ndikimeve të vendet e trashëgimisë, kulturore dhe atraktive, si dhe përcaktimin e çdo mundësie potenciale, që mund të vijë nga ndryshimet klimatike. - Kryerjen e analizës kosto-përfitim të investimeve për përshtatje për vendet me risk të lartë, të cilat janë gjithashtu prioritet për turizmin, dhe hartimin e planit strategjik të investimit për përshtatjen e burimeve turistike me risqet dhe mundësitë e identifikuar. | Drejtorja e Planifikimit Urban | Afatshkurtër-afatmesëm |
| 6 | Marrja në konsideratë e proceseve të përshtatjes në punë, për të minimizuar riskun mbi shëndetin e fuqisë punëtore. Për shembull, ndryshimet në regjimin e punës dhe PMP-të. | Drejtorja e Planifikimit Urban | Afatmesëm-afatgjatë |
| 7 | Sigurimi se të gjithë sektorët dhe bizneset, që kërkojnë leje mjedisore, për aktivitete që përfshijnë substanca mundësisht të dëmshme, punime me çimento, pika karburantesh, i vlerësojnë të gjitha ndikimet e ndryshimeve klimatike për funksionimin e tyre. | Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit | Afatgjatë |
| 8 | Nxitja e qëndrueshmërisë përmes zinxhirit dhe proceseve të furnizimit të prokurimit dhe komisionimit të Bashkisë Vlorë, për të ndihmuar Bashkinë Vlorë të promovojë sektorin vullnetar, komunitar dhe të ndërmarrjes sociale. Përmirësimi i provave dhe të kuptuarit të risqeve ndërvepruese dhe të njëpasnjëshme, duke i përfshirë në të gjithë zinxhirin e furnizimit. | | Afatmesëm |
| 9 | Shërbimi si lehtësues në prezantimin e Pagesave për Shërbimet e Ekosistemit (PES), veçanërisht në sektorin e bujqësisë, për të kontribuar të një strategji e qëndrueshme financimi. | Drejtorja e Planifikimit Urban Drejtorja e Mjedisit dhe Bujqësisë | Afatmesëm-afatgjatë |
| 10 | Zhvillimi i nismave të tjera për financimin mbi klimën, të tilla si modeli i koncesionit të tarifave të hyrjes, lejet e hyrjes, miratimi i zhvillimit dhe dhënia e kredive të kushtëzuara për zhvillimin e strategjisë së financimit të qëndrueshëm | Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit | Afatmesëm-afatgjatë |
| 11 | Përmirësimi i bashkëpunimit me akademinë në mënyrë që të shkëmbehen praktikat dhe njohuritë më të mira | Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit | Afatshkurtër-afatmesëm |
| 12 | Mbështetja e bizneseve për prezantimin e sektorëve të menaxhimit të riskut në kompanitë të tyre, veçanërisht në kompanitë e mëdha | Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit | Afatshkurtër-afatmesëm |

A.4 Biznesi dhe industria

Për të identifikuar dhe çuar përpara mundësitë nëpërmjet përpjekjeve për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike në Vlorë

| Nr. | Veprimi | Drejtuksi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
|-----|--|--|-------------------|
| 13 | Angazhimi dhe krijimi i Partneriteteve me bizneset private për të promovuar veprimin për Lëvizshmëri të Qëndrueshme, si instalimi i stacioneve të karikimit të automjeteve elektrike në objektet e tyre. Sigurimi i përputhshmërisë dhe ndëroperueshmërisë së stacioneve të karikimit me lloje të ndryshme automjeteve elektrike për të nxitur përshtatjen, etj. | Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit | |

A.5 Mjedis natyror

A.5 Mjedis natyror

Për të përfshirë konsideratat e veprimit klimatik në politikën e mjedisit natyror në Bashkinë Vlorë dhe për të promovuar menaxhimin efektiv të biodiversitetit dhe për të përmirësuar mbrojtjen e habitateve dhe peizazheve natyrore

| Nr. | Veprimi | Drejtuksi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
|-----|--|---|------------------------|
| 1 | <p>Identifikimi i mundësive për të rritur qëndrueshmërinë klimatike të infrastrukturës dhe mjedisit të ndërtuar përmes masave ekologjike natyrore në zhvillimet e reja (dhe për rinovimin e atyre ekzistuese), të tilla si përdorimi i elementeve natyrore (p.sh., pemët e rrugëve, tarracat e gjelbra, kopshtet që grumbullojnë ujë dhe shiut, etj.) dhe materialeve të tjera (si trotuarët e depërtueshme nga uji). Këtu mund të përfshihen veprime për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hartimin dhe përshtatjen e Strategjisë së Infrastrukturës së Gjelbër për të siguruar praninë e më shumë habitateve dhe habitateve të përmirësuara. Garantimin që hapësirat e gjelbra të sigurojnë gjithashtu përmirësime të biodiversitetit dhe promovimin e efikasitetit të eficientës së energjisë, zgjidhjeve të energjisë së rinovueshme dhe masave të ruajtjes së ujit në zhvillimet e reja, si dhe promovimin e tarracave, mureve dhe oborreve të gjelbra - Mbrojtjen dhe përmirësimin e hapësirave të gjelbra dhe të hapura, habitateve dhe korridoreve ekologjike nëpërmjet projekteve të peizazhit, si dhe promovimin e zgjidhjeve të bazuara në natyrë. Vlerësimin e qëndrueshmërisë së parqeve urbane dhe hapësirave të gjelbra të Bashkisë Vlorë, duke marrë parasysh si biodiversitetin ashtu edhe përdoruesit. - Përfshirjen e zgjidhjeve të infrastrukturës së gjelbër si një mjet për të mbështetur biodiversitetin, për të zbutur stresin e të nxehtit, për të ruajtur ujë, për të lehtësuar përmbytjet, si dhe për përfitime më të gjera mjedisore. - Eksplorimin e mënyrave për të rritur gamën e specieve të bimëve me qëllim shtimin e burimeve ushqimore dhe habitateve për pjalumësit. Përdorimin e këtyre specieve vendase për mbjellje përgjatë infrastrukturës rrugore të re dhe ekzistuese. | <p>Drejtoria e Planifikimit Urban</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe Njësia e Prokurimit Publik;</p> <p>Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura (ARZM Vlorë)</p> | Afatshkurtër-afatmesëm |

A.5 Mjedisi natyror

Për të përfshirë konsideratat e veprimit klimatik në politikën e mjedisit natyror në Bashkinë Vlorë dhe për të promovuar menaxhimin efektiv të biodiversitetit dhe për të përmirësuar mbrojtjen e habitateve dhe peizazheve natyrore

| Nr. | Veprimi | Drejtuesi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
|-----|--|---|-------------------|
| | <ul style="list-style-type: none"> - Mbrojtjen dhe kujdesin për ekosistemet ekzistuese dhe natyrore dhe sigurimin e përfshirjes së skemave të përshtatshme të peizazhit dhe mbjelljes në projektet infrastrukturore dhe komunitare. - Promovimin e përfitimeve më të gjera të infrastrukturës së gjelbër sikurse sigurimin e hijezimit për lehtësimin e stresit të të nxehtit, mbështetjen e biodiversitetit, sigurimin e ruajtjes së ujit dhe lehtësimin e përmbytjeve, si dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit. - Zhvillimin e mekanizmave dhe kanaleve të komunikimit për të siguruar që përshtatja dhe infrastruktura e gjelbër promovohen dhe përfshihen në punimet e ardhshme të zhvillimit dhe mirëmbajtjes, duke realizuar projekte infrastrukturore dhe ndërtimore cilësore, miqësore me klimën dhe të përshtatura. - Sigurimi që të mirëmbahen dhe mbrohen zonat e përshtatshme buferike për të shmangur ndikimet e mundshme në habitatet e përcaktuara, ose speciet dhe habitatet e mbrojtura, dhe për të mbrojtur dhe përmirësuar biodiversitetin më të gjerë. Identifikimi dhe mbrojtja e habitateve dhe specieve të Natura 2000 në territorin e Bashkisë Vlorë, duke përfshirë zonat brenda dhe jashtë Zonave të Mbrojtura - Nxitja e krijimit dhe respektimit të zonave buferike të Parkut Kombëtar të Mbrojtur të Lumit Vjosa. - Identifikimi i vendeve ose projekteve për gjelbërim të përkohshëm në tokë të lirë dhe të braktisur. Ndërhyrjet për mbrojtjen e maleve dhe pyllëzimi për shmangien e erozionit përgjatë Bypass-it të Vlorës, Rrugës së Orikumit - Tunelit të Llogarasë, etj. Përdorimi i specieve vendase me rezistencë të lartë për fiksime, formim humusi dhe rezistencë ndaj zjarrit. - Eksplorimin e mundësive të rritjes së vëllimit të hapësirave të gjelbra dhe sistemeve të qëndrueshme të kullimit urban në të gjithë Bashkinë Vlorë, për të reduktuar riskun për përmbytje të komuniteteve nga ngjarjet ekstreme të reshjeve të shiut | | |
| 2 | <p>Hartimi/rishikimi i Planit të Menaxhimit të Biodiversitetit të Vlorës dhe i projekteve specifike për zonën për t'u siguruar se janë identifikuar dhe janë marrë parasysh risqet nga ndryshimet klimatike, përfshirë një vlerësim të ndryshimeve të sezonalitetit, përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimin e një strategjie vendore për ofrimin e 10% të fitimit neto të biodiversitetit në kushtet e reja në të ardhmen. - Mbrojtjen dhe përmirësimin e ambienteve të gjelbra të hapura, habitateve dhe korridoreve ekologjike në nivel peizazhi nëpërmjet projekteve të peizazhit, duke zbatuar një skemë zhvilluese me Fitim Neto të Biodiversitetit. - Promovimin e integritetit të biodiversitetit në zhvillime - Integrimin e masave të përshtatjes, sipas nevojës, si mbjellja strategjike e pemëve, ujitja e livadheve, ndryshimi i regjimit të kositjes, instalimi i çezmave të ujit të pijshëm dhe mbjellja e specieve bimore më rezistente ndaj thatësisë. - Sigurimin që sipërfaqet e gjelbra dhe pemët të thithin më shumë CO2 dhe të përshtaten me klimën për të siguruar jetëgjatësi gjatë gjithë vitit. - Shpalljen e "Pyllit të Sodës" dhe hapësirave të tjera të gjelbra përreth qytetit të Vlorës "Park Bashkiak" ose "Kurorë e Gjelbër" e qytetit të | <p>Drejtorja e Bujqësisë dhe Mjedisit</p> <p>Spektori i Pyjeve dhe Kullotave; Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura</p> | <p>Afatmesëm</p> |

A.5 Mjedisi natyror

Për të përfshirë konsideratat e veprimit klimatik në politikën e mjedisit natyror në Bashkinë Vlorë dhe për të promovuar menaxhimin efektiv të biodiversitetit dhe për të përmirësuar mbrojtjen e habitateve dhe peizazheve natyrore

| Nr. | Veprimi | Drejtuesi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
|-----|--|--------------------------------|---------------------|
| | <p>Vlorës (hartimin i planit të menaxhimit të tij).</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prioritizimin dhe uljen e tarifave për bletarinë në zonat natyrore. | | |
| 3 | <p>Hartimi i një strategjie për mbjelljen e pemëve, për përdorimin e tyre për qëllime freskimi në zona të caktuara të botës së egër, në të gjithë Bashkinë Vlorë. Mbështetja dhe përmirësimi i një programi për mbjellje të shkurreve dhe pemëve vendase në qytetin e Vlorës, si: <i>Blini, Tisi, Lofata, Frasheri, Valanidhi, Agrumet, Lisi</i> (rrënjë), erica arbores, etj. në kuadër të një fushate ndërgjegjësimit për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke përfshirë veprime të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i një procesi studimi mbi pemët për të përcaktuar punimet e nevojshme për minimizimin e riskut. - Mbrojtja e pemëve ekzistuese, rritja e mbulimit me pemë dhe identifikimi i vendeve të reja për mbjellje shtesë të pemëve për përmirësimin e mjedisit natyror dhe biodiversitetit dhe mbrojtjen e pemëve në tokë private. Mbështetja e mbjelljes së specieve vendase. Ruajtja e bazave gjenetike të specieve bimore vendase, veçanërisht specieve të bredhit anglez dhe bredhit maqedonas në Llogora, që aktualisht janë të rrezikuara. - Identifikimi i korridoreve të mundshme ekologjike dhe i problematikave të lidhjes ndërmjet zonave. Si shembull mund të përmendim identifikimin e vendndodhjeve, si pemishtet urbane, parcelat, tarracat dhe muret e gjelbra, për të krijuar habitate të reja për florën dhe faunën vendase, që do të ndihmojnë në eliminimin e ndikimeve “të ishullit të të nxehtit urban”. - Sigurimi i shpërndarjes së tij në mënyrë të dobishme për biodiversitetin, duke rritur njëkohësisht sekuestrimin e karbonit. - Vëzhgimi i pemëve dhe strukturave që janë të cenueshme nga erërat e forta dhe që mund të paraqesin risk dëmtimi nëse shemben/bien gjatë erërave të forta. Megjithatë, duhet t'u jepet prioritet masave parandaluese. - Vlerësimi i ndikimit të ngjarjeve atmosferike ekstreme dhe i praktikave të pyllëzimit në “Pyllin Pishë-Poro” dhe “Pyllin e Sodës”. - Pyllëzimi i zonave bregdetare me <i>Tamarix parviflora</i> dhe specie të tjera shkurresh vendase, veçanërisht në zonat bregdetare të Pishë-Poros, deltës së lumit Vjosë, deri në “Pyllin e Sodës”. - Krijimi i shtresave natyrore, pa skema uniformë mbjelljeje, ndryshe nga pylli ekzistues, i cili është i mbjellë me një skemë sipërfaqësore sistemi rrënjor 2*3 dhe është shumë i kërcënuar nga erërat e forta. - Përfitimi nga prezantimi i programeve vendore të mbjelljes së pemëve, duke siguruar se të gjitha skemat kontribuojnë te objektivat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, si për shembull ato që ndihmojnë në reduktimin e riskut nga përmbytjet dhe në ftohjen urbane. - Rigjenerimi i pyjeve të Vlorës - pyllëzimi i ri përmes mbjelljes së fidanëve për të mundësuar përmirësimin e pyllëzimit, dhe hartimi i një plani zbatimi/planeve përgatitore për të minimizuar ndikimin e zjarreve në pyje me qasje të reja për kultivimin e llojeve të ndryshme të pyjeve, që do të ulin ndikimin e zjarreve. - Krijimi i kapaciteteve vendore për prodhimin e fidanëve të pemëve vendase për projektet e pyllëzimit, përmes ngritjes së fidanishteve | Sektori i Pyjeve dhe Kullotave | Afatmesëm-afatgjatë |

A.5 Mjedisi natyror

Për të përfshirë konsideratat e veprimit klimatik në politikën e mjedisit natyror në Bashkinë Vlorë dhe për të promovuar menaxhimin efektiv të biodiversitetit dhe për të përmirësuar mbrojtjen e habitateve dhe peizazheve natyrore

| Nr. | Veprimi | Drejtuesi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
|-----|---|--|-------------------------------|
| | <p>pyjore në vende strategjike, si fshatrat Dukat, Kaninë dhe Tragjas. Në këto fidanishte do të kultivohen fidanë vendas të përshtatur me kushtet klimatike vendore, duke siguruar furnizim të qëndrueshëm për përpjekjet për restaurim të përshtatura për speciet karakteristike të zonës.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi i kullotave dhe përdorimi i specieve vendase, nëpërmjet farërave të grumbulluara në zonat përkatëse. Karaburun, Dukat, Tragjas, Shashicë, Kaninë, etj. - Promovimi i restaurimit të shtresave pyjore midis sipërfaqeve bujqësore, Dukat i Ri, Tragjas Radhimë, për krijimin e mikrohabiteteve dhe mbrojtjen e kulturave bujqësore nga erërat e forta. | | |
| 4 | <p>Përgatitja e një Plani/Programi për Menaxhimin e Specieve Invazive për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monitorimin dhe mbajtjen nën kontroll të përhapjes së specieve të huaja invazive, përfshirë ndikimin në shkencën qytetare. - Identifikimin dhe trajtimin e specieve të dëmshme invazive, veçanërisht të atyre që paraqesin risk për shëndetin publik. - Sigurimin se janë identifikuar risqet përkatëse nga ndryshimet klimatike dhe speciet invazive, përhapja e të cilave lidhet me ndryshimet klimatike, dhe se janë zhvilluar teknika të përshtatshme menaxhimi për kontrollin e tyre. - Monitorimin e përhapjes së specieve invazive tokësore dhe ujore në kontekstin e ndryshimeve klimatike dhe kontrollimin e specieve invazive aty ku përhapja e tyre konsiderohet problematike. - Eksplorimin e metodave më miqësore me mjedisin për vënien në kontroll të rritjes së barërave të këqija dhe për reduktimin e përhapjes së specieve invazive. Shmangien e përdorimit të specieve të identifikuar si invazive për dekorim. - Përdorimi i zgjidhjeve të bazuara te natyra për menaxhimin e sëmundjeve të pemëve, në zonat natyrore dhe bujqësore. | <p>Sektori i Pyjeve dhe Kullotave</p> <p>Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura (ARZM)</p> <p>Drejtoria Rajonale e Peshkimit dhe Akuakultures</p> | <p>Afatshkurtër-afatmesëm</p> |
| 5 | <p>Përgatitja e një plani qëndrueshmërie për vënien në kontroll të infektiveve nga parazitët, insektet dhe speciet invazive, që lidhen me të nxehtin.</p> | <p>Sektori i Pyjeve dhe Kullotave</p> <p>Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura (ARZM)</p> | <p>Afatmesëm</p> |
| 6 | <p>Sigurimi i konvertimit në shkallë të gjerë të ish-zonave industriale. Aty ku zona të tilla nuk janë të përshtatshme për zhvillim, të merren parasysh opsionet e përshtatshme për gjelbërimin e zonave (pyjet urbane, ligatinat, parqet, etj.).</p> | | <p>Afatmesëm-afatgjatë</p> |

A.5 Mjedisi natyror

Për të përfshirë konsideratat e veprimit klimatik në politikën e mjedisit natyror në Bashkinë Vlorë dhe për të promovuar menaxhimin efektiv të biodiversitetit dhe për të përmirësuar mbrojtjen e habitateve dhe peizazheve natyrore

| Nr. | Veprimi | Drejtuesi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
|-----|--|---|------------------------|
| 7 | Hartimi dhe miratimi i një Strategjie Peizazhi për të siguruar që planifikimi strategjik i peizazhit të marrë parasysh ndryshimet klimatike. | Sektori i Urbanistikës, Bujqësisë, dhe i Pyjeve dhe Kullotave | Afatmesëm |
| 8 | Krijimi i habitatit në vende strategjike për të reduktuar riskun e erozionit të tokës. | Sektori i Pyjeve dhe Kullotave | Afatshkurtër-afatmesëm |
| 9 | Krijimi i mureve mbrojtëse nga përmytjet nëpërmjet përdorimit të zgjidhjeve të bazuara te natyra. | Sektori i Pyjeve dhe Kullotave | Afatshkurtër-afatmesëm |
| 10 | Hartimi dhe zbatimi i masave për të luftuar erozionin e bregdetit në Pyllin e Sodës dhe erozionin e tokës në basenin lumor të Shushicës. Nxitja e ruajtjes së leshterikëve të detit (Posidonia) të grumbulluar në brigjet e detit dhe përdorimit të zonave natyrore të plazhit. Nxitja e ruajtjes dhe restaurimit të habitatit të livadheve të leshterikëve të detit (Posidonia) në Gjirin e Vlorës. | Sektori i Pyjeve dhe Kullotave | Afatmesëm-afatgjatë |
| 11 | Restaurimi, përmes qasjes së Zgjidhjeve të Bazuara te Natyra, i zonave të degraduara dhe zonave pyjore të djegura nga zjarret (Llogara, Karaburun, Dukat, Pishë-Poro, etj.). Ndërhyrjet në pyllëzimin në fshatin Dukat i Vjetër për të rikuperuar 300 ha pyll të dëmtuar që nuk po rikuperohej për shkak të erozionit dhe shpëlarjes së dheut. | Sektori i Pyjeve dhe Kullotave | Afatmesëm-afatgjatë |
| 12 | Zbatimi i masave, mundësisht përmes qasjes së Zgjidhjeve të Bazuara te Natyra, për mbrojtjen nga erozioni i tokave bujqësore në fshatin Trevllazër | Sektori i Pyjeve dhe Kullotave | Afatmesëm-afatgjatë |
| 13 | Marrja e masave për mbrojtjen ndaj përmytjeve për segmentin Mifol – Portokalle | Sektori i Pyjeve dhe Kullotave | Mesatar |
| 14 | Përditësimi dhe përgatitja e Planeve të Menaxhimit të Kullotave dhe Pyjeve. Ndërhyrja për përmirësimin e kullotave dhe praktikave të qëndrueshme për të reduktuar intensitetin në zonat e mbishfrytëzuara (menaxhimi nëpërmjet kontratave, rotacioneve dhe përcaktimit të llojit dhe sipërfaqes për bagëtitë, si dhe rindërtimit të rezervuarëve të ujit, etj.) | Sektori i Pyjeve dhe Kullotave ARZM Vlorë | |
| 15 | Kontrolli dhe mirëmbajtja e prurjes së rregullt të ujit në Nartë dhe në Lagunën e Orikutit. | Drejtoria Rajonale e Peshkimit dhe Akuakultures, | |

A.5 Mjedisi natyror

Për të përfshirë konsideratat e veprimit klimatik në politikën e mjedisit natyror në Bashkinë Vlorë dhe për të promovuar menaxhimin efektiv të biodiversitetit dhe për të përmirësuar mbrojtjen e habitateve dhe peizazheve natyrore

| Nr. | Veprimi | Drejtuesi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
|-----|--|------------------------------------|-------------------|
| | Sigurimi i qarkullimit të brendshëm të ujit në laguna nëpërmjet mirëmbajtjes së kanaleve të brendshme dimërore e verore. | ARZM Vlorë, OMP-ja | |
| 16 | Rindërtimi i 2 stacioneve të pompimit në Akëri (zona e aeroportit) dhe Orikum. Rigjenerimi i zonave breglumore/moçalore të Valltos në Dukatin e Ri/Orikum, rreth 300 ha tokë të bonifikuar. Promovimi i ruajtjes së "pellgjeve ujore" natyrore në zonë për të siguruar ruajtjen e habitateve të shpendëve të ujit. | Drejtorja e Bujqësisë dhe Mjedisit | Afatmesëm |

A.6 Asetet dhe veprimtaritë e bashkisë

| A.6 Asetet dhe veprimtaritë e bashkisë | | | |
|---|---|---|------------------------|
| Për të rritur qëndrueshmërinë e aseteve të ndërtesave në pronësi të Bashkisë Vlorë, përfshirë stokun e banesave | | | |
| Nr. | Veprimi | Drejtuesi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
| 1 | Rishikimi i shërbimeve të Bashkisë Vlorë për: <ul style="list-style-type: none"> - Sigurimin se stafi dhe burimet teknike dhe operacionale ekzistojnë dhe përgatitjen për të reaguar ndaj ngjarjeve atmosferike ekstreme të mundshme. - Garantimin se ka plane menaxhimi për të përballuar çdo incident të motit ekstrem që mund të ndodhë, në mënyrë që shërbimet të vazhdojnë të ofrohen kudo që është e mundur - Njohjen se cilat zona shërbimi kanë gjasa të preken më shumë gjatë periudhave të emergjencave klimatike. | Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik | Afatmesëm |
| 2 | Duke u mbështetur në hartëzimin e rrezikut dhe riskut, veçanërisht për përmybtjet, të përmirësohet qëndrueshmëria dhe kapacitetet e përgjithshme të menaxhimit të ujit, duke përfshirë: <ul style="list-style-type: none"> - Forcimin e kapaciteteve të sistemit të paralajmërimit të hershëm. - Sigurimin se përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike dhe risqet për qëndrueshmërinë janë përfshirë në regjistrin e riskut të Bashkisë Vlorë. | Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit; Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e | Afatshkurtër-afatmesëm |

A.6 Asetet dhe veprimtaritë e bashkisë

Për të rritur qëndrueshmërinë e aseteve të ndërtesave në pronësi të Bashkisë Vlorë, përfshirë stokun e banesave

| Nr. | Veprimi | Drejtesi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
|-----|---|--|------------------------|
| | | Prokurimit Publik | |
| 3 | Identifikimi, pajisja me burime dhe instalimi i teknologjive të reja (ose përditësimi i atyre ekzistuese) në objektet e banimit/strehimit të bashkisë për të pakësuar ndikimet e ndryshimeve klimatike te stafi, klientët, publiku i gjerë dhe banorët | | |
| 4 | Kryerja e një kontrolli qëndrueshmërie nga Bashkia Vlorë për pasuritë bashkiake, duke filluar me ato në zonat më të cenueshme dhe duke ofruar mbështetje për komunitetin | | Afatshkurtër-afatmesëm |
| 5 | Sigurimi që praktikatat e menaxhimit të mbetjeve, objekteve të magazinimit dhe trajtimit janë të qëndrueshme për t'u bërë ballë kushteve klimatike të ardhshme, përfshirë përmytjet dhe valët e të nxehtit. | Drejtorja e Planifikimit Urban; Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik; | Afatmesëm-afatgjatë |
| 6 | Rishikimi i planeve ekzistuese të kontigjencave dhe emergjencave civile, që trajtojnë ngjarjet atmosferike të rënda, veçanërisht lidhur me informacione për udhëtimet dhe motin, si dhe për mbështetjen e njerëzve më të cenueshëm në të gjithë bashkinë | | Afatmesëm-afatgjatë |
| 7 | Angazhimi me stafin e Bashkisë Vlorë për: <ul style="list-style-type: none"> - Përfshirjen e fleksibilitetit të punës në praktikatat standarde të punës së këshillit, për t'i mundësuar stafit të punojë në periudha të motit ekstrem. - Kryerjen e vlerësimeve të riskut dhe monitorimin e vendeve për përcaktimin e veprimeve të nevojshme për minimizimin e riskut për stafin dhe përdoruesit. - Përfshirjen e masave që ofrojnë një mjedis pune më të rehatshëm për stafin, të cilëve u duhet të punojnë në zyrë gjatë kushteve atmosferike ekstreme | Drejtorja e Planifikimit Urban; Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe Njësia e Prokurimit Publik; | Afatshkurtër-afatgjatë |
| 8 | Përgatitja e një manuali për përgjigje në raste emergjencash, që përcakton rolin e secilës zonë shërbimi gjatë periudhave të emergjencave klimatike. | Drejtorja e Planifikimit Urban | Afatmesëm-afatgjatë |

A.6 Asetet dhe veprimtaritë e bashkisë

Për të rritur qëndrueshmërinë e aseteve të ndërtesave në pronësi të Bashkisë Vlorë, përfshirë stokun e banesave

| Nr. | Veprimi | Drejtpuesi dhe Partneri(ët) | Afati kohor S/M/L |
|-----|---|--|------------------------|
| 9 | <p>Bashkëpunimi me nivelin e tretë dhe struktura të tjera kërkimore për të shqyrtuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Masën në bazë të së cilës po shqyrtohen parashikimet e ardhshme të ndryshimeve klimatike në bashki lidhur me infrastrukturën digjitale, telekomunikacionin dhe TIK-un. - Potencialin e teknologjive për veprim ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbatimin e tyre në qytetin e Vlorës, së bashku me financimin e inovacionit dhe kërkimit në nivel kombëtar dhe në BE. | Drejtoria e Planifikimit Urban; Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik; | Afatshkurtër-afatgjatë |
| 10 | Të punuarit me organizatat partnere dhe palët e interesit për rritjen e zbatimit të projekteve të Menaxhimit të Përmbytjeve Natyrore në Bashkinë Vlorë. | Sektori i Pyjeve dhe Kullotave; Drejtoria e Planifikimit Urban | Afatmesëm-afatgjatë |
| 11 | <p>Rritja e qëndrueshmërisë (dhe të kuptuarit e riskut) të ndërtesave në Bashkinë Vlorë dhe të stokut të banesave përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identifikimit dhe vlerësimit të integritetit të ndërtesave të vjetra dhe të braktisura për të reduktuar kërcënimet e paraqitura. - Identifikimit dhe mbrojtjes ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe zbutjen e ndërprerjeve të shërbimit. | Drejtoria e Planifikimit Urban; Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe Njësia e Prokurimit Publik; | Afatshkurtër-afatmesëm |

Shtojca VI: Metodologjia për prioritizimin e masave për përshtatje

Pjesë e metodologjisë janë:

- a. Marrja në konsideratë se të gjitha veprimet e identifikuar kanë potencial të konsiderueshëm për të kontribuar në përshtatje; ushtrimi i prioritizimit përqendrohet në dy aspektet kryesore, përkatësisht te:
 - Potenciali i përfitimeve të përbashkëta të veprimeve, i cili i referohet probabilitetit dhe masës në të cilën veprimet në fjalë mund të sjellin (i) zhvillim socio-ekonomik dhe (ii) përfitime lehtësuese.
 - Lehtësia e zbatimit, e cila kërkon identifikimin e veprimeve zbatimi i të cilave është më i lehtë për t'u arritur, që merr parasysh analizën e kryer në hapin e parë. Ky aspekt merr parasysh kompleksitetin e (i) kërkesave institucionale, (ii) kërkesave teknike dhe (iii) shkallës së kostove (aspekteve financiare), në përpjesëtim të zhdrejtë me lehtësinë e zbatimit, që do të thotë se një masë shumë e shtrenjtë është më pak "e lehtë për t'u zbatuar", duke pasur parasysh faktin se duhet mobilizuar një buxhet i madh. Fizibiliteti nuk është analizuar, pasi të gjitha veprimet konsiderohen si të realizueshme dhe të nevojshme.
- b. Çdo nënkategori u vlerësua si "e ulët", "mesatare" ose "e lartë" dhe këto vlerësime u matën dhe u grumbulluan, duke sjellë vlerësimin e përgjithshëm prioritar. Masa për përfitimet e përbashkëta është 0.8 për zhvillimin dhe 0.2 për zbutjen. Për lehtësimin e zbatimit, masa është 0.3 për aspektin institucional, 0.3 për atë teknik dhe 0.4 për atë financiar.
- c. Për secilën kategori, vlerësimet e ulëta, mesatare ose të larta u shoqëruan përkatësisht me 1, 2 ose 3 pikë. Në mënyrë të barabartë, për masën totale merren parasysh kriteret e përfitimeve të përbashkëta dhe lehtësia e zbatimit. Niveli përfundimtar i prioritetit identifikon si "Shumë të larta" veprimet me vlerësim >4.5 pikë, si "Të larta" ato me $4.5 > x > 4.0$ dhe si "Mesatare" ato me vlerësim <4.0 (numri maksimal i pikëve që një veprim mund të marrë është 6).